

Raport për gjendjen e Mjedisit 2011-2012



MINISTRIA E MJEDISIT DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



AGJENCIA PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 2013



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

RAPORT PËR GJENDJEN E MJEDISIT

2011-2012

Prishtinë, 2013



Fjala e Ministrit



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë përkatësisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka përgaditur Rapotin e Gjendjes së Mjedisit 2011-2012, i cili ka për qëllim të ju informoi për gjendjen aktuale të mjedisit në Kosovë. Njëkohësisht përmes këtij Raporti prezantohet edhe angazhimi i institucioneve qeveritare për zbatimin e politikave adekuate mjedisore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Kosova ka bërë përparim të dukshëm në ndërtimin e një shteti modern e të integruar në Bashkimin Evropian. Në këtë rrugë krahas sfidave tjera ne po përballemi edhe me plotësimin sfidave

dhe kërkesave mjedisore, ku padyshim se vlerësimi i gjendjes së mjedisit është një ndër fushat me prioritet të lartë.

Përmbushja e këtyre obligimeve kërkon një angazhim më të madh, jo vetëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por edhe nga e gjithë shoqëria jonë. Andaj, përkushtimi ynë do të jetë që së bashku me institucionet dhe organizatat tjera relevante për mbrojtjen e mjedisit të angazhohemi për të hartuar politikat e duhura mjedisore dhe duke zbatuar këto politika të ndërtojmë mekanizma dhe instrumente efikase për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kualitetit të tij.

Jemi të vetëdijshëm që Republika e Kosovës edhe më tutje do ta ketë prioritet zhvillimin ekonomik, i cili do të shoqërohet edhe me rritjen e shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe ngritjen e kapaciteteve të reja energjetike, që domosdo do të rrisin edhe ndikimin në mjedis. Padyshim se ndikimi në mjedis do të rritet edhe nga zhvillimi i sektorëve tjerë si transporti, industria, urbanizimi, bujqësia etj. Duke marrë për bazë këto rrethana, MMPH do të mundohet maksimalisht që të respektoj parimin kryesor të mbrojtjes së mjedisit në relacion me zhvillimin ekonomik, parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, pra “të plotësojmë nevojat aktuale jetësore, pa i cenuar këtë të drejtë gjeneratave të ardhshme”.

Ne do të angazhohemi po ashtu edhe në parandalimin e shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore, zgjerimin e rrjetit të zonave të mbrojtura, menaxhimin më efikas të resurseve ujore, planifikimin e qëndrueshëm urban, menaxhimin e avancuar të mbeturinave dhe forcimin e inspektimit mjedisore.

Dardan Gashi
Ministër i Ministrisë së Mjedisit
dhe Planifikimit Hapësinorë

Përmbajtja

Fjala e ministrit.....	05
Parathënie	09
Përmbledhje ekzekutive	11
1. Profili i Kosovës	19
1.1. Pozita Gjeografike	19
1.2. Relievi	19
1.3. Klima.....	19
1.4. Hidrografia.....	19
1.5. Veçoritë Socio-Ekonomike	19
2. Ajri	24
2.1. Monitorimi dhe vlerësimi i emisioneve në ajër	24
2.2. Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit	30
2.2.1. Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit	30
2.2.2. Zgjerimi i rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit	32
2.2.3. Vlerësimi i cilësisë së ajrit.....	33
2.2.4. Cilësia e ajrit në zonat industriale	39
2.2.5. Gjendja meteorologjike në vendmostrimet e cilësisë së ajrit	41
2.3. Konkluzionet dhe rekomandimet	43
3. Uji	44
3.1. Resurset ujore.....	44
3.2. Monitorimi i cilësisë së ujërave.....	46
3.3. Konkluzionet dhe rekomandimet	70
4. Toka (Dheu)	71
4.1. Shfrytëzimi i tokave	71
4.2. Ndotja e tokave	73
4.3. Gjendja e mjediseve të rrezikuara.....	74
4.4. Konkluzionet dhe rekomandimet	76
5. Mbrojtja e Natyrës dhe Biodiversitetit	77
5.1. Zonat e Mbrojtura dhe Gjendja e tyre.....	77
5.2. Parku Nacional Mali Sharr.....	79
5.3. Konkluzionet dhe Rekomandimet	83
6. Mbeturinat	84
6.1. Mbeturinat komunale	84
6.2. Mbeturinat industriale.....	89
6.3. Deponitë sanitare.....	91
6.4. Konkluzionet dhe Rekomandimet	92
7. Mjedisi dhe Shëndeti Publik	93
7.1. Ndikimi i mjedisit në shëndetin publik	93
7.2. Kualiteti i ujit të pijes dhe shëndeti publik	95
7.3. Kualiteti i ajrit dhe shëndeti publik.....	98
7.4. Konkluzionet dhe Rekomandimet	99

8.	Masat për mbrojtjen e mjedisit	100
8.1.	Zbatimi i Strategjisë së Kosovës për Mjedis dhe Planit të Veprimit	100
8.2.	Strategjitë dhe Planet Sektoriale të Veprimit	100
8.3.	Hartimi i planeve mjedisore në nivelin lokal	101
8.4.	Hartimi i legjislacionit dhe përafrimi me direktivat e BE-së	101
8.5.	Investimet për Mbrojtjen e Mjedisit	102
8.6.	Zhvillimet dhe ngecjet në forcimin e institucioneve mjedisore	103
9.	Referencat	104
9.1.	Literatura, raportet dhe publikimet	104
9.2.	Institucionet dhe ndërmarrjet publike	105
10.	Shtojcat	106
10.1.	Indeksi i shkurtesa	106
10.2.	Indeksi i tabaleva	107
10.3.	Indeksi i figurave	108
10.4.	Indeksi i hartave	109





Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit¹. Sipas nenit 25 të këtij ligji, Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i paraqet Kuvendit Raport për Gjendjen e Mjedisit. Raporti duhet të përmbajë të dhëna për: Gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm, ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës, zbatimin e Strategjisë së Mjedisit, Planit të Veprimit, masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, shfrytëzimin e resurseve natyrore, zhvillimin e institucioneve mjedisore dhe financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, është institucioni që harton këtë dokument.

Ky Raport paraqet gjendjen e mjedisit për vitin 2011 dhe 2012, por edhe të dhëna të mëhershme zënë vend të konsiderueshëm me qëllim krahasimi. Ky është raporti i katërt zyrtar për gjendjen e mjedisit i cili procedohet zyrtarisht nga Ministri i MMPH-së.

Bazuar në modelet e pranueshme të raportimit dhe në rrethanat ekzistuese mjedisore në Kosovë, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Për t'i përmbushur kërkesat e raportit, të dhënat e mbledhura janë përpunuar në informata kualitative mjedisore që tani janë prezantuar në këtë raport. Këto të dhëna janë në formë teksti, tabelash, hartash dhe paraqitjesh grafike.

Raporti përshkruan gjendjen e mediumeve mjedisore dhe faktorët kryesor që kanë ndikuar në gjendjen e mjedisit në Kosovë. Raporti trajton në një masë politikat e ndjekura për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit si dhe angazhimin e institucioneve qeveritare, joqeveritare dhe të shoqërisë në përgjithësi për përmirësimin e gjendjes. Raporti përmbledhë shqetësimet për të gjitha problemet mjedisore në vend dhe është një mënyrë shumë e përshtatshme për vlerësimin e gjendjes së mjedisit.

Në masë të konsiderueshme hartimi i këtij raporti është orientuar edhe nga përzgjedhja e indikatorëve (treguesve) të cilët kanë qenë më të përshtatshëm për vlerësimin e gjendjes së mjedisit. Jemi përpjekur që indikatorët e zgjedhur të jenë të kapshëm nga të gjithë ata që do të shërbejnë me këtë raport.

Përkundër angazhimit maksimal, ky raport ka edhe mangësi, që në radhë të parë janë pasojë e mungesës së të dhënave për shumë çështje të rëndësishme, mungesës së monitorimit të integruar të mjedisit, bazës ligjore dhe dobësive tjera institucionale e menaxhuese.

Duhet pranuar faktin se cilësia e raportimit varet nga cilësia e monitorimit që zbatohet në shkallë vendi dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor. Duke ditur se këto dy sisteme mjedisore tek ne nuk janë të organizuara në nivelin e duhur, mund të arrijmë në një konkluzion se edhe mungesa e të dhënave të plota dhe besueshmëria e tyre është një tregues i rëndësishëm i gjendjes së mjedisit në Kosovë. Qëllimi i këtij raporti në radhë të parë është informimi për gjendjen e mjedisit në Kosovë, mirëpo, të dhënat e tij janë një bazë e mirë edhe për ndërtimin e politikave adekuate mjedisore dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis siç janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj.

AMMK shpreh falënderimin për të gjitha institucionet që kontribuan në finalizimin e këtij dokumenti, goftë përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme ose duke dhënë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Ne i vlerësojmë, çmojmë dhe mirëpresim të gjitha angazhimet, vërejtjet dhe sugjerimet e institucioneve, ekspertëve dhe dashamirësve të mjedisit, të cilat do të na ndihmojnë shumë gjatë hartimit të publikimeve të ardhshme, për ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së tyre.

Dr.sc. Ilir Morina,
Kryeshef Ekzektiv i Agjencionit
për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

¹ Ligji Nr. 03/L-025



Përmbledhje ekzekutive e Raportit

AJRI

Monitorimin e emisioneve në ajër në Kosovë, përmes sistemeve vetanake e bëjnë: KEK-u, Kompleksi i Ferronikelit në Gllogoc dhe Fabrika e çimentos-Sharçem në Han të Elezit.

Në KEK (TCA dhe TCB), bëhet monitorimi i emisioneve për: Pluhur, SO_2 , NO_x dhe CO_2 . Matje për emisionet e pluhurit, tregojnë se janë regjistruar tejkalime në të dy termocentralet. Gjatë periudhës 2007-2012 ka tejkalime të vlerës maksimale të lejuar të pluhurit ($50\text{mg}/\text{Nm}^3$), sidomos te TC A ku janë regjistruar tejkalime enorme të këtij parametri. Gjatë vitit 2010 dhe 2012 ka pasë tejkalime të vlerave maksimale të lejuara edhe të SO_2 . Tejkalime të vlereve të lejuara gjatë viteve 2007-2012 janë regjistruar edhe për parametrin NO_x , në të dy termocentralet e KEK-ut.


Sharçemi bënë monitorimin me matje të herë pas herë nga një kontraktorë i jashtëm. Parametrat e monitoruar janë: Pluhuri, SO_2 , NO_x dhe CO. Në bazë të rezultateve të matjeve vërehet se gjatë periudhës 2006-2012 ka tejkalime të vlerave maksimale të lejuara për pluhur. Kurse rezultatet e matjeve për SO_2 dhe NO_x tregojnë se në pjesën më të madhe kanë qenë nën vlerat maksimale të lejuara.

Në Ferronikel bëhet matja e emisioneve në gjashtë pika monitoruese. Këto matje realizohen vetëm një herë në muaj nga kontraktori i certifikuar. Edhe në rastin e Ferronikelit vërehen tejkalime të Vlerave Maksimale të Lejuara në disa raste për parametrat Pluhur dhe SO_2 .

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë realizohet nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës përmes Institutit Hidrometeorologjik. Edhe disa operatorë ekonomik siç janë KEK-u dhe Ferronikeli bëjnë monitorimin vetanake të cilësisë së ajrit.

Sipas rezultateve të monitorimit të cilësisë së ajrit nga IHMK për vitin 2012, për parametrin SO_2 nuk ka tejkalime në asnjë nga stacionet monitoruese, tejkalime vjetore nuk ka as për NO_2 . Mirëpo, në stacionin e Hanit të Elezit dhe atë të Gjilanit janë regjistruar tejkalime të pragu i lartë i vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (1-orësh) dhe të pragu i ulët i vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (1-orësh). Ndërkaq tejkalime nuk janë vërejtur, as të vlerësimit i koncentrimit të CO në ajrin ambiental, ndërkohë që të vlerësimit i përqendrimit të O_3 në ajrin ambiental janë regjistruar tejkalime në stacionin e Pejës dhe atë të Hanit të Elezit.

Ndërsa sa i përket vlerësimit të koncentrimit të $\text{PM}_{2.5}$ dhe PM_{10} në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011, tejkalime janë regjistruar në stacionet në Prizren, Han i Elezit dhe Gjilan.



Në sektorin e ujërave janë prezantuar të dhëna për resurset ujore të Kosovës, cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe monitorimin e ujërave sipërfaqësore sipas pellgjeve. Nga territori i Kosovës, në vitin me lagështi mesatare rrjedhin $3.6 \times 10^9 \text{ m}^3$ ujë ($121.2 \text{ m}^3 / \text{sec}$). Pjesa më e madhe e lumenjve i takon pellgut të Detit të Zi 50.7%, Detit Adriatik 43.5% dhe Detit Egje 5.8%. Sipërfaqja ujëmbledhëse topografike e Kosovës është 11.645 km^2 . Hidrografia e rrjedhave ujore të Kosovës ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci. Drini i Bardhë ka gjatësi më të madhe në kilometra brenda territorit të Kosovës me 122 km, ndërsa Lumëbardhi i Prizrenit më të vogël me 31 km. Vija ujëndarëse (pellgjet ujëmbledhëse), kanë rrjedhje në drejtime të ndryshme. Koeficienti rrjedhës sillet prej 3.93 l/sec/km^2 (Morava e Binçës) deri 42.46 l/sec/km^2 (Lumëbardhi i Deçanit).

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bënë Instituti Hidrometeorologjik. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda.

Ky rrjet monitorimi ka gjithsej 54 stacione monitoruese.



Në kuadër të monitorimit të parametrave fiziko-kimik në këtë raport janë prezantuar të dhëna për këta parametra: sasia e oksigjenit të tretur (O_2 tretur), shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO_5), përqeshmëria elektrike (PE), përqendrimi i jonit hidrogjen (pH), azoti i nitratoeve (N-NO_2^-), azoti i nitratoeve (N-NO_2^-), azoti i amoniumit (N-NH_4^+), fosfori i ortofosfateve (P-PO_4^{3-}), fosfori total (poli dhe orto), për Pellgun e Drinit në Bardhë, Pellgun e Ibri si dhe Pellgun e Moravës së Binçës dhe Lepencit. Rezultatet e monitorimit tregojnë se në disa raste, është regjistruar një vlerë shumë e ngritur e parametrin joni amonium $\text{NH}_4^+ / \text{mg/l}$, me tejkalim të vlerës maksimale të lejuar në vendstacionet: Bresje/Prishtevka në muajin gusht ($55,82 \text{ mg/l}$) dhe në Gërllicë/Nerodimja në muajin shtator joni amonium ($50,47 \text{ mg/l}$). Kjo ngritje e vlerës supozohet se vjen si rezultat i sasisë së pakët të ujit/ prurjeve, në muajt e verës. Gjithashtu vlerat më të larta mund të rezultojnë edhe për shkak se IHMK-së i mungon laborator mobil, përkatësisht frigoriferi për ruajtjen e mostrave, pasi që dihet se gjatë gjatë sezonit të verës ku temperaturat janë shumë të larta, ky parametër (joni amonium) ka afinitetin që në temperatura të larta të rritet përqendrimi i tij.

Po ashtu janë prezantuar të dhënat edhe për praninë e metaleve të rënda në ujërat sipërfaqësore. Metalet e monitoruara janë: Plumbi, Kromi, Kadmiumi, Bakri, Zingu, Hekuri, Mangani dhe Nikeli. Monitorimi i pranisë së këtyre metaleve është bërë në 23 stacione monitoruese.

Raste të tejkalimeve të vlerave të lejuara të këtyre metaleve gjatë vitit 2011 janë evidentuar si vijon: Metali Baker, ka një tejkalim të regjistruar në lumin Klina, Metali Zink ka tejkalim në lumi Sitnica – Mitrovicë si dhe Metali hekur, tejkalim në lumin Graçanka–Vragoli. Në Pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës, metali krom (Cr^{3+}), metali Hekur dhe Zink, kanë një tejkalim nga vlerat e lejuara në bazë të direktivës EU 152/1999, përderisa sasia e metaleve të tjera të përcaktuar ndodhen në sasira më të vogla se sa VML. Metali Hekur ka disa tejkalime të vlerës së lejuar edhe në lumin Morava e Binçës (në tri stacionet monitoruese), në lumin Kriva Reka – Domorovc, në lumin Lepenc – Hani i Elezit si dhe në lumin Nerodimja (në dy stacione monitoruese).

Në kuadër të kapitullit për tokën, në raport janë prezantuar të dhëna për kategoritë e shfrytëzimit të tokave, format e humbjes së tokave bujqësore, ndotjen e tokave dhe mjediset e rrezikuara.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në humbjen e tokave në Kosovë janë: zgjerimet e paplanifikuara të vendbanimeve, deponitë industriale dhe sanitare dhe erozioni. Njëra prej formave më të shpeshta të humbjes së tokave bujqësore është ndërrimi i destinimit të shfrytëzimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Sipas të dhënave të MBPZHR, gjatë periudhës 1999-2008, rreth 2,580.50 ha tokë bujqësore i është ndërruar destinimi pa lejen e autoriteteve përkatëse. Ndërsa rreth 1.690.00 ha të sipërfaqes së tokës bujqësore i është ndërruar destinimi me leje nga komunat. Sipas vlerësimeve të MBPZHR, llogaritet se rreth 400 ha tokë bujqësore brenda vitit i ndërrohet destinimi i shfrytëzimit në tokë ndërtimore.

Në Kosovë ende nuk ka sistem të monitorimit të tokës (dheut), prandaj edhe AMMK ka mungesë të të dhënave për kualitetin e dheut. Megjithatë, AMMK, ka identifikuar 110 vende të ndotura dhe të kontaminuara. Prej tyre 28 mjedise janë me potencial të lartë të ndotjes dhe janë të propozuara si Hotspote mjedisore. Si hotspote mjedisore janë evidentuar deponitë e minierave me koncentrike të lartë të metaleve të rënda, deponi të mbetjeve bujqësorë, deponi sanitare të mbeturinave, deponitë e rehabilitura komunale dhe deponitë e egra, mbetjet nga kemikatet e rrezikshme industriale dhe radioaktivitetit.

Sipërfaqja e mbuluar në nivel të Kosovës me mjedise të rrezikuara llogaritet të jetë 0.091 km². Hotspotet paraqesin rrezikshmëri të lartë për mjedisin dhe shëndetin e popullatës në Kosovë. Këto probleme të rrezikshmërisë së lartë kërkojnë analizë, vlerësime të ndikimeve, zbatim të masave përmirësuese dhe monitorim të vazhdueshëm, me qëllim që të evitohen rreziqet e mëtejshme për natyrën dhe shëndetin e njeriut.

Për shkak të mungesës së rrejtit nacional për monitorimin e cilesise se dheut, mungesës së programeve dhe planeve për rehabilitimin e tokave të ndotura, mungesës së programeve për monitorimin e përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike, mungesës së planeve dhe programeve për mbrojtjen e tokave nga erozioni dhe përmbytjet, si dhe mungesës së strategjisë për mbrojtjen e tokës nga ndotja rekomandohet që të punohet në: ngritjen e rrejtit të integruar të monitorimit të dheut dhe monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së tij, hartimin e programeve, planeve dhe masave për mbrojtjen e tokave bujqësore, për rehabilitimin e tokave të ndotura, për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe monitorimi i erozionit, si dhe në ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe monitorimit të përdorimit të pesticideve, ngritja e sistemeve të kontrollit dhe monitorimit të përdorimit të plehrave.



MBROTJA E NATYRËS DHE BIODIVERSITETIT

Gjendja e natyrës është prezantuar përmes të dhënave për numrin e zonave të mbrojtura të natyrës, menaxhimin e zonave të mbrojtura, gjendjen e këtyre zonave, si dhe gjendjen e llojeve bimore dhe shtazore.

Numri i Zonave të Mbrojtura të Natyrës është 99 dhe përfshinë sipërfaqen prej 118505.5 ha (11.4 % të territorit të Kosovës). Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 11 Rezervate të Natyrës, 2 Parqe Kombëtare, 84 Monumente të Natyrës, 1 Park Regjional i Natyrës dhe 1 Peizazh i Mbrojtur.

Gjatë periudhës 2004-2012, janë marrë nën mbrojtje ligjore 60 zona të reja të natyrës në mesin e të cilave edhe zgjerimi i Parkut Kombëtar “Sharri” me rreth 20 mijë ha, në territorin e Komunës së Dragashit si dhe Parku i dytë Kombëtar, “Bjeshkët e Nemuna” me rreth 60 mijë ha. Janë propozuar mbi 159 të tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura shumica janë monumente natyre me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik dhe spelologjik.



Aktualisht, vetëm 4 zona të mbrojtura kanë organe menaxhuese. Menaxhimin i Parkut Kombëtar “Mali Sharr” bëhet nga Drejtoria e Parkut me seli në Prizren që vepron në kuadër të MMPH/AMMK. Gjatë vitit 2013 është themeluar edhe Drejtoria e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, e cila po ashtu vepron në kuadër të MMPH/AMMK. Parku regjional “Gërmia” menaxhohet nga ndërmarrja publike “Hortikultura”, ndërsa monumenti i Natyrës me rëndësi të veçantë “Shpella e Gadimes” menaxhohet nga një organ që nuk është në mbikëqyrje nga institucionet lokale dhe qendrore. Monumentet tjera të natyrës menaxhohen nga autoritetet komunale përkatëse.

Gjatë vitit 2011-2012 është bërë monitorimi i vazhdueshëm i zonave të mbrojtura të natyrës si: Parku Kombëtar “Sharr”, Bifurkacioni i lumit Nerodime, Rezervati i Arnenit, Rusenica, Oshlaku, Ujëvarat e Mirushës, Park Regjional Gërmia, Burimi i Drinit të Bardhë më shpellën e Radavcit, Shpella e Gadimes, Gryka e Rugovës, Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë, si dhe shumë monumentet tjera të natyrës.

Gjatë kësaj periudhepo ashtu janë zhvilluar edhe disa aktivitete tjera të rëndësishme për sektorin

e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetin. Janë miratuar dy projektligje shumë të rëndësishme: Ligji për Parkun Kombëtar “Sharr” dhe Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”. Është miratuar Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011–2020. Është përgatitur Planit Hapësinor për “Ujëvarat e Mirushës” si dhe në bashkëpunim me UNDP-në ka filluar përgatitje e Planit Menaxhues për Parkun Kombëtar “Sharr”.

MBETURINAT

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk është në gjendje të mirë dhe paraqet një ndër sfidat kryesore mjedisore. Mesatarisht në Kosovë me shërbimin për grumbullimin e mbeturinave komunale shërbehen 49% e popullatës. Regjioni i Prishtinës mbulon përqindjen më të lartë të popullatës me këtë shërbim me 55% , ndërsa regjioni i Mitrovicës më të ulët me vetëm me 30%.

Në zonat urbane (qytete), shërbimi i grumbullimit të mbeturinave u ofrohet përrreth 90 % të popullatës, ndërsa zonat rurale mbulohen me këtë shërbim vetëm me rreth 10 %.

Mbeturinat e biodegradueshme marrin pjesë me 42 %, në kuadër të strukturës së përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara në Kosovë. Në vitin 2011 është regjistruar sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara. Në këtë vit në deponinë e Prishtinës janë deponuar (81,816.63 ton) ndërsa sasia më e vogël këtë vit është deponuar në deponinë sanitare të Podujevës (7,115.11 ton).

Sasia e mbeturinave komunale të gjeneruara për person në Kosovë në vitin 2011 është 335 kg, që tregon një rritje të ndjeshme të sasisë së mbeturinave për kokë/banori, krahasuar me vitet tjera. Krahasuar me regjionet tjera sasi më e madhe vjetore e mbeturinave për person gjenerohet në regjionin e Prishtinës.

Mesatarja ditore e mbeturinave të gjeneruara për person në Kosovë për vitin 2011 është 0.9 kg.

Sasia më e madhe e mbeturinave grumbullohet sipas shërbimit “derë me derë”, ndërkohë që sipas shërbimit për banesa kolektive ky grumbullim është më i vogël. Në Kosovë grumbullimi i mbeturinave derë më derë ishte 57% ndërsa në banimin kolektiv ka qenë 43%.

Në regjionet tjera në Kosovë grumbullimi i mbeturinave komunale ishte në raport 45 % në banim kolektiv dhe 55 % në banim derë më derë. Ndërsa në regjionin e Prishtinës 41% në banim kolektiv dhe 59% derë me derë.

Në vitin 2010 sasia e mbeturinave industriale është 580,154 ton, ku 36,241 nga to janë mbeturina të rrezikshme ndërsa pjesa tjetër mbeturina jo të rrezikshme. Sasia më e madhe e mbeturinave të gjeneruara është në sektorin e prodhimeve të ushqimit dhe pijeve.

Në shumicën e deponive sanitare gjendja nuk është e mirë. Pjesa më e madhe e tyre ballafaqohen me problemin e mungesës së hapësirës për deponimin e mbeturinave, mos mbulimin e mbeturinave, mos funksionimin e pompave dhe djegien e vazhdueshme të mbeturinave.



MJEDISI DHE SHËNDETI PUBLIK

Në Kosovë ende ka numër të madh të rasteve të sëmundjeve ngjitëse dhe numër të madh të rasteve të sëmundjeve që ndërlidhen me gjendjen e mjedisit e sidomos të sëmundjeve që vijnë nga ndotja e ujit dhe ajrit.

Numri i madh i rasteve me diarre ujore mund të ndërlidhet me kushtet jo të mira ekonomike dhe higjienike, cilësinë e ujit të pijshëm, mungesën e kanalizimit, menaxhimin e dobët të mbeturinave. Numri i madh i rasteve të Hepatitit A është indikator i cili flet për nivelin e ulët të higjienës si dhe shfrytëzimin e ujit të pijes nga pusët e kontaminuar.

Përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm të ujësjellësve publik në Kosovë është Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, i cili përcjell, kryen analizat dhe bënë raportet për përshtatshmërinë e cilësisë së ujit në bazë të rregullave.



Sipas këtyre raporteve, shumica e mbetjeve bakteriologjike ndodhin në ujësjellësit e qyteteve të vogla/rurale, edhe pse ka të raportuar edhe mos-përshtatshmëri të kualitetit të ujit të pijshëm (kryesisht mbetje bakteriologjike) edhe në sistemet e ujësjellësve publik.

Në bazë të të dhënave nga monitorimi i burimeve të ujit të pijshëm nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, konstatohet se ndotja e ujërave të pijshëm është më e madhe nga kontaminimi bakteriologjik se sa nga kontaminimi kimik. 74%-90% e ujërave të bunarëve sipas IK-SHP-së janë me kontaminim fekal.

Numri i madh i të sëmurëve të sistemit respirator është indikator i ndotjes së ajrit. Nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve të regjistruar në kujdesin parësorë shëndetësorë, në kuadër të grupit të sëmundjeve që ndërlidhen me mjedisin dhe faktorët mjedisor, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar me sëmundje të sistemit të frymëmarrjes me 663353 raste në vit ose 31.5 % e numrit të përgjithshëm të të sëmurëve.

Në një analizë të bërë nga Banka Botërore, thuhet se në bazë të koeficienteve ekspozim/reagim, koncentrimet vjetore të PM në ajrin e ambientit, dhe të dhënat për popullsinë e ekspozuar, ndotja e ajrit urban në Kosovë llogaritet se shkakton 835 vdekje të parakohshme, 310 raste të reja të bronkitit kronik, 600 shtrirje në spital dhe 11,600 vizita në emergjencë.

MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Ky është një kapitull tjetër i raportit, përmes së cilit synohet të prezantohet se sa është zbatuar Strategjia e Kosovës për Mjedis dhe Plani i Veprimit në Mjedis, progresin e arritur në hartimin e strategjive dhe planeve sektoriale të veprimit, hartimin e planeve dhe programeve mjedisore në nivelin lokal.

Në këtë kapitull po ashtu është bërë një përmbledhje e masave dhe veprimeve kryesore të ndërmarra nga institucionet e ndryshme për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Këtu janë përfshirë masat në hartimin e legjislacionit mjedisor dhe përafrimin e tij me legjislacionin evropian, zhvillimet dhe ngecjet në forcimin e institucioneve mjedisore dhe investimet për mbrojtjen e mjedisit.

Gjate vitit 2010-2012, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka rishikuar Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2005-2015 dhe Planin e Veprimit për Mjedis. Si rezultatet i këtij procesi është hartuar draft Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2022.

Gjatë vitit 2011 është miratuar në Kuvendin e Kosovës, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2010-2020, ndërsa janë në procedurë për miratim edhe Strategjia dhe Plani Aksional për Mbeturina si dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit.

Ka filluar po ashtu edhe përgatitja e Plani Strategjik i Kosovës për Ujëra, Strategjisë për Ndryshime Klimatike dhe disa strategjive tjera që parashihen sipas legjislacionit mjedisor dhe që janë të nevojshme për administrimin më efikas të mjedisit.

Gjatë vitit 2011, me përkrahje të Agjencionit Suedez për Zhvillim Ndërkombëtarë, Qendra Rajonale për Mjedis (REC) Zyra në Prishtinë ka filluar projektin për hartimin e Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis - PVLN në 10 komuna të Kosovës.

Gjate vitit 2012, në kuadër të plotësimit të legjislacionit për mjedisin janë miratuar disa ligje me rendësi sikur janë: Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri”, Ligji për mbeturina dhe Ligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore 04/L-067 i miratuar me datë 24.05.2012 Dekreti nr. DL- 028 -2012, Datë 08.06.2012

Krahas hartimit të legjislacionit mjedisor i është kushtuar kujdes i veçantë edhe përafrimit të legjislaturës kombëtare mjedisore me atë evropiane.

Gjate viteve 2010-2012 një pjesë e investimeve mjedisore janë orientuar në rehabilitimin e disa deponive dhe mbylljen e deponive të vjetra të mbeturinave komunale dhe industriale. Investime tjera nga MMPH-ja janë realizuar edhe në implementimin e projekteve për ndërtimin e shtatë qendrave për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore, si dhe në implementimin e projektit për mbeturina të rrezikshme, në ndërtimin e magazinave për ruajtje të përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.

Në sektorin e ujërave është investuar në rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe në hartimin e studimeve të fisibilitetit për trajtimin e ujërave të ndotura.

Investimet e donatoreve kanë qenë të orientura në ngritjen e kapaciteteve dhe në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në përgjithësi, por edhe në ngritjen e rrjetit të monitorimit të gjendjes së mjedisit.

Në kuadër të zhvillimeve institucionale duhet veçuar themelimin e Agjencionit për Rrezatimin Jonizues dhe Jojonizues dhe Ngritja e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Ndërsa, në kuadër të ngecjeve dhe pengesave në forcimin e institucioneve mjedisore gjatë kësaj periudhe veçohen: Mungesën e organeve menaxhues për Parkun Regjional Mirusha, mos funksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Ujërave dhe mungesa e rrjetit të monitorimit për cilësinë e tokës.



1. Profili i Kosovës

1.1. Pozita Gjeografike

Kosova gjendet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik. Shtrihet në mes të 41°50'58" dhe 43°51'42" të gjerësisë gjeografike veriore dhe 20°01'30" dhe 21°48'02" të gjatësisë gjeografike lindore. Kosova ka sipërfaqe prej 10.908 km². Sipas rezultateve paraprake nga regjistrimi preliminar të realizuar nga ASK në vitin 2011, Kosova ka 1.73 milion banorë dhe dendësi mesatare prej 159 banor në km² (në regjistrim nuk janë përfshirë komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan)². Kufizohet me Shqipërinë (në jug-perëndim), me Maqedoninë (në juglindje), me Serbinë (në lindje, veri dhe verilindje) dhe me Malin e Zi (në perëndim). Gjatësia e përgjithshme e kufirit të Kosovës me vendet fqinje është rreth 700.7 km².

1.2. Relievi

Kosova është vend malor dhe me ultësira, i përbërë nga Fusha e Kosovës (me lartësi mbidetare 510-570 m) dhe Rrafshi i Dukagjinit (lartësia mbidetare 350-450 m). Lartësia mesatare mbidetare e Kosovës është 810m. Pika me e ulët është 270 m, ndërsa më e larta 2656 m (Gjeravica). Në aspektin hipsometrik sipërfaqe nën 300m lartësi mbidetare përfshinë vetëm 16.4 km² (0.2 %) deri 1000 m shtrihen 8754 km² (80.7 %), prej 1000 deri 2000 m 1872.3 km² (17 %) dhe mbi 2000 m deri 250.6 km² (2.3 %). Format kryesore në relievin e Kosovës janë: malet me 63 % dhe fushëgropat 37%.

1.3. Klima

Kosova karakterizohet me klimë të mesme-kontinentale, me ndikim të klimës mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit. Të reshurat mesatare vjetore 596 mm. Temperaturat mesatare vjetore të Kosovës janë 10 °C, me temperaturën e arritur minimale -27,2 dhe maksimale 39,2. Faktorët lokal kryesorë që ndikojnë në klimën e Kosovës janë: relievi, ujërat, trualli dhe bimësia.

1.4. Hidrografia

Vlerësohet se Kosova ka vetëm 1600 m³/ujë/vit për kokë banori. Ujërat e Kosovës ndahen në 4 Pellsje Lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci. Nga territori i Kosovës në vitin me lagështi mesatare rrjedhin përafërsisht 3.8 x 10⁹ ujë, përkatësisht 121.2 m³/sec. Potenciali për energji ujore në Kosovë është shumë i vogël dhe deri më tani shfrytëzimi i saj është mjaft modest. Kushtet topografike për ndërtimin e rezervuarve artificial për mbledhjen e ujit nuk janë të përshtatshme.

Rezervat e ujërave nëntokësore janë të kufizuara dhe gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ku edhe rezervat e ujërave sipërfaqësore janë më të mëdha, në krahasim me pjesën lindore me rezerva të pakta dhe pjesën jug-lindore, ku nevojat për ujë janë shumë të mëdha. Kosova ka numër të vogël të liqeneve natyrore. Liqene artificiale janë Batllava, Gazivoda, Radoniqi, Përlepnica dhe Baddovci, si dhe një numër i liqeneve të vogla për ujitje.

1.5. Veçoritë Socio-Ekonomike

Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe parashikimet- Numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës edhe përkundër shpërnguljeve dhe trysnive të shumta ndaj saj, vazhdimisht është rritur në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore me ritme të ndryshme. Gjatë periudhës 63 vjeçare (1948-2011) popullsia e Kosovës kishte një rritje prej 138.2%.

² Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, ESK 2011

Tabela 1: Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2011³

Viti	Nr.i banorëve	Komentet
1948	727820	Regjistrimi
1961	963988	Regjistrimi
1971	1243693	Regjistrimi
1981	1584440	Regjistrimi
1991	1956196	Vlerësimi
2002	1985000	Vlerësimi
2011	1733872	Regjistrimi
2012	1815606	Vlerësimi




Figura 1: Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2011

Në bazë të projeksioneve të popullsisë së Kosovës numri i përgjithshëm do të vazhdon të rritet edhe në 50 vitet e këtij shekulli, edhe pse me ritme dukshëm më të ngadalshme krahasuar me vitet e '60, '70 dhe '80 të shekullit të kaluar.

Rritja e numrit të përgjithshëm të popullsisë ka ndikim në mjedis në shumë aspekte, prej të cilave më të rëndësishmet janë: ndikimi në shkallën e prodhimit, shfrytëzimin e resurseve, në mënyrën e shfrytëzimit të tokës si dhe krijimin e mbeturinave dhe ndotjen e mjedisit.

Lidhja në mes popullsisë dhe ndikimit në mjedis në shikim të parë është: më shumë njerëz harxhojnë më shumë produkte, potencial natyror, shkaktojnë më shumë dëme dhe prodhojnë më shumë mbeturina.

Shtimi natyror i popullsisë- Popullsia e Kosovës ritmin më të shpejtë të rritjes e ka pasur gjatë viteve '60-ta, kur shkalla e shtimit natyror ishte më e larta në periudhën e pas Luftës së dytë Botërore me 29.9% (lindshmëria 44.1% kurse vdekshmëria 14.2%).

³ Statistikat e lindjeve në Kosovë 2008, ASK 2009

Tabela 2: Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 1948-2011⁴

Viti	Lindshmëria	Vdekshmëria	Shtimi natyror
1948	27792	10324	17468
1961	40561	11759	28802
1971	47060	10312	36748
1981	48111	9677	38434
1991	52263	8526	43737
1996	46041	8392	37649
2002	36136	5654	30482
2003	31994	6417	25577
2004	35063	6399	28664
2005	37491	7207	30284
2006	34187	7479	26708
2007	33122	6681	26431
2008	34399	6852	27547
2009	34240	7030	27210
2010	33751	7234	26517
2011	34262	7556	26706




Figura 2: Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 2002-2011

Në bazë të dhënave që ofron Enti i Statistikave të Kosovës, në vitin 2003 në Kosovë është regjistruar niveli më i ulët i lindjeve dhe i shtimit natyror të popullsisë në 1000 banorë, që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore deri me sot.

Dendësia e popullsisë- Me rritjen e popullsisë së Kosovës është rritur edhe niveli i popullimit mesatar për njësi të sipërfaqes nga 62.7 (1948) në 159 (2011) banorë për km². Kjo rritje paraqet njëherësh edhe rritjen e ndikimit të popullsisë në mjedis. Dendësia më e lartë e popullsisë është në zonat e ulëta fushore (mbi 600 b/km²-Fusha e Kosovës), në viset e ulëta kodrinore lëviz rreth mesatares së Kosovës, kurse viset e larta kodrinore-malore kanë dendësi më të ulët se mesatarja e Kosovës.

Në viset e ulëta është koncentruar numri më i madh i popullsisë, objekteve industriale dhe urbanizimit, faktorë këta që kanë ndikimin më të madh në ndotjen e mjedisit.

⁴ Statistikat e vdekjeve në Kosovë 2011, ASK, Prishtinë 2012

Tabela 3: Dendësia e popullsisë në Kosovë 1948-2011⁵

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2002	2011
Nr.i ban. për km ²	62.7	74.8	88.4	114.1	145.3	179.7	182	159




Figura 3: Dendësia e popullsisë në Kosovë 1948-2011

Ndryshimet në dendësi të popullsisë në mjedisin gjeografik lidhen me disa probleme mjedisore siç janë: braktisja e mjediseve agrare (emigrimet drejt qyteteve), rritja e trysnisë mbi mjedis në disa zona (veçmas urbane) dhe pamundësia për të kënaqur kërkesat në banim, punësim, siguri, infrastrukturë etj, si dhe ndërhyrjet tjera përmes zënies së sipërfaqeve bujqësore me ndërtime, ndërhyrje pa kriter në ujësjellës, rritja e sasisë së mbeturinave, ujërave të zeza që hedhen në mjedis të pa trajtuara etj. Struktura e popullsisë sipas moshës- Popullsia e Kosovës është me moshë të re. Në vitin 2006 grup moshë 0-19 vjeç përbën 38 %, grup moshë 20-64 përbën 56 %, kurse grup moshë e vjetër mbi 65 vjeç përbën 6 % të popullsisë së përgjithshme.

Tabela 4: Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2011⁶

	1981	1991	2001	2006	2011
0-19 vjeç	52	48	41	38	38
20-64 vjeç	43	47	54.1	56	65
Mbi 65 vjeç	5	5	5.9	6	7




Figura 4: Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2006

5 Gjeografia e Kosovës, ETMM, Pr, 1994 dhe Statistikat vitale të Kosovës 2002, Regjistrimi 2011, ASK.

6 Për vitin 1881, Buletini 17, ASK, 1991-2001, Ecuria dhe shtrirja e pop. Shqiptare në Ish Jugosllavi, Instituti Ekonomik 1997, 2006, Kosova në shifra 2006 dhe 2011, SSK, Prishtinë 2007 dhe 2012.

Struktura e popullsisë sipas moshës në mjedis ndikon përmes prodhimit dhe konsumit, sepse nga kjo strukturë formohet kontingjenti i punës dhe kontingjenti i popullsisë që paraqitet si konsumator. Të ardhurat për kokë banori- Pas viteve '80-ta, përkeqësimi i situatës ekonomike në Kosovë është shprehur edhe me zvogëlimin e të ardhurave për kokë banori. Nga viti 2000 të ardhurat për kokë banori fillojnë të rriten, më shumë për shkak të ndihmave dhe donacioneve të ndryshme se sa të zhvillimit ekonomik të vendit.

Tabela 5: Të ardhurat kombëtare për kokë banori në Kosovë 1985-2009⁷

	1985	1990	1995	2000	2001	2004	2006	2008	2009
Të ardhurat për banorë në €	1125	689	340	730	823	1457	1487	1784	1710




Figura 5: Të ardhurat kombëtare për kokë banori në Kosovë 1985-2008

Kosova ka nivelin më të ulët të të ardhurave për kokë banori në Ballkan dhe Evropë.

Varfëria- Në vitin 2011, në Kosovë të ardhurat (banorë të rriturit/ditë) kanë qene 1.72 Euro për kategorinë e varfërisë dhe 1.20 Euro për kategorinë varfëri e skajshme⁸.

Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2011 në Kosovë në varfëri kanë jetuar 29.7 % e popullsisë, prej të cilëve 31.5 % në zonat rurale ndërsa 26.7 % në zonat urbane. Kurse në varfëri ekstreme kanë jetuar 10.2%, prej të cilëve 10.7% në zonat rurale kurse 9.4% në zonat urbane. Nëse e analizojmë trendin e varfërisë dhe varfërisë së skajshme për periudhën 2009-2011, do të vërejmë një rënie të ndjeshme të varfërisë dhe të varfërisë së skajshme nga viti 2009 në vitin 2010, kurse nga viti 2010 deri në vitin 2011, vërehet një rritje e varfërisë së skajshme. Tabela 6.

Tabela 6: Varfëria dhe varfëria e skajshme sipas vendbanimeve (%) 2009-2011⁹

Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit	Shpërndarja e të varfërve			Shpërndarja e të varfërve të skajshëm		
	2009	2010	2011	2009	2010	2011
Urbane	33.1	26.7	26.7	13.2	7.8	9.4
Rurale	35.3	30.7	31.5	12.1	8.5	10.7
Totale	34.5	29.7	29.7	12.5	8.2	10.2

Shkalla e varfërisë e shikuar sipas gjinisë, tregon se në vitin 2011, 33.3 % e femrave kanë jetuar në varfëri në krahasim me 29.2 % të meshkujve. Ndërsa sa i përket shpërndarjes së varfërisë sipas madhësisë së ekonomive familjare, ato me 5-8 anëtarë dhe ato me mbi 10 anëtarë kanë përqindjen më të lartë të varfërisë. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe shkalla e lartë e papunësisë konsiderohen disa nga shkaktarët e nivelit të lartë të varfërisë në Kosovë.

⁷ Bruto prodhimi vendorë në Kosovë për vitet 2004-2008, ASK, Prishtinë, 2009

⁸ Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011, ASK 2012, fq 3

⁹ Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011, ASK 2012, fq 3

2. Ajri

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht në ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore.

Ndotja e ajrit ndodh kur ajri përmban substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale. Disa ndotës mund të kenë ndikime globale - p.sh. rritja e efektit të gazeve serrë ose dëmtimi i shtresës së ozonit. Çdo burim i ndotjes është kontribues në territorin ku shfaqet, por ndotja e ajrit gjithnjë e më shumë po merr përmasa globale.

Si burime të ndotjes së ajrit në Kosovë konsiderohen Energjetika, Industria dhe komunikacioni.

Në këtë kapitull prezantohen të dhënat mbi emisionet dhe cilësinë e ajrit të mbledhura nga raportimet e operatorëve ekonomik dhe sistemi i monitorimit automatik kontinual. Për cilësi të ajrit ka disa të dhëna nga operatorët, të cilët bëjnë vetëmonitorim brenda zonave të tyre industriale. Ende përfshirja e operatorëve ekonomik nuk është e kënaqshme, ngase përveç KEK, Ferronikelit dhe Sharrcemit, operatorët tjerë nuk raportojnë për emisionet e tyre nga proceset e prodhimit.

Të dhënat e raportuara dhe vlerësimi i tyre janë bazuara në ligjet dhe udhëzimet administrative për ajrin, si dhe në direktivat e BE dhe metodologjisë së raportimeve nga Agjencioni i Mjedisit të Evropës. Të dhënat i referohen kryesisht vitit 2012, ndërsa te emisionet është prezantuar edhe trend i tyre për disa vite paraprake.

2.1. Monitorimi dhe vlerësimi i emisioneve në ajër

Vlerësimi i Emisioneve nga Termocentralet TCA dhe TCB

Pluhuri

Për të treguar emisionet e pluhurit në TC A dhe TC B janë prezantuar të dhëna të kalkuluara nga zyrtarët mjedisor të KEK-ut përmes Fig.7., nga ku shihen kështu tejkallimet krahasuar me vlerat maksimale të lejuara (VML) si në TC A poashtu edhe në TCB.




Fig.7. Emisionet e kalkuluara të pluhurit në mg/Nm³ për TC A dhe TC B gjatë vitit 2012

Gjatë vitit 2007-2012 në TC A dhe TC B, nga të dhenat për emisionet e pluhurit, të prezantuara në Fig. 8. dhe Fig. 9. shihet se në vitin 2012 ka përmisim të gjendjes në krahasim me vitet paraprake, edhe pse tejkallimet nga vlerat maksimale të lejuara (VML) janë ende shumë të larta në të gjitha vitet.




Fig.8. Emisionet e kalkuluara të pluhurit në mg/Nm³ për TC A gjatë viteve 2007-2012




Fig.9. Emisionet e kalkuluara të pluhurit në mg/Nm³ për TC B gjatë viteve 2007-2012

Dioksidi i sulfurit (SO₂)

Për të treguar gjendjen e SO₂ në TC A dhe TC B gjatë vitit 2012 janë prezantuar të dhëna të kalkuluara në Fig.10. ku shihen tejkalimet nga vlerat maksimale të lejuara (VML) si në TC A poashtu edhe në TC B.




Fig.10. Emisionet e kalkuluara të SO₂ në mg/Nm³ për TC A dhe TC B gjatë vitit 2012

Trendi i emisioneve për SO₂ gjatë vitit 2007-2012 në TC A dhe TC B është paraqit në Fig. 11. dhe Fig. 12. ku shihet se përveç vitit 2007 të gjitha vitet tjera kanë patur tejkalime krahasuar me vlerat maksimale të lejuara (VML).




Fig.11. Emisionet e kalkuluara të SO₂ në mg/Nm³ për TC A gjatë viteve 2007-2012




Fig.12. Emisionet e kalkuluara të SO₂ në mg/Nm³ për TC B gjatë viteve 2007-2012

Oksidet e azotit (NO_x)

Emisionet e NO_x për TC A dhe TC B gjatë vitit 2012 janë paraqitur në Fig.13. ku shihen tejkalimet nga vlerat maksimale të lejuara (VML) si në TC A poashtu edhe në TCB.




Fig.13. Emisionet e kalkuluara të NO_x në mg/Nm³ për TC A dhe TC B gjatë vitit 2012

Trendi i emisioneve për NO_x gjatë viteve 2007-2012 në TC A dhe TC B është paraqit në Fig. 14. dhe Fig. 15. ku shihen tejkalime krahasuar me vlerat maksimale të lejuara (VML) në të gjitha vitet.




Fig.14. Emisionet e kalkuluara të NO_x në mg/Nm³ për TC A gjatë viteve 2007- 2012




Fig.15. Emisionet e kalkuluara të NO_x në mg/Nm³ për TC B gjatë viteve 2007- 2012

Dioksidi i karbonit (CO₂)

Emisionet e CO₂ gjatë vitit 2012 për TC A ka qenë 2,762,053 t/vit kurse në TC B ka qenë 3,314,555. Ndërsa në tabelën 7 është prezantuar trendi i emisioneve të CO₂ gjatë viteve 2007- 2012 të CO₂ në TC A dhe TC B.

Tab.7. CO₂ në t/vit për TC A dhe TC B gjatë viteve 2007- 2012

	2007	2008	2009	2010	2011	2012
TC A	2,087,938	2,008,196	2,364,253	2,848,117	2,893,087	2,762,053
TC B	3,636,361	4,338,011	4,689,615	4,249,301	3,463,901	3,314,555
TCA+TCB	5,724,299	6,346,207	7,053,868	7,097,418	6,356,988	6,076,608

Duhet të theksohet se në TC Kosova A, janë vendosur elektrofilter të rinjë në TCA₅ dhe TCA₃, ndërsa pritet edhe instalimi i të njëjtëve në TCA₄.

Nga rezultatet e emisionit të pluhurit tek TCA5 mund të konstatohet se vendosja e elektrofilterëve të rinjë ka dhënë rezultate, pasi që vlerat e emisioneve të pluhurit janë nën Vlerat Maksimale të Lejuara.¹⁰

Vlerësimi i Emisioneve në Sharrcem

Pluhuri

Emisionet e pluhurit për tre muaj të vitit 2012 janë prezentuar në Fig.16¹¹. Mungesa e të dhënave në këtë vit vjen nga shkaku se Sharrcemi është në fazën e remontit ku janë duke u realizuar edhe investimet e parapara në përmirësimet në mjedis e që u referohen zavendësimeve në filterat eksistues. Nga Fig.16. shihet se gjatë muajve Qershor deri në Korrik të vitit 2012, emisionet e pluhurit kanë qenë nën vlerat maksimale të lejuara.




Fig.16. Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm³ gjatë muajve Qershor, Korrik, Gusht të vitit 2012 në Sharrcem.

Dioksidi i sulfurit (SO₂)

Nga Fig.17. shihet se gjatë muajve qershor deri në korrik të vitit 2012, emisionet e SO₂ kanë qenë shumë të ulëta në krahasim me vlerat maksimale të lejuara.




Fig.17. Vlera mesatare e SO₂ në mg/Nm³ gjatë muajve Qershor, Korrik, Gusht të vitit 2012 në Sharrcem.

¹⁰ Raporti për gjendjen e mjedisit në KEK për vitin 2012

¹¹ Raportet mujore, SHARRCEM, 2012

Oksidet e azotit (NOx)

Nga Fig.18. shihet se gjatë muajve Qershor deri në Korrik të vitit 2012, emisionet e NOx janë nën vlerën maksimale të lejuar.




Fig.18. Vlerat mesatare e NOx në mg/Nm³ gjatë muajve Qershor, Korrik, Gusht të vitit 2012 në Sharrcem.

Vlerësimi i Emisoneve në Ferronikel

Për përcaktimin e emisioneve në ajër Ferronikeli bënë matje në disa pika monitoruese¹²: oxhaku i furrave rrotulluese, oxhaku i konvertorëve, oxhaku i furrave elektrike, ngrohja dhe oxhaku tharës. Më poshtë janë prezantuar të dhëna për monitorimin e emisioneve të Pluhurit, SO₂ dhe NOx në furrën rrotulluese.

Rezultatet e më poshtme janë dhënë në njësine mg/m³, dhe jo në mg/Nm³ për çka edhe nuk është bërë krahasimi i tyre me vlerën maksimale të lejuar.

Emisionet e matura në furrën rrotulluese në vitin 2012

Tabela.8. Emisionet e matura të pluhurit në vitin 2012

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Emisioni i pluhurit mg/m³ në 2012		117.4	55.38	44.62	91.22	50.49	64.36	76.9	70.13	86.95	83.2	103.53
VML	50 mg/Nm³											

Tabela.9. Emisionet e matura të SO₂ në vitin 2012

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Emisioni i SO ₂ mg/m³ në 2012		1.54	504	1.47	2.03	770	800.8	948.8	848	746	708	807.4
VML	800 mg/Nm³											

Tabela.10. Emisionet e matura të NOx në vitin 2012

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Emisioni NOx mg/m³ në 2012		181	125	269	158	415	95	345	198	190	326	320
VML	400 mg/Nm³											

¹² Raportet mujore nga NewCoFerronikeli, 2012

2.2 Monitorimi dhe Vlerësimi i Cilësisë së Ajrit

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë realizohet nga IHMK dhe nga disa prej operatorëve ekonomik sikur janë: Ferronikeli dhe KEK-u .

2.2.1 Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr.03/L-025, Ligji i Mbrojtjes së Ajrit nga ndotja, Nr.03/L-160 dhe Ligjit për Veprimtarin Hidrometeorologjike, Nr.02/L-79, MMPH, respektivisht IHMK është e obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë teritorin e Kosovës.

Spektori i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë posedon:

- Rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit me matje automatike;
- Laboratorin e analizave kimike të ajrit për përcaktimin e ndotësve inorganik dhe organik në ajër;
- Laboratorin për përgatitjen e mostrave të ajrit për analizë laboratorike;
- Laboratorin për kalibrimin e analizereve të ajrit.

Nga fundi i vitit 2009 ka filluar së funksionuari stacioni i parë i monitorimit automatik të cilësisë së ajrit i vendosur në Prishtinë, në oborrin e IHMK.

Numri i stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është caktuar në bazë të studimit preliminar për përcaktimin e pikave monitoruese, bazuar në kriteret e direktivës 2008/50/EC dhe në "Udhëzimin Administrativ për Kriteret për Përcaktimin e Pikave Monitoruese Numrin dhe Shpeshtësinë e Matjeve, Metodologjinë e Punës, Formën dhe Kohën e Raportimit të të Dhënave", Nr.15/2010.

Në studimin e lartpërmendur është vendosë që rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë të ketë 9 stacione të monitorimit automatik dhe një (1) stacion monitorues mobil. Është bërë edhe zonimi, kështu që Kosova do të ketë një aglomerat (Prishtinë) dhe pjesa tjetër e vendit do të formojnë një zonë.

Gjatë vitit 2011-2012 rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë është paisur me 5 stacione fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit të cilat janë donacion nga Zyra ndërlidhëse e KE (Projekt i MMPH dhe IPA-s). Stacionet janë të pajisur me analizorë automatik të dioksidit të sulfurit (SO_2), oksideve të azotit (NO_x), monoksidit të karbonit (CO), ozonit (O_3), analizator i grimcave të suspenduara $\text{PM}_{10}/\text{PM}_{2.5}$ (me fraksionatorin për PM_{10} dhe $\text{PM}_{2.5}$) mostrues të grimcave PM_{10} dhe $\text{PM}_{2.5}$ si dhe senzoret për matjen e parametrevë meteorologjik si: temperatura, lagështija relative dhe shtypja e ajrit si dhe drejtimi dhe shpejtësia e erës. Këto stacione janë vendosur në: Gjilan, Hani i Elezit, Shtërpc-Brezovicë, Prizren dhe Pejë.

Në përgjithësi rrjeti i monitorimit në Kosovë do të ketë 9 stacione fikse të monitorimit automatik të cilësisë së ajrit, të cilat janë të shpërndara në 8 komuna (Tab.11) dhe një (1) stacion mobil (lëvizës).




Harta 1. Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë

Tab.11. Stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë (pa stacionet e monitorimit në zonën e KEK-ut)

Kodi lokal i stacionit	Emri i stacionit	Menagjues	Tipi i stacionit	Parametrat e matur
KS0101*	Prishtine-HMIK	IHMK	Sfodni Suburban	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KS0102*	Prishtine-Oborri ish-Rilindja	IHMK	Trafik urban	NO ₂ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KS0103*	Drenas-Oborri i Komunës	IHMK	Sfondi Urban	SO ₂ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KS0204*	Mitrovicë-Stacioni i Meteorologjisë	IHMK	Sfondi Urban	CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KS0305	Pejë- Shkolla fillore "Lidhja e Prizrenit"	IHMK	Sfondi Urban	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KS0406	Prizren- Oborri i Komunës	IHMK	Sfondi Urban	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KS0507*	Brezovica-Zona e skijimit	IHMK	Sfodni Rural	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KS0508	Hani i Elezit- Shkolla fillore "Ilaz Thaqi"	IHMK	Trafik suburban/sfodni industrial	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KS0609	Gjilan-Oborri i Komunës	IHMK	Trafik urban	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
*Stacionet të cilat kanë qenë jashtë funksionit gjatë vitit 2012				

2.2.2. Zgjerimi i rrjetit të monitorimit

Nga fundi i vitit 2012, me mbështetjen e Bankës Botërore, MZHE ka financuar blerjen e tri stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit në zonën e KEK-ut (shih Tab. 12). Nga fundi i dhjetorit të 2012 është arritur marrëveshja në mes të MZHE dhe MMPH që këto stacione të kalojnë në pronësi të MMPH dhe të menaxhohen nga AMMK/IHMK. Këto stacione janë inkorporuar në rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë dhe janë reprezentative për monitorimin e zonës industriale.



Harta.2. Lokacionet e stacioneve monitoruese në zonën e KEK-ut

Tab.12. Stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit në zonën e KEK-ut (zona industriale)

Kodi lokal i stacionit	Emri i stacionit	Menagjues	Tipi i stacionit	Parametrat e matur
KSo110	Obiliq- Qendra e mjekësis familjare	IHMK	Sfondi Industrial	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KSo111	Dardhishtë-Shkolla fillore	IHMK	Sfondi Industrial	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}
KSo112	Palaj-Kosova Mont	IHMK	Sfondi Industrial	SO ₂ , NO ₂ , CO, O ₃ , PM ₁₀ /PM _{2.5}

Nga fundi i vitit 2012 është bërë marrëveshja në mes të IKSHF dhe MMPH/AMMK që dy stacionet e IKSHF për monitorim të cilësisë së ajrit, të kalojnë nën menaxhimin e AMMK/IHMK dhe ato tani janë pjesë e rrjetit kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit të Kosovës.

Duke marrë parasysh mbështetjet nga institucionet tjera si dhe marrëveshjet e realizuara me MMPH, rrjeti aktual i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë disponon me gjithsej 12 stacione, fiksë moni-

toruese dhe një (1) stacion mobil të cilat menaxhohen nga MMPH/ AMMK/ IHMK (pa i llogaritur dy stacionet e IKSH, të cilat ende nuk janë funksionale).

Frekuenca e matjeve – frekuenca e matjeve është e rregulluar me Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 për “Kriteret për Përcaktimin e Pikave Monitoruese për Cilësinë e Ajrit, Numrin dhe Shpeshtësinë e Matjeve, Klasifikimin e Ndotësve të Cilët Monitorohen, Metodologjinë e Punës, Formën dhe Kohën e Raportimit të të Dhënave”.

Normat e lejuara për cilësinë e ajrit- Normativat e cilësisë së ajrit në Kosovë janë të rregulluara me Udhëzimin administrativ për Vlerat Kufitare- Normat e cilësisë së Ajrit , Nr.02/2011.

2.2.3. VLERËSIMI I CILËSISË SË AJRIT

Vlerësimi i cilësisë së ajrit është bërë nga të dhënat e mbledhura nga monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ajrit në Kosovë, (Gjilan, Hani i Elezit, Prizren, Pejë dhe Drenas) gjatë vitit 2012¹³.

Shqyrtimi i të dhënave të mbledhura është trajtuar duke iu referuar vlerave kufitare për periudha të ndryshme të ekspozimit, vlerave të synuara, vlerave kufitare të pragut të lartë dhe pragut të ultë të vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe ekosistemit, të përcaktuara me Direktiven 2008/50 EC dhe Udhëzimin administrative për vlerat kufitare- normat e cilësisë së ajrit Nr.02/2011.

Rezultatet nga monitorimi i cilësisë së ajrit

Te dhënat e prezentuara në raport janë nga matjet e realizuara nga sistemi automatik i monitorimit të vazhdueshëm në 4 stacione monitoruese fikse dhe në një stacion monitorues mobil. Janë monitoruar parametrat si : dyoksid sulfuri (SO_2), dyoksid të azotit (NO_2), Ozon (O_3), monoksid karboni (CO) dhe grimca të suspenduara PM_{10} dhe $\text{PM}_{2.5}$. Në secilin nga këto stacione janë matë edhe parametrat meteorologjik si: shpejtësia e erës, drejtimi i erës, temperatura, shtypja dhe lagështija relative e ajrit. Të dhënat nga monitorimi i cilësisë së ajrit gjatë vitit 2012 për të gjitha stacionet e monitorimit janë prezantuar në figurat vijuese.




Fig.19.Vlerat mesatare mujore të SO_2 ($\mu\text{g}/\text{m}^3$) gjatë vitit 2012

13 Raporti vjetor i monitorimit të cilësisë së ajrit-2012, IHMK




Fig.20.Vlerat mesatare mujore të NO₂(ug/m³) gjatë vitit 2012




Fig.21.Vlerat mesatare mujore të CO(mg/m³) gjatë vitit 2012




Fig.22.Vlerat mesatare mujore të O₃ (µg/m³) gjatë vitit 2012




Fig.23.Vlerat mesatare mujore të PM₁₀ (µg/m³) gjatë vitit 2012




Fig.24.Vlerat mesatare mujore të PM_{2.5}(ug/m³) nga monitorimi i ajrit gjatë vitit 2012

Analiza e të dhënave (rezultateve) nga monitorimi i cilësisë së ajrit

Analiza e të dhënave (rezultateve) për vlerësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është bërë, duke marrë si pikë krahasimi standardet e BE-së nga Direktiva 2008/50/EC, mbi cilësinë e ajrit dhe Udhëzimin administrative për vlerat kufitare- normat e cilësisë së ajrit, Nr.02/2011.

Dyoksidi i sulfurit (SO₂)

Në tabelën e poshtëshënuar është bërë vlerësimi i ndotjes së ajrit me SO₂ duke bërë një krahasim të përqendrimit të SO₂ me vlerat kufitare, shih Tab.13.

Tab.13.Vlersimi i koncentrimit të SO₂ në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011

Objektivi	1 orë	24-orë
Vlera kufitare për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	S'ka tejkalime	S'ka tejkalime
Pragu i alarmit	S'ka tejkalime	-
Pragu i lartë i vlersimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	-	S'ka tejkalime
Pragu i ulët i vlersimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	-	S'ka tejkalime

Dyoksidi i Azotit (NO₂)

Vlerësimi i ndotjes së ajrit me NO₂ është bërë duke krahasuar rezultatet e NO₂ me vlerat kufitare të tijë, të cilat janë dhënë në tabelën e poshtëshënuar, shih Tab.8.

Tab.14.Vlersimi i koncentrimit të NO₂ në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011

Objektivi	1 orë	Vjetore
Vlera kufitare për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	S'ka tejkalime	S'ka tejkalime
Pragu i alarmit	S'ka tejkalime	-
Pragu i lartë i vlersimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionin e Hanit të Elezit dhe në Gjilan	S'ka tejkalime
Pragu i ulët i vlersimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionin e Hanit të Elezit dhe në Gjilan	S'ka tejkalime

Vlera kufitare e mesatares 1 orëshe dhe e mesatares vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, nuk tejkalon në asnjërin stacion të monitorimit .

Vlera kufitare 1 orëshe e pragut të lartë të vlerësimit, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (140 ug/m³), ka tejkaluar në stacionin e monitorimit në:

- ✓ Hanin e Elezit -----1 rast dhe
- ✓ Gjilan -----2 raste

Vlera kufitare 1 orëshe për pragu e ulët të vlerësimit, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (100 ug/m³), ka tejkaluar në stacionin e monitorimit në :

- ✓ Hanin e Elezit -----3 raste dhe
- ✓ Gjilan -----6 raste

Numri maksimal i tejkalimeve të lejuar gjatë 1 viti është 18 raste, gjë që nuk tejkalohet ky numër.

Monoksidi i karbonit (CO)

Për të bërë vlerësimin e ndotjes së ajrit me CO është bërë krahasim i përqendrimit të CO nga rezultatet e monitorimit me vlerat kufitare të cilat janë dhënë në tabelën e poshtëshënuar, Tab.15.

Tab.15.Vlersimi i koncentrimin të CO në ajrin ambient, sipas kërkesave të Direktivës 2008/50 dhe UA Nr.02/2011

Objektivi	8 orë
Vlera kufitare për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	S'ka tejkalime
Pragu i lartë i vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	S'ka tejkalime
Pragu i ulët i vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	S'ka tejkalime

Ozoni (O₃)

Një krahasim i rezultateve monitoruese të ozonit me vlerat kufitare është dhënë në Tabelën e poshtëshënuar, Tab.16. nga ku edhe është vlerësuar ndotja e ajrit me O₃.

Tab.16.Vlersimi i përqendrimit të O₃ në ajrin ambient, sipas kërkesave të Direktivës 2008/50 dhe UA Nr.02/2011

Objektivi	1 orë	8-orë*
Pragu i informimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionin e Hanit të Elezit	-
Pragu i alarmit	S'ka tejkalime	-
Objektivi afatgjatë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	-	Tejkalon në stacionet në Han të Elezit dhe në Pejë
Vlera e synuar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	-	Tejkalon në stacionet në Han të Elezit dhe në Pejë

Vlera kufitare e Pragut të informimit, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (180ug/m³), është tejkaluar një (1) rast gjatë tërë vitit në stacionin e Hanit të Elezit dhe ka arritë vlerën në 189,62 ug/m³, ndërsa në stacionet tjera nuk janë regjistruar tejkalime.

Vlera kufitare e Objektivi afatgjatë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut(120ug/m³), tejkalon në stacionet:

- ✓ Pejë -----4 ditë
- ✓ Hani i Elezit-----25 ditë

Vlera e Objektivi afatëfgjatë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut lejohet të tejkalojë maksimum 25 ditë brenda vitit.

Vlera e synuar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (120ug/m³) tejkalon në stacionet:

- ✓ Pejë -----4 ditë
- ✓ Hani i Elezit-----25 ditë

PM₁₀ - Materja grimcore me diametër aerodinamik<10µm

Vlerësimi i ndotjes së ajrit me grimcat PM₁₀ është bërë duke krahasuar përqendrimin e PM₁₀ nga rezultatet e monitorimit me vlerat kufitare, ku është dhënë në Tabelën e poshtëshënuar, Tab.17.

Tab.17.Vlersimi i koncentrimet të PM_{10} në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011

Objektivi	24 orë	Viti
Vlera kufitare, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionet: Prizren, Hani i Elezit dhe Gjilan	Tejkalon në Gjilan dhe Prizren
Pragu i lartë i vlerësimit, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionin e Gjilanit, Hanit të Elezit	Tejkalon në stacionin e Gjilanit, Hanit të Elezit
Pragu i ulët i vlerësimit, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionin e Gjilanit, Hanit të Elezit	Tejkalon në stacionin e Gjilanit, Hanit të Elezit

Vlera e përqëndrimit mesatar vjetor në stacionin e monitorimit në Gjilan arrinë në $50,2 \mu\text{g}/\text{m}^3$ dhe tejkalon vlerën kufitare të mesatares vjetore ($40 \mu\text{g}/\text{m}^3$) si dhe vlerën kufitare të pragut të lartë të vlersimit ($28 \mu\text{g}/\text{m}^3$) dhe pragut të ulët të vlersimit ($20 \mu\text{g}/\text{m}^3$), për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, për periudhën e mesatares vjetore.

Përqëndrimi mesatar vjetor në stacionin e monitorimit në Han të Elezit ishte $35,54$ dhe tejkalon vlerën kufitare të pragut të lartë të vlersimit ($28 \mu\text{g}/\text{m}^3$) dhe pragut të ulët të vlersimit ($20 \mu\text{g}/\text{m}^3$), për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, për periudhën e mesatares vjetore, por nuk tejkalon vlerën kufitare të mesatares vjetore ($40 \mu\text{g}/\text{m}^3$).

Ndërsa përqëndrimi mesatar vjetor në stacionin e monitorimit në Prizren ishte $42,47 \mu\text{g}/\text{m}^3$ dhe tejkalon vlerën kufitare të mesatares vjetore ($40 \mu\text{g}/\text{m}^3$) si dhe vlerën kufitare të pragut të lartë të vlersimit ($28 \mu\text{g}/\text{m}^3$) dhe pragut të ulët të vlersimit ($20 \mu\text{g}/\text{m}^3$), për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, për periudhën e mesatares vjetore.

Nga stacioni i monitorimit në Pejë numri i vlerave valide ishte shumë i ulët, d.m.th nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për të bërë vlerësimin e gjendjes së ajrit nga rezultatet e mbledhura.

Tejkalimet e vlerës kufitare ditore të PM_{10}

Numri i ditëve me tejkalime të vlerës kufitare ditore të PM_{10} për çdo muaj është paraqitë në fig.25. për të gjitha stacionet e monitorimit ku ka pasë tejkalime të vlerës kufitare ditore.




Fig.25. Numri i ditëve me tejkalim të vlerës kufitare ditore të PM_{10} ($50 \mu\text{g}/\text{m}^3$)

Stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit në Gjilan- kishte 81 ditë me tejkalime të vlerës kufitare ditore të PM_{10} ($50\mu g/m^3$), gjatë tërë vitit, ndërsa lejohen 35 ditë me tejkalime brenda 1 viti, d.m.th është tejkaluar numri i lejuar i ditëve me tejkalime të vlerës kufitare ditore.

Vlera kufitare ditore e pragut të lartë të vlerësimit, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ($35\mu g/m^3$), ishte tejkaluar në 155 ditë (raste). Vlera kufitare ditore e pragut të ulët të vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ($25\mu g/m^3$), ishte tejkaluar në 175 ditë (raste).

Stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit në Hanin e Elezit - gjatë vitit 2012 kishte 26 ditë me tejkalime të vlerës kufitare ditore të PM_{10} ($50\mu g/m^3$), për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, gjë që nuk tejkalon numrin e lejuar të ditëve me tejkalime gjatë një viti (35 ditë gjatë një viti).

Vlera kufitare ditore e pragut të lartë të vlerësimit, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ($35\mu g/m^3$), ishte tejkaluar 96 ditë (raste) gjatë vitit 2012. Vlera kufitare ditore e pragut të ulët (të poshtëm) të vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ($25\mu g/m^3$), ishte tejkaluar 147 ditë (raste) gjatë vitit 2012.

Stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit në Prizren - gjatë vitit 2012 kishte 28 ditë me tejkalime të vlerës kufitare ditore të PM_{10} ($50\mu g/m^3$), për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, nga ku vërehet se nuk tejkalon numrin e lejuar të ditëve me tejkalime gjatë një viti (lejohen tejkalime në 35 ditë gjatë një viti).

Vlera kufitare ditore e pragut të lartë (të sipërm) të vlerësimit, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ($35\mu g/m^3$), ishte tejkaluar 50 ditë (raste).

Vlera kufitare ditore e pragut të ulët (të poshtëm) të vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ($25\mu g/m^3$), ishte tejkaluar 70 ditë (raste).

$PM_{2.5}$ - Materja grimcore me diametër aerodinamik $<2.5\mu m$

Një krahasim i rezultateve monitoruese me vlerat kufitare është dhënë në Tabelën e poshtëshënuar. Vlerësimi i ndotjes së ajrit me grimcat $PM_{2.5}$ është bërë duke krahasuar përqëndrimin e $PM_{2.5}$ nga rezultatet e monitorimit me vlerat kufitare, ku është përshkruar në Tabelën e poshtëshënuar, tab.18.

Tab.18.Vlerësimi i koncentrimin të $PM_{2.5}$ në ajrin ambiantal (mjedisor), sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011

Objektivi i vlerave kufitare	vjetore
Vlera kufitare për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionet: Gjilan, Prizren dhe Hani i Elezit
Pragu i lartë i vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionet në Gjilan, Hanit të Elezit dhe Prizren
Pragu i ulët i vlerësimit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Tejkalon në stacionet në Gjilan, Hanit të Elezit dhe Prizren

Stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit në Gjilan - përqëndrimi mesatar vjetor i $PM_{2.5}$ ($25\mu g/m^3$) në stacionin e monitorimit në Gjilan arrinë në $18,6\mu g/m^3$ dhe tejkalon vlerën kufitare të pragut të lartë të vlerësimit ($17\mu g/m^3$) dhe pragut të ulët të vlerësimit ($12\mu g/m^3$), për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit në Hanin e Elezit - përqëndrimi mesatar vjetor i $PM_{2.5}$ ishte $21,9\mu g/m^3$ dhe tejkalon vlerën kufitare të pragut të lartë të vlerësimit ($17\mu g/m^3$) dhe pragut të ulët të vlerësimit ($12\mu g/m^3$), për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit në Prizren - po ashtu edhe në stacionin e monitorimit në Prizren përqëndrimi i vlerës mesatares vjetore arrinë në $28,4\mu g/m^3$ që d.m.th tejkalon vlerën kufitare të pragut të lartë të vlerësimit ($17\mu g/m^3$) dhe pragut të ulët të vlerësimit ($12\mu g/m^3$), për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

2.2.4. CILËSIA E AJRIT NË ZONAT INDUSTRIALE

Në zonat industriale cilësia e ajrit është monitoruar nga vetë operatorët ndotës, si: Ferronikeli dhe KEK-u.

Të dhënat për cilësinë e ajrit nga Ferronikeli¹⁴

Për vlerësimin e cilësisë së ajrit në Ferronikel gjatë vitit 2012 janë marrë të dhënat e bëra për moni-

¹⁴ Raportet mujore nga Ferronikeli, 2012

torimin e PM_{10} dhe SO_2 në dy pika monitoruese: Airpointer 1 dhe Airpointer 2. të cilat janë instaluar në zonën e fabrikës.

PM_{10} - Materja grimcore me diametër aerodinamik $<10\mu m$

Nga fig. 26. shihet se vlera maksimale e mesatares mujore të PM_{10} në lokacionin airpointer 1 arrin në $121,78 \mu g/m^3$ në muajin Nëntor ndërsa në airpointer 2 arrin në $164,99 \mu g/m^3$ në muajin Maj.




Fig. 26. Vlera mesatare mujore e PM_{10} në pikat matëse: Airpointer 1 dhe Airpointer 2

Dyoksidi i sulfurit (SO_2)




Fig.27. Vlera mesatare mujore e SO_2 në pikat matëse: Airpointer 1 dhe Airpointer 2

Nga Fig.27. shihet se vlera maksimale e mesatares mujore të SO_2 në lokacionin airpointer 1 arrin në $95,67 \mu g/m^3$ ndërsa në airpointer 2 arrin në $19,59 \mu g/m^3$.

Në zonën industriale të KEK-ut, kryhet monitorimi i cilësisë së ajrit për këto parametra: SO₂, blozë, thërmija ajrore, dhe aerosediment.

Më poshtë është paraqitur grafikisht rezultati për SO₂ në INKOS - TC A dhe Kastriot – TC B për vitin 2012.




Fig.28. Vlera mesatare mujore e SO₂ në INKOS-TCA dhe në Kastriot-TCB për vitin 2012

Nga fig. 28. shihet se vlera maksimale e mesatares mujore në TCA arrin në 24 µg/m³ ndërsa në TCB arrin në 32,7 µg/m³.

2.2.5. GJENDJA METEOROLOGJIKE NË VENDËMONITORIMET E CILËSISË SË AJRIT

Në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit janë të integruar edhe parametrat meteorologjik. Për të plotësuar paraqitjen e të dhënave të mbledhura nga rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit, analizohen edhe të dhënat përmblledhëse të parametrave meteorologjik, të cilët ndikojnë në mekanizmin e akumulimit, transportit, difuzionit, shpërndarjes dhe transformimit të ndotësve në atmosferë. Parametrat meteorologjik që monitorohen në këto stacione janë:

- Temperatura e ajrit
- Shtypja atmosferike
- Lagështia e ajrit
- Drejtimi dhe shpejtësia e erës

Përshkrimi i gjendjes meteorologjike është një përshkrim përmblledhës mbi ndikimin e meteorologjisë në dukuritë e mundshme, sidomos në formimin e Ozonit dhe akumulimin maksimal të PM₁₀.

Një ndër parametrat meteorologjik më të rëndësishëm të cilët ndikojnë në shpërndarjen e ndotësve në ajër janë drejtimi dhe shpejtësia e erës duke mos përfshirë edhe rëndësinë e parametrave tjerë meteorologjik të cilët kanë rëndësinë e vet në këtë dukuri.

Drejtimet dominante të erës janë paraqitë në figurat e poshtëshënuara.

¹⁵ Raporti për gjendjen e mjedisit në KEK për vitin 2012




Fig. 29. Trëndafili i erës për stacionin e Gjilanit




Fig.30. Trëndafili i erës për stacionin e Hanit të Elezit




Fig.31. Trëndafili i erës për stacionin e Prizrenit

2.3. Konkluzionet dhe Rekomandimet

Konkluzionet

Nga vlerësimi dhe përpunim i të dhënave të mbledhura vërehet se tejkalimet më të larta në të tri stacionet e monitorimit kanë qenë me ndotësin PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, nga ku mundë të konstatojmë se problem parësorë i ndotjes së ajrit në Kosovë është :

- Ndotja me grimcat PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, të cilët atakojnë shëndetin e njeriut, vegjetacionin, botën shtazore dhe rrezikojnë materialet.
- Ngritja e përqëndrimit të PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ në sezonin dimëror është kontribut shtesë në emisionet e gazrave që vije nga djegijet për ngrohjen e shtëpive.
- Bazuar në këto të dhëna për cilësinë e ajrit, mundë të vlerësohet se ajri në Kosovë ka cilësi jo të kënaqshme.

Rekomandimet

Që të kemi një gjendje sa më reale mbi cilësinë e ajrit në Kosovë , rekomandojmë që :

- Të sigurohen mjete financiare për mirëmbajtjen e pajisjeve monitoruese;
- Të shtohet numri i parametrave monitorues sipas kërkesave të parashtruara në ligjet dhe udhëzimet që rregullojnë çështjet e ndotjes së ajrit;
- Të merren hapa konkret nga ana e MMPH dhe institucioneve përgjegjëse në uljen e ndotjes nga PM_{10} dhe $PM_{2.5}$.

3. Uji

3.1. Resurset ujore

Nga territori i Kosovës, në vitin me lagështi mesatare rrjedhin 3.6×10^9 m³ (miliard) ujë (121.2 m³ / sec), ndërsa vëllimi i përgjithshëm i akumuluar në akumulimet ekzistuese është 569.690.000 m³, që paraqet vetëm 15,7% të sasisë së përgjithshme mesatare. Pjesa më e madhe e lumenjve i takon pellgut të Detit të Zi 50.7%, Detit Adriatik 43.5% dhe Detit Egje 5.8%. Shumica e lumenjve karakterizohen me rrjedhje të çrregullt sezonale. Rrjedhjet e lumenjve janë më të larta gjatë dimrit ose në fillim të pranverës.

Sipërfaqja ujëmbledhëse topografike e Kosovës është 11.645 km², çka do të thotë se vetëm për 758 km² apo 6.5 % ka mospërputhje me sipërfaqen e përgjithshme të saj.

Hidrografia e rrjedhave ujore të Kosovës ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci.

Drini i Bardhë ka gjatësi më të madhe në kilometra brenda territorit të Kosovës me 122 km, ndërsa Lumëbardhi i Prizrenit më të vogël me 31 km. Të dhënat për gjatësinë brenda territorit të Kosovës për lumenjtë kryesorë janë prezantuar në tabelën 19.

Tabela 19 : Gjatësia në kilometra e lumenjve kryesorë të Kosovës¹⁶

Emërtimi	Gjatësia në km brenda territorit të Kosovës	Sipërfaqja m ²
Drini i Bardhë	122	4.622
Sitnica	90	2.873
Lumëbardhi i Pejës	62	424.9
Morava e Binçës	60	1.552
Lepenci	53	679.0
Ereniku	51	510.3
Ibri	42	1.155
Lumëbardhi i Prizrenit	31	262.6

Rrjedhat lumore të Kosovës derdhën në tre ujëmbledhës detarë: Deti i Zi, Deti Adriatik dhe Deti Egje. Lumenjtë kryesorë të cilët i përkasin ujëmbledhësit të Detit të Zi janë: Ibri, Sitnica me degët; (Llapi, Drenica), dhe Morava e Binçës. Detit Adriatik i përkasin: Drini i Bardhë me degët (Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, Lumëbardhi i Prizrenit, lumi i Klinës, Ereniku, Mirusha, Toplluha dhe Plava). Ndërsa, lumi i Lepencit me degën kryesore (Nerodime) i përkasin Detit Egje.

Vija ujëndarëse (pellgjet ujëmbledhëse), kanë rrjedhje në drejtime të ndryshme. Koeficienti rrjedhës sillet prej 3.93 l/sec/km² (Morava e Binçës) deri 42.46 l/sec/km² (Lumëbardhi i Deçanit). Për më shumë shiko tabelën 20.

Tabela 20. Pellgjet ujëmbledhës, sipërfaqja, sasia rrjedhëse e ujit dhe vend derdhja

Nr.	Pellgu	S[km ²]	Q[m ³ /s]	q[l/s*km ²]	Rrjedhja vjetore [mil.m ³]	Kahja e rrjedhës
1	Drini i Bardhë	4649	61.0	14.6	2.200	Detit Adriatik
2	Ibri	4009	32.6	8.13	771	Deti i Zi
3	Morava e Binçës	1564	6.1	4.35	330	Deti i Zi
4	Lepenci	0.685	8.7	12.7	307	Deti Egje

Rrjeti hidrometrik përbëhet nga 27 stacione. Në të gjitha stacionet, niveli i ujit matet në mënyrë automatike dhe permanente përmes sensorëve, ç'do 15 min. dhe 1 orë. Po ashtu në çdo stacion hi-

¹⁶ Disa fakte për mjedisin, ESK, 2007

drometrik janë të vendosura latat përmes të cilave lexohet niveli dhe bëhet krahasimi me sensor. Në disa stacione hidrometrike është i vendosur sistemi me vinç përmes të cilit matet shpejtësia. Matja e shpejtësisë së ujit për të llogaritur prurjet ($Q = m^3/s$), bëhet në disa stacione hidrometrike nëpër pellgje të Kosovës.

Në tabelën 21 janë prezantuar të dhënat për vlerat mesatare vjetore të prurjeve vetëm për ato stacione që kanë qenë në funksion gjatë viteve 2010-2012.

Tabela 21 : Vlerat mesatare vjetore të prurjeve ($Q = m^3/s$) të stacioneve hidrometrike sipas stacioneve¹⁷

NR.	LUMI	STACIONI	2010	2011	2012
1.	Bistrica Pejës	Drelaj	0.503	0.438	-
2.	Bistrica Pejës	Grykë	0.614	0.530	-
3.	Mirusha	Mirushë	0.832	-	-
4.	Ereniku	Gjakovë	0.690	0.519	0.597
5.	Bistrica Prizrenit	Prizren	0.463	0.361	0.589
6.	Bistrica Prizrenit	Vlashnje	0.914	-	-
7.	Drenica	Drenas	1.443	-	-
8.	Llapi	Lluzhan	1.141	0.843	0.699
9.	Sitnica	Vragoli	0.802	-	-
10.	Llapi	Millosevë	0.990	0.543	0.566
11.	Morava Binçës	Viti	0.333	0.290	0.216
12.	Nerodime	Kaçanik	0.233	-	-
13.	Lepenci	Hani Elezit	0.692	0.619	0.547
14.	Lepenci	Brod	0.492	0.397	0.433
15.	Brod	Mlik	0.763	0.579	0.638



Foto: Stacioni hidrometrik në lumin Bistrica e Pejës – Gryka e Rugovës dhe sistemi i vinçit për matjen e rrjedhës së ujit

17 Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Akumulacionet sipërfaqësore- Për të plotësuar nevojat për ujë të pijshëm, ujitje, peshkim, turizëm dhe për prodhimin e energjisë elektrike, në shumë vende janë ndërtuar diga për të grumbulluar ujin e përrrenjve dhe lumenjve, gjatë stinëve me prurje të mëdha dhe për ta përdorur atë gjatë stinëve kur reshjet janë shumë të vogla dhe kërkesa është shumë e madhe.

Kosova ka disa akumulacione sipërfaqësore ose sikur njihen ndryshe liqene artificiale (Batllava, Gazivoda, Radoniqi, Përlepnica dhe Badovci) si dhe një numër të liqeneve të vegjël për ujitje. Në tabelën 22 janë prezantuar karakteristikat themelore të akumulacioneve.

Tabela 22: Akumulacionet kryesore në Kosovë, sipërfaqja, rrjedhja ujore dhe vëllimi

Emri i akumulacionit	Ujërrjedhja (lumi)	Sipërfaqja e pellgut [km ²]	Rrjedhja mesatare [m ³ /sek.]	Vëllimi akumulacionit Milion [m ³]	
				Shfrytëzues	Gjithsej
Gazivoda	Ibër	1060	13.5	350	390
Pridvorci	Ibër	-	-	0.435	0.49
Batllava	Batllavë	226	1.06	25.1	30
Badovci	Gračankë	103	1.05	27.0	31.6
Livoçi	Livoç	53.6	-	-	-
Radoniqi	Lumëbardhi i Deçanit	130	0.16	102	113

3.2. Monitorimi i cilësisë së ujërave

Monitorimin e ujërave të lumenjëve në territorin e Republikës së Kosovës e bënë Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjëve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Ky rrjet monitorimi ka gjithësej 54 stacione monitoruese. 10 parametra fizik (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Pellgu i Drinit të Bardhë përfshin 10 lumenj me 23 stacione monitoruese (10 stacione janë referente dhe monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 13 janë stacione përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit).

Pellgu i Ibrit; përfshin 8 lumenj me 18 stacione monitoruese (5 stacione janë referente dhe monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 13 janë stacione përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit).

Pellgu i Moravës së Binqës përfshin 2 lumenj me 6 stacione monitoruese (2 stacione janë referente që monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 4 janë stacione përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit).

Pellgu i Lepencit; përfshin 2 lumenj me 7 stacione monitoruese (2 stacione janë referente dhe monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 13 janë stacione përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit).

Kodet e stacioneve monitoruese në të katër Pellgjet Lumore janë prezantuar në tabelën vijuese.


Tabela 23: Kodet e stacioneve monitoruese

Kodi	Lokacioni	Lumi	Venderdhja
RV01_032	Klina në Klinë	Lumi Klina,	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_041	Drelaj	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_042	Pejë Dalje	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_043	Grabanicë	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_051	Bajë e Malishevës	Lumi Mirusha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_052	Volljak	Mirusha Klinë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_061	Deçan Hyrje	Lumbardhi i Deçanit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_062	Kralan	Lumbardhi i Deçanit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_071	Jasiq	Ereniku Jasiq	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_072	Ura e Terzive	Lumi Erenik	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_081	Zhdrellë	Lumi Rimnik	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_082	Xërxë	Lumi Rimnik	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_091	Buqallë	Lumi Toplluha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_092	Piranë	Lumi Toplluha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_101	Prevallë	Lumbardhi i Prizrenit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_102	Vlashnje	Lumbardhi i Prizrenit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV02_011	Kushtovë	Ibri	Deti i Zi
RV02_012	Ibri Mitrovicë	Ibri	Deti i Zi
RV02_013	Kelmend	Ibri	Deti i Zi
RV02_021	Bablak	Sitnica	Deti i Zi
RV02_022	Sitnica Lipjan	Sitnica	Deti i Zi
RV02_023	Sitnica Vragoli	Sitnica	Deti i Zi
RV02_024	Sitnica Plemetin	Sitnica	Deti i Zi
RV02_025	Sitnica Nedačovc	Sitnica	Deti i Zi
RV02_026	Sitnica Mitrovicë	Sitnica	Deti i Zi
RV02_031	Murgullë	Llapi	Deti i Zi
RV02_032	Podujevë	Llapi	Deti i Zi
RV02_033	Llapi Milloshevë	Llapi	Deti i Zi
RV02_041	Bresje	Prishtëvka	Deti i Zi
RV02_051	Graqanka Vragoli	Graqanka	Deti i Zi
RV02_061	Krojmir	Drenica	Deti i Zi
RV02_062	Drenica Vragoli	Drenica	Deti i Zi
RV02_071	Petrovë	Lumi i Topillës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV02_072	Muzeqinë	Lumi Shtime	Deti i Zi
RV03_011	Kurbuliq	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_012	Kllokot	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_013	Uglar	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_014	MoravaDomorovc	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_021	Zebincë	Kriva reka	Deti i Zi
RV03_022	Kriva reka Domorovc	Kriva reka	Deti i Zi
RV04_011	Prevallë Subain	Lepenc	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_012	Lepenci Kaçanik	Lepenc	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_013	Hani i Elezit	Lepenc	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_021	Jezerc	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_022	Bifurkacioni	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_023	Gërlicë	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_024	Nerodimja Kaçanik	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje

HARTA E MONITORIMIT TË KUALITETIT FIZIKO-KIMIK TË UJRAVE SIPËRFAQSORE



Sistemi Informativ Mjedisor / GIS
Bazimi i të dhënave:
BIMK/ AMMK
Projeksioni: UTM WGS-84
Zona 34
Prill 2011



Harta 3: Stacionet e monitorimit të kualitetit fiziko-kimik të ujërave sipërfaqësore

Ky pellg ka sipërfaqe më të madhe se sa pellgjet e lumenjve të tjerë të vendit tonë. Rrjeti i monitorimit të këtij pellgu ka 23 stacione monitorimi të cilësisë fiziko-kimike, 3 nga këto stacione janë bazë të cilat i takojnë vetë lumit Drini i Bardhë duke filluar nga burimi i tij në bjeshkën e Radavcit mbi Pejë, pastaj stacioni tjetër monitorues i radhës është pas puqitjes së lumenjve Istog dhe lumit Klina në Klinë dhe stacioni i tretë i këtij lumi është vendosur pas puqitjes së lumenjve Lumëbardhi i Pejës dhe Deçanit, lumit Mirushë, Erenik, Rimnik dhe Toplluhë ndërsa vendndodhja e këtij stacioni është tek ura mbi lum në vendbanimin Gjonaj të Hasit. Cilësia e ujit përgjatë rrjedhës së tij ndryshon nga stacioni

në stacion sepse në burim ka cilësi tejet të mirë dhe pastaj në dy stacionet tjera ka ndotje që vijnë nga ujërat e pa trajtuara të cilat derdhen në të dhe në lumenjtë e cekur më lartë që janë nënPELLGJE të këtij lumi, po ashtu ndotja vjen edhe nga ujërat që bëjnë shpërlarjen e tokave bujqësore.

Në të gjitha burimet e lumenjve uji është i cilësisë shumë të mirë. Të dhënat e analizave fizik-kimike për këto pesë vjetët e fundit, tregojnë që këto ujëra i takojnë klasës së I. Ndryshimi i gjendjes fillon për rreth vendbanimeve me shkarkimin e ujërave të ndotur, shkarkimet e ujërave nga kolektorët e industrive përgjatë rrjedhës së këtij pellgu lumor. Po ashtu shkakëtar i kësaj ndotje është edhe hedhja e mbeturinave sidomos në vendet e pozicionimit të urave e edhe gjetkë.

Deri te pika e bashkimit me lumin Istog uji kryesisht është i cilësisë së mirë. Ndryshimet drastike fillojnë në rajonin Zllakuqan–Ruhot dhe Zllakuqan–Klinë. Te pika e puqitjes së Drinit të Bardhë me lumin Klina gjendja e tij bëhet e mjerueshme sepse rezultatet tregojnë për një kategori të IV të kualitetit. Pra uji i pellgut Drini i Bardhë ndotet nga shkarkimet e nën pellgjeve të cilat paraprakisht u janë nënshtruar ndikimeve njerëzore. Kjo gjendje vazhdon gjerë në Vllashnje te pika e shkarkimit të Lumëbardhit të Prizrenit.

Komente të përgjithshme për lumenjtë (nënpellgjet) e pellgut Drini i Bardhë

Lumi i Istogut (Istog)- Buron në bjeshkën mbi qytetin e Istogut me një pastërti të madhe me cilësi shumë të mirë dhe në krahasim me lumenjtë e tjerë ky lum deri në puqitje të tij në Drinin e Bardhë nuk pëson ndryshime të mëdha në cilësi, prandaj dhe nga monitorimi i gjertanishëm njihet si lumi më i pastërt në Kosovë.

Lumëbardhi i Pejës (Bistrica e Pejës)– Formohet nga disa burime përgjatë Grykës së Rugovës të cilat burime në stacionin e parë monitorues në Drelaj kanë cilësi fiziko-kimike të mirë, përderisa kjo cilësi në stacionin tjetër pas shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane dhe industriale pëson ndryshim, karakteristikë tek ky lum është se gjatë stinës së verës gjatë sezonit të ujitjes së tokave bujqësore ky lum shteron për një periudhë përafërsisht dymujore. Stacioni i tretë monitorues është në afërsi të Klinës para puqitjes me lumin e Drinit të Bardhë ku cilësia e tij është më e dobët.

Lumi Klina- Stacioni i parë monitorues ndodhet në Cerpule i cili nuk plotëson kriteret e të ashtuquajturës burim i parë ose amë sepse ai ndodhet larg këtij lokaliteti prandaj deri në këtë vend ndodhje aktiviteti njerëzor është mjaft i shprehur. Për këtë arsye dhe cilësia e tij është mjaftë e dobët në të dy stacionet monitoruese gjë që jep të kuptohet edhe nga rezultatet e analizave laboratorike të paraqitura më poshtë në grafikone.

Lumi Mirusha– Formohet në kodrinat mbi fshatin Bllacë të Therandës nga shumë mini burime, në fshatin Banjë e Malishevës (që në planin monitorues në të ardhmen do të mirret si pikë referente), merr formën e plot të lumit dhe prej aty i shtohet edhe ujërrjedha e burimit të fuqishëm sipërfaqësor që njihet me emrin Uligja e Banjës. Ky lum monitorohet vetëm në një stacion dhe atë në Volljak disa metra para puqitjes me lumin Drini i Bardhë cilësia e tij karakterizohet me turbiditet të vogël, sasia e oksigjen të tretur sillet ndërmjet 8.37-10.90 mg/l, përqëndrimi elektrik ne mes 587-638 $\mu\text{S}/\text{cm}$, pra i takon ujërave të lumenjve me cilësi mesatare.

Lumëbardhi i Deçanit (Bistrica e Deçanit)- Stacioni i parë i monitorimit sipas rrjetit të IHMK gjendet në km e 3 mbi qytetin e Deçanit mbi kishën e Deçanit ku cilësia e tij është shumë e mirë, stacioni tjetër ndodhet 10 m para puqitjes me lumin Drini i Bardhë në fshatin Kralan të Gjakovës, cilësia e tij në këtë stacion nuk është edhe aq alarmuese por ka ngritje të vlerave të parametrave në krahasim me stacionin e parë edhe në këtë lumë shkaktohet turbullirë e madhe për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i tij prej kompanive private vetëm disa dhjetëra metra mbi stacionin e monitorimit të këtij lumi.

Ereniku- Stacioni i parë i monitorimit të cilësisë së këtij lumi ndodhet në bjeshkët mbi fshatin Jasiq (KK Junik) aty ku nuk ka influencë nga aktivitetet njerëzore, cilësia e ujit është shumë e mirë. Stacioni i dytë sipas rrjetit të monitorimit është afër puqitjes me lumin e Drinit të Bardhë në afërsi të Gjakovës te Ura e Terzive, cilësia e këtij lumi në këtë stacion është e dobët si karakteristikë që është vërejtur gjatë analizave është prezenca e sasive të detergjenteve dhe se lumi gjithnjë ka shkumë mbi sipër-

faqe që është si rezultat i ndonjë veprimtarie për larjen e tekstileve (rrobave), autolarjeve apo edhe të ndonjë përdorimi tjetër të detergjenteve nga industritë të cilat veprojnë në atë region dhe ujërat e tyre i shkarkojnë fare pa trajtim adekuat paraprak edhe pse një shkarkim i tyre nuk është i lejuar.

Rimniku– Monitorimi i tij fillon në vendin e quajtur Zhdrellë jo larg nga burimi i tij, njihet si burim me përçueshmëri më të lartë (529 - 770 $\mu\text{S}/\text{cm}$) se të gjitha burimet e tjera dhe për përmbajtje të sasisë së konsiderueshme të metaleve të rënda. Stacioni i radhës është disa metra para puçitjes me lumin Drini i Bardhë në Xërxë i cili ka sasi të vogël të oksigjenit dhe sasi të madhe të jonit amonium, fosfateve etj.

Toplluha- Stacion fillestar për monitorimin e këtij lumi është në vendin e quajtur Buqallë mbi kompleksin turistik “SOLID” e Suharekës, uji i këtij lumi ka cilësi shumë të mirë në të gjithë parametrat e matur, përderisa në stacionin e dytë në fshatin Piranë disa dhjetëra metra para puçitjes me lumin e Drinit të Bardhë uji ka cilësi më të dobët, njihet si lumi permanent me turbullirë të lartë për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i lumit.

Lumëbardhi i Prizrenit (Bistrica e Prizrenit)- Fillon nga Prevala ka rrjedhë rrëke, stacioni i parë monitorues ndodhet po në grykën e Prevallës dhe ka cilësi mjaftë të mirë në të gjitha aspektet. Stacioni i dytë në rrjetë është në fshatin Vlashnje 3,5 km para puçitjes me lumin e Drinit të Bardhë dhe nëse e krahasojmë cilësinë e ujit të tij me stacionin e parë monitorues do të vërejmë një ndryshim të madh të ndikimit të të gjitha ujërave të ndotura të shkarkuara përgjatë rrjedhës së tij në të.

INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Për interpretimin e gjendjes së nën pellgjeve të lumit Drini i Bardhë, vlen e njëjta pasqyrë e ndryshueshmërisë në hyrje dhe dalje të tyre. Në vijim me anë të grafikoneve do të paraqesim një interpretim të vlerave mesatare vjetore (VMV¹⁸) të secilit parametër në secilin lum të këtij pellgu.

Sasia e oksigjenit të tretur (O_2 tretur)- në vazhdimësi qëndron në vlera të konsiderueshme gjatë rrjedhës së këtij lumi (pellgu) ku vlerat kanë variuar nga 6.34 mg/l O_2 deri në 11.79 mg/l O_2 në vitin 2008, vitin 2009 kishte vlera nga 5.09 mg/l O_2 deri në 11,38 O_2 mg/l O_2 . Viti 2010 tregon një ndryshim në vlerën mesatare për oksigjenin e tretur 7.52 mg/l O_2 nga vitet paraprake që silleshin nga 10.88 mg/l O_2 , në vitin 2011 kemi minimumin e vlerës 5.99 mg/l O_2 dhe maksimumin 8.99 mg/l O_2 . Viti 2012 paraqitet me një minimum të oksigjenit të tretur 6.61 mg/l O_2 dhe maksimum të vlerës mesatare vjetore 10.22 mg/l O_2 oksigjen i tretur.




Figura 32: Oksigjeni i tretur në pellgun e Drinit të Bardhë

18 VMV- nga vlerat serike mujore janë llogaritur vlerat mesatare vjetore.

Shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO_5)- ky parametër në grafikon është paraqitur vetëm në stacionet përgjatë rrjedhjes së lumenjëve dhe rezulton me këtë pasqyrë: në vitin 2008 minimumi i vlerës është 1.39 mg/l O_2 derisa maksimumi praqitet me 7.73 mg/l O_2 . Në viti 2009 ky parametër kap vlerën 1.51-7.17 mg/l O_2 . Derisa viti 2010 tregon 7.81 mg/l, ndërsa për vitin 2011 tregohet një ulje e vlerës mesatare maksimale 6.20 mg/l O_2 . Për vitin 2012 gjendja paraqitet e njëjtë nga 2.22 mg/l O_2 në 6.95 mg/l O_2 i tretur.

Nëse krahasojmë vlerat mesatare vjetore me vlerat e matjeve serike vërehet se SHBO_5 gjendet edhe në vlera më të larta së këto.




Figura 33: Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Drinit të Bardhë

Sa i përket cilësisë mund të themi se nuk ka ndotje të theksuar në asnjë nga stacionet monitoruese.

Përçueshmëria elektrike (PE)– në vitin 2008,2009,2010,2011 vlerën më të ulët e shënon lumi Lumëbardhi i Prizrenit- Prevallë 151 $\mu\text{S}/\text{cm}$, 120 $\mu\text{S}/\text{cm}$, 102 $\mu\text{S}/\text{cm}$, 112 $\mu\text{S}/\text{cm}$ dhe 130 $\mu\text{S}/\text{cm}$, ndërsa në vitet 2008 dhe 2010 vlerat më e larta në lumin Rimnik- Xërxë 681 dhe $\mu\text{S}/\text{cm}$ dhe 689 $\mu\text{S}/\text{cm}$, vitin 2009 dhe 2011 vlerë maksimale shënohet në të njëjtin lum Rimnik por në vendmostrimin Zhdrellë 665 $\mu\text{S}/\text{cm}$ dhe 770 $\mu\text{S}/\text{cm}$.

Derisa për vitin 2012 vlera maksimale mesatare vjetore shënohet në lumin Klina vendmostrimi Klinë 695 $\mu\text{S}/\text{cm}$.




Figura 34: Përçueshmëria elektrike në pellgun e Drinit të Bardhë

Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH)- në përgjithësi në vitin 2008 mesi anon nga një vlerë neutrale ku vlera më e ulët është në lumin Istog- Istog me 7.57 dhe ajo më e larta 8.08 që shënohet në lumin Rimnik- Zhdrellë. Edhe për vitin 2009 kemi vlera të përafërta me nja minimum 7.76 lumi Lumëbardhi i Prizrenit– Vllashje në maksimum vlerë 8.31 në lumin Lumëbardhi i Pejës– Drelaj me vlerë 8.31. Viti

2010 vlerë të ulët të pH tregon lumi Klina- Klinë 7.74 derisa maksimumi për këtë vit është në lumin Rimnik- Zhdrellë 8.34. Viti 2011 tregon një zgjerim intervali të vlerës së pH, me vlerën më të ulët në lumin Lumëbardhi i Prizrenit- Prevallë 7.45 derisa maksimumin e kësaj vlere e tregon lumi Toplluha- Buqall me vlerë 8.55.

Për vitin 2012 vlerën më të ulët pH shënon në lumin Lumëbardhi i Prizrenit- Prevallë 7.8 derisa maksimumin e vlerës mesatare vjetore e shënon lumi Toplluha- Buqallë me vlerë të pH-së 8.6 .




Figura 35: Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Drinit të Bardhë

Azoti i nitraveve (N-NO_3^-)- viti 2008 në lumin Erenik vendmostrimi Jasiq nitratatet janë në limit të detektimit ($0.1 \text{ mg/l N-NO}_3^-$ që është si limit i detektimit të aparaturës përcaktuese), derisa maksimumi i këtij parametri rezulton në lumin Rimnik- Xërxë me vlerë $2.297 \text{ mg/l N-NO}_3^-$. Viti 2009 me limit detektimi paraqitet lumi Lumëbardhi i Pejës- Drelaj, Lumëbardhi i Deçanit- Deçan, Rimnik- Zhdredhë si dhe Lumëbardhi i Prizrenit- Prevallë, derisa maksimumi i këtij parametri rezulton në lumin Toplluha- Piranë me vlerë $1.994 \text{ mg/l N-NO}_3^-$. Në vitin 2010, po ashtu kemi limit të detektimit në këto stacione monitorimi Lumëbardhi i Pejës- Drelaj dhe lumin Rimnik- Zhdrellë, derisa vlera maksimale mesatare vjetore paraqitet në lumin Toplluha- Piranë $1.973 \text{ mg/l N-NO}_3^-$. Viti 2011, limitet e detektimit ($0.1 \text{ mg/l N-NO}_3^-$) paraqiten në lumin Drini i Bardhë- Radavc, Lumbardhi i Pejës- Drelaj, Lumbardhi i Deçanit- Deçan hyrje, Ereniku- Jasiq dhe në Lumbardhin e Prizrenit- Vllashnje, përdërisa maksimumi i vlerës mesatare vjetore paraqitet në lumin Toplluha- Piranë me vlerën $2.765 \text{ mg/l N-NO}_3^-$.




Figura 36: Azoti i nitraveve në pellgun e Drinit të Bardhë

Në vitin 2012 limitet e detektimit paraqiten në këto vendmostrime: Drini i Bardhë- Radavc, Ereniku- Jasiq, Rimniku- Zhdredhë dhe në Lumbardhin e Prizrenit- Vllashnje. Ndërsa maksimumi i vlerës mesatare vjetore është në lumin Rimnik- Xërxë me vlerë $21.815 \text{ mg/l N-NO}_3^-$.

Azoti i nitriteve (N-NO_2^-) viti 2008 në lumin Drini i Bardhë vendmostrimi Radavc; Lumëbardhi i Pejës-Drelaj; lumi Toplluha- Buqallë dhe Lumëbardhi i Prizrenit- Prevallë, azoti i nitriteve paraqitet në limit të detektimit $0.003 \text{ mg/l N-NO}_2^-$. Në vitet 2009, 2010 dhe 2011 minimumi i VMV paraqitet në lumin Drini i Bardhë- Radavc $0.01398 \text{ mg/l N-NO}_2^-$; lumin Rimnik- Zhdrellë $0.23104 \text{ mg/l N-NO}_2^-$ dhe për 2011 lumi Drini i Bardhë- Radavc $0.01064 \text{ mg/l N-NO}_2^-$.

Viti 2012 limiti i detektimit ($0.003 \text{ mg/l N-NO}_2^-$) paraqitet në lumin Drini i Bardhë- Radavc; Ereniku-Jasiq; Rimnik- Zhdrellë; Toplluha- Buqallë dhe në lumin Lumbardhi i Prizrenit- Prevallë.




Figura 37: Azoti i nitriteve në pellgun e Drinit të Bardhë

Derisa maksimumi i mesatares vjetore të këtij parametri për të gjitha vitet (2008 deri 2012) është në lumin Rimnik- Xërxë me interval vlerash nga $0.1582 - 0.2310 \text{ mg/l N-NO}_2^-$.

Azoti i amoniumit (N-NH_4^+)- në vitin 2008 ky parametër regjistrohet si limit i detektimit ($0.001 \text{ mg/l N-NH}_4^+$) për këto stacione monitoruese: lumi Drini i Bardhë- Radavc, lumi Lumëbardhi i Pejës- Drelaj, lumi Toplluha- Buqallë dhe në lumin Lumbardhi i Prizrenit- Prevallë, vitet 2009 dhe 2010 lumi Istogut- Istog ($0.1245 \text{ mg/l N-NH}_4^+$ dhe $0.1323 \text{ mg/l N-NH}_4^+$), derisa 2011 si vlerë minimale e mesatares vjetore paraqitet lumi Drini i Bardhë- Radavc me këtë vlerë $0.0455 \text{ mg/l N-NH}_4^+$. Për vitin 2012 lumi Drini i Bardhë- Radavc dhe Lumbardhi i Prizrenit- Prevallë regjistrohen me limite të detektimit të aparaturës matëse ($0.001 \text{ mg/l N-NH}_4^+$).

Vlerat maksimale të mesatare vjetore për të katër vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012 paraqitet në lumin Rimnik stacioni monitorues në Xërxë ka koncentrim më të shprehur të këtij parametri (nga 2.0718 mg/l deri $3.7639 \text{ mg/l N-NH}_4^+$). E gjithë kjo rezulton për arsye se kemi të bëjmë me një lum që shtrihet mes përmes tokave bujqësore, por duke mos neglizhuar edhe të gjitha shkarkimet e ujërave urbane të qytetit të Rahovecit me disa fshatra që si zakonisht të pa trajtuara derdhen në rrjedhjen e këtij lumi.




Figura 38: Azoti i amoniumit në pellgun e Drinit të Bardhë

Duke u bazuar në vlerat e lejuara të cilat nuk duhet të jenë më të larta se 1.5 mg/l vërehet se përpos burimeve ku cilësia e ujëra është e mirë, në stacionet e tjera të monitorimit kjo cilësi është e nivelit mesatar dhe të ulët.

Fosfori i ortofosfateve (P-PO₄³⁻)- minimumi VMV për vitet: 2008 Dini i Bardhë- Radavc 0.0054 mg/l P-PO₄³⁻, 2009 lumi Lumëbardhi i Prizrenit- Prevallë 0.0018 mg/l P-PO₄³⁻, viti 2010 lumi Erenik- Jasiq 0.0033 mg/l P-PO₄³⁻,viti 2011 fosfori i ortofosfateve me limit të detektimit (0.001 mg/l P-PO₄³⁻) paraqitet në këto vendmostrime; lumi Istog- Istog; Lumëbardhi i Deçanit- Deçan dhe në lumin Rimnik- Zhdrellë. Viti 2012 me limit detektimi paraqiten këto stacione lumin Drini i Bardhë- Radavc dhe në lumin Rimnik- Zhdrellë. Ndërsa vlerë maksimale vjetore tregon lumi Rimnik- Xërxë për të gjitha vitet me vlerë nga 0.319 mg/l – 0.591 mg/l P-PO₄³⁻.




Figura 39: Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Drinit të Bardhë

Fosfori total (poli dhe orto)- vlera e fosforit total në pellgun e Drinit të Bardhë rezulton me luhatje të mëdha (ku ky parametër në grafikon është paraqitur vetëm në stacionet përgjatë rrjedhjes së lumenjëve). Vlera e minimumit mesatar vjetor për fosforin total për vitin 2008 është 0.037 mg/l P në vendmostrimin Mirushë- Volljak, ndërsa për vitet 2009,2010,2011 dhe 2012 lumi Lumbardhi i Deçanit- Kralan rezulton me minimum mesatar vjetor me një interval të vlerave nga 0.034-0,048 mg/l P.

Derisa vlerat maksimale vjetore (VMV) për të gjitha këto pese vite paraqiten ne lumin Rimnik vendmostrimi Xërxë me interval vlerash nga 0.482 - 1.016 mg/l P.




Figura 40: Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Drinit të Bardhë

PELLGU I IBRIT

Pellgu i Ibrit ka gjithsejtë 18 stacione monitorimi, tri nga to janë stacione që i takojnë lumit Ibër, stacioni i parë është në Kushtovë dhe cilësia e tij është e kënaqshme, stacioni i radhës është në dalje

të qytetit pas të gjitha shkarkimeve të ujërave urbane e të tjera, të cilat ndikojnë që cilësia e ujit të jetë më e dobët në këtë stacion dhe stacioni i tretë ndodhet në Kelmend pas puqitjes së tij me lumin Sitnica i cili paraprakisht me vete përmban gjithë sasinë e ujërave të nënpellgjeve të këtij pellgu lumor. Gjatë kësaj periudhe monitoruese nuk është vërejtur ndonjë rast për tu alarmuar.

Komente të përgjithshme për lumenjtë e pellgut të Ibrit

Lumi Sitnicë- duke filluar prej Ferizajt deri në Mitrovicë është lumi më i ndotur në Kosovë. Sa i përket parametrave fizik si: materiet e suspenduara janë prezent dhe i tejkalojnë vlerave maksimale të lejuara. Kjo vjen nga ajo se në këtë lum derdhet njëra pjesë e lumit të Nerodimës dhe lumenjtë Shtime, Graçanka, Prishtevka, Drenica, Llapi, Trepça si dhe ujërrjedha tjera më të vogla ku të gjitha këto puqiten në lumin Sitnicë, përmbajnë në vete ujërat e shkarkimeve të amvisëri si dhe ujërat e shkarkimeve industriale. Sa i përket parametrave kimik duke u bazuar në matjet e bëra siç janë sasia e oksigjenit të tretur dhe SHBO_5 si indikator që tregojnë për ndotjen permanente të këtij lumi.

Graçanka- Cilësia e ujit të këtij lumi është në vazhdimësi e ndotur si rezultat i pompimit të ujërave nga minierat e Kizhnicës dhe Artanës. Ka vlera të larta të përçueshmërisë elektrike dhe të jonit sulfat. Vlen të ceket se gjatë stinës së ngrohtë të verës ky lum shteron.

Prishtevka- Monitorimi i këtij lumi bëhet në Bresje të Fushë Kosovës para derdhjes së tij në lumin e Sitnicës, ky nuk mund të quhet lum sepse nuk plotëson asnjë kriter të tij, por ky është kolektori i të gjitha ujërave të shkarkuara urbane etj., të kryeqytetit të Kosovës i cili është njëri ndër më të ndoturit. Gjithashtu ka tejkallim të sasisë së nitriteve, materiet e suspenduara, shpenzimi kimik dhe biokimik i oksigjenit, munges të oksigjenit të tretur, detergjente etj.

Llap- Monitorimi i këtij lumi bëhet që nga burimi i tij mbi fshatin Murgullë dhe vazhdon pastaj në Podujevë në dalje të qytetit dhe stacioni i tretë dhe i fundit në Milloshevë para puqitjes së tij me lumin Sitnicë dhe nuk ka tejkallim të VML.

Drenica- Monitorimi i këtij lumi bëhet duke filluar nga Krojmir dhe para bashkimit me Sitnicën në Vragoli. Gjatë stinës së pranverës në stacionin e parë monitorues ka një cilësi më të mirë përdërisa në stacionin e dytë në Vragoli gjendja e tij pëson ndryshime të theksuara p.sh. përçueshmëria elektrike rritet për disa qindra njësi si rezultat i shkarkimeve të ujërave të mihjeve sipërfaqësore të KEK-ut.

Shtimja- Ka dy stacione monitorimi njëri në pjesën ku nuk ka ndikim të jashtëm nga aktivitet njerëzor dhe se cilësia e tij është shumë e mirë dhe stacioni i dytë është pas shkarkimeve të të gjitha ujërave urbane nga të gjitha fshatrat për rreth dhe të vetë qytetit të Shtimes prej nga cilësia e ujit të këtij lumi kalon në kategorinë mjaftë të dobët.

INTERPRETIMI I REZULATEVE TË PELLGUT IBËR

Në vijim përmes rezultateve me VMV të paraqitura në grafikone do të interpretohet gjendja e ujërave në pellgun e Ibrit me vlera mesatare vjetore për një numër të përzgjedhur të parametrave që maten nga IHMK në lumenj të këtij pellgu.

Sasia e oksigjenit të tretur (O_2 tretur)- vërehet se varion nga stacioni në stacion por mund të themi se në të gjitha rrjedhat e këtij pellgu ka sasi të mjaftueshme përpos në lumin e Prishtevka në Bresje që sasia e O_2 është e ultë.

Nëse krahasojmë vlerat e vitin 2008 me ato të 2009 shihet se nuk ka ndonjë ndryshim të madh, si vlerë më e lartë e O_2 është matur në lumin Ibër- Kushtov me vlerë 12.40 mg/l O_2 dhe 12.83 mg/l O_2 në lumin Ibër- Mitrovicë, ndërsa vlera minimale në 2008 dhe 2009 shënohen në lumin Prishtevka-Bresje por duhet të kihet parasysh se këto janë vlera mesatare vjetore sepse ka pasur raste d.m.th. gjate dinamikes mujore të monitorimit që në këtë stacion monitorimi dhe mos të ketë fare O_2 të tretur.




Figura 41: Oksigjenit të tretur në pellgun e Ibrit

E njëjta pasqyrë paraqitet edhe për vitet 2010 dhe 2011, maksimumi i vlerës mesatare vjetore paraqitet në lumin Ibër- Kushtovë 11.10 mg/l O_2 , derisa minimumi i saj përsëri në lumin Prishtevka- Bresje 3.48 mg/l O_2 të tretur.

Edhe në vitin 2012 minimumi i vlerës mesatare vjetore paraqitet në lumin Prishtevka- Bresje 3.98 mg/l O_2 derisa si vendmostrim me vlerën më të lartë vjetore rezultojnë lumi Lumbardhi i Deçanit- Deçan me vlerë 10.11 mg/l O_2 .

Duke e parë këtë trend pesëvjeçar lumi me sasinë më të vogël të oksigjenit të tretur është lumi Prishtevka vendmostrimi Bresje.

Shpenzimi biokimik i oksigjenit ($SHBO_5$)- ky parametër në grafikun është paraqitur vetëm në stacionet përgjatë rrjedhjes së lumenjëve. Krahasimin e bërë në mes vlerave të vitit 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012 vërehen ndryshime të vogla çka nënkupton se edhe cilësia e ujit të këtij pellgu në vazhdimësi nga viti në vit pra nga sezoni në sezon është pak i ndryshueshëm, vlerat maksimale të $SHBO_5$ është në stacionin Bresje të lumit Prishtevka me vlera mesatare vjetore 17.95 mg/l O_2 për 2008, dhe 19.67 mg/l O_2 për 2010, për 2011 kjo vlerë ishte 11.43 mg/l O_2 . Viti 2012 si vlerë mesatare vjetore të $SHBO_5$ paraqitet përsëri në stacionin Bresje të lumit Prishtevka me vlera mesatare vjetore 14.18 mg/l O_2 ndërsa ato stacione me vlera më të ulëta janë matur në burimet e lumenjve të këtij pellgu.




Figura 42: Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Ibrit

Përçueshmëria elektrike- marr në përgjithësi për këto pesë vite gjendja mbetet e njëjtë. Si vendmostrim me vlerat më të ulëta të mesatare vjetore të përçueshmërisë elektrike (për pesë vitet) paraqitet lumi Ibër- Kushtovë me interval vlerash (303-335 $\mu S/cm$). Ndërsa si vendmostrim me vlerat më të larta të mesatare vjetore (për pesë vitet) paraqitet lumi Graçanica- Vragoli me interval vlerash (1426-1621 $\mu S/cm$).




Figura 43: Përçueshmëria elektrike në pellgun e Ibrit

Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH)- vlerat e pH sillen zakonisht ndërmjet vlerave 7.48 deri në 8.16 për vitin 2008, ndërsa për 2009 këto vlera gjenden ndërmjet 7.50- 8.24, ndërsa për vitin 2010 vlerat variojnë nga 7.69 ne 8.19. Për vitin 2011 vlerat e pH sillen nga 7.7 – 8.49. Ndërsa në vitin 2012 vlerat e pH sillen nga 7.9 – 8.4.

Thënë përgjithësisht këto ujëra i takojnë një mesi të dobët bazik.




Figura 44: Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Ibrit

Azoti i nitrateve (N-NO_3^-)- vlera e limitit të detektimit ($0.1 \text{ mg/l N-NO}_3^-$) për të gjitha vitet paraqitet në lumin Topilla vendmostrimi Petrovë, derisa limiti i detektimit në vitin 2010 paraqitet edhe në këto stacione: Ibri- Kushtovë dhe Llapi- Murgullë. Poashtu edhe në vitin 2012, përveç lumit Topilla- Petrovë, limit i detektimit paraqitet edhe në vendmostrimet: Ibri- Kushtovë dhe Shtënica- Lipjan.




Figura 45: Azoti i nitrateve në pellgun e Ibrit

Maksimumet e vlerave mesatare vjetore të parametrut azoti i nitrateve, ndër vite ka këtë paraqitje; në lumi Sitnica- Sitnica Mitrovicë për 2009 (2.540 mg/l N-NO_3^-), për 2010 (2.252 mg/l N-NO_3^-), për vitin 2011 (2.398 mg/l N-NO_3^-). Ndërsa lumi Drenica- Drenica Vragoli, për vitin 2008 si vlerë maksimale mesatare vjetore ka (3.512 mg/l N-NO_3^-), ndërsa për 2012 ka vlerë (1.921 mg/l N-NO_3^-).

Azoti i nitriteve (N-NO_2^-)- për të pesë vitet (2008-2012) lumi Sitnica vendmostrimi Mitrovicë paraqitet me maksimum të VMV. Për vitin 2008 ky parametër arrin vlerën 0.194 mg/l N-NO_2^- , për vitin 2009 paraqitet një ulje e lehtë me vlerë 0.158 mg/l N-NO_2^- , 2010 përsëri një ngritje e lehtë 0.185 mg/l N-NO_2^- , derisa në vitin 2011 kemi një ulje të azotit në nitrate 0.175 mg/l N-NO_2^- , ku kjo ulje vazhdon edhe në vitin 2012 me azot të nitrateve 0.154 mg/l N-NO_2^- .

Nga e gjitha kjo nënkuptohet për një cilësi të dobët të këtij lumi.




Figura 46: Azoti i nitriteve në pellgun e Ibrit

Azoti i amoniumit (N-NH_4^+)- si edhe më lartë tek treguesi paraparak edhe këtu kemi stacionin Bresje të lumit Prishtevka i cili ka vlera më të larta të këtij parametri, se sa stacionet e tjera të monitorimit të lumenjve të këtij pellgu. Në të gjitha vitet 2008,2009,2010 dhe 2011 lumi Prishtevka vendmostrimi Bresje tregon vlerën më të lartë të mesatares vjetore.




Figura 47: Azoti i amoniakut në pellgun e Ibrit

Ku edhe për vitin 2012 gjendja paraqitet e njëjtë: në lumin Prishtevka- Bresje maksimumi i VMV është 8.416 mg/l N-NH_4^+ , derisa minimumi i VMV paraqitet në burimet e lumenjve.

Fosfori i ortofosfateve (P-PO_4^{3-})- ky parametër minimumin e VMV për 2008 e ka në lumin Topilla-Petrovë 0.003 mg/l P-PO_4^{3-} , ndërsa për vitet tjera është lumi Ibër- Kushtovë: 2009 ka vlerë 0.009 mg/l P-PO_4^{3-} , 2010 paraqitet me vlerë 0.010 mg/l P-PO_4^{3-} dhe 2011 me vlerë 0.001 mg/l P-PO_4^{3-} . Për vitin 2012 minimumi i VMV të parametrit fosfori i ortofosfate paraqitet në lumin Drenica- Krojmir. Derisa maksimumi i VMV për të gjitha vitet paraqitet në lumin Prishtevka- Bresje nga vlera 0.728 mg/l P-PO_4^{3-} deri 1.191 mg/l P-PO_4^{3-} .




Figura 48: Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Ibrit

Fosfori total (poli dhe orto)- ky parametër në grafikon është paraqitur vetëm në stacionet përgjatë rrjedhjes së lumenjëve dhe rezulton me këtë pasqyrë: vlera maksimale e mesatares vjetore (VMV) e fosforit total për të katër vitet paraqitet në lumin Prishtevka- Bresje me vlerë nga 0.964 mg/l P – 1.215 mg/l P, derisa minimumi i VMV për vitet 2008, 2009 dhe 2010 paraqitet lumi Llap- Milloshevë me vlerë 0.222 mg/l P, 0.186 mg/l P dhe 0.159 mg/l P, viti 2011 përafërsisht ka pasqyrë të njëjtë: minimumi i VMV paraqitet në lumin Ibër- Mitrovicë 0.128 mg/l P, ndërsa maksimumi i VMV përsëri në lumin Prishtevka- Bresje me vlerë 1.041 mg/l P.




Figura 49: Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Ibrit

Viti 2012 vlera e parametrit fosfori total ka këtë pasqyrë: si minimum i VMV, si në tri vitet e para është në lumin Llap- Milloshevë 0.175 mg/l P, ndërsa maksimumi i VMV përsëri në lumin Prishtevka- Bresje me vlerë 1.847 mg/l P.

PELLGU I MORAVËS SË BINÇËS DHE LEPENCIT

Komente të përgjithshme për lumenjtë e pellgut të Moravës së Binçës dhe Lepencit

Morava e Binçës- Monitorimi i këtij lumi bëhet duke filluar nga Kurbuliq, pastaj në Kllkot dhe Uglar dhe në kufirin me Serbinë në Domorovc. Ky lum bashkohet me lumin Kriva Reka të Dardanës. Në këtë lum po ashtu shkarkohen të gjithë ujërat urbane dhe industriale të Vitisë, Gjilanit dhe Dardanës.

Lumi Kriva Reka - Ky lum ngërthen në vete dy rrjedha ku uji në pikën e parë të monitorimit rezulton me cilësi të lartë, përderisa në stacionin e dytë në Domorovc cilësia e ujit bie, parametrat që rezultojnë më ndotje më të lartë janë: turbullira, amoniaku si dhe nitritet.

Lumi Lepenc- Ky lum ka dy burime njëri në bjeshkën e Prevallës e tjetri në bjeshkën e Brezovicës. Që të dy kanë cilësi shumë të mirë të ujërave. Kjo gjendje vazhdon të qëndroj deri në shkarkimin e ujërave të kompanisë "Silkapor" ku ujin her pas here e turbullon tej mase që është si rezultat i shkarkimeve të ujërave me të cilat kjo kompani bënë shpëlarjen e lëndës së parë dhe si të tilla i shkarkon në ujin e pastër të lumit Lepenc, kjo dukuri vazhdon për disa km, sepse është prezent edhe në stacionin e dytë të monitorimit të këtij lumi i cili ndodhet para puqitjes me lumin Nerodimja në Kaçanik. Pas bashkimit me këtë lum matja bëhet në stacionin e tretë në Han të Elezit, i cili është stacion ndërkufitarë me Republikën e Maqedonisë, cilësia e tij është brenda kufijve të lejueshëm.

Lumi Nerodime- Ky lum fillon në bjeshkët e Jezercës komuna e Ferizajit me një cilësi të lartë të ujit, ndërsa në stacionin e dytë pas shkarkimeve të ujërave urbane dhe të ujërave të tjera të regjionit të Ferizajt cilësia e ujit të këtij lumi bie duke vazhduar edhe në stacionin e radhës në Kaçanik para bashkimit të tij me lumin Lepenc.

INTERPRETIMI I REZULATEVE NË PELLGUN E MORAVËS SË BINÇËS DHE LEPENCIT

Interpretimin e gjendjes së nën pellgjeve të lumit Moravë e Binçës dhe Lepenc do ta paraqesim në vijim me anë të grafikoneve me vlera mesatare vjetore të secilit parametër në secilit lum të këtyre pellgjeve.

Sasia e oksigjenit të tretur (O_2 tretur)- nga grafiku vihet re tendencë në ulje të vlerave të oksigjenit të

tretur në stacionet pas shkarkimit të kolektorëve të ujërave të ndotura urbane. Në rrjedhjen e sipërme ujërat janë të pastër dhe të pasur me oksigjen. Varfërimi i lumenjve me oksigjen është pasojë e konsumit të tij pas shkarkimit të lëndëve organike, burimi kryesor i të cilave janë shkarkimet urbane.




Figura 50: Oksigjenit të tretur (mg/l O₂) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Uji i lumit Morava e Binçës- Uglar për dy vitet rezulton me sasi më të vogël të parametrin oksigjen i tretur dhe kjo si pasojë e shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale të pa trajtuara paraprakisht. Dy vitet e para tregon minimumin e VMV 6.06 mg/l O₂ dhe 7.01 mg/l O₂, derisa maksimumi i VMV është lumi Lepenc- Kaçanik 11.37 mg/l O₂ dhe 11.59 mg/l O₂. Viti 2010 paraqitet me vlera të përafërta të VMV 6.24 mg/l O₂ në lumin Nerodimja- Gërlicë dhe maksimumi i VMV 10.73 mg/l O₂ në lumit Morava e Binçës- Kurbuliq. Viti 2011 për lumin Nerodimja- Gërlicë tregon një ulje te minimumit të VMV 4.97 mg/l O₂ dhe me maksimum të VMV 9.69 mg/l O₂ të tretur.

Poashtu, viti 2012 nuk tregon ndryshim të madh të këtij parametri; sasia më e vogël e oksigjenit të tretur, minimumi i VMV paraqitet në lumin Morava e Binçës- Uglar 5.86 mg/l O₂, derisa maksimumi i VMV është lumi Lepenci- Hani i Elezit 9.40 mg/l O₂.

Por vlen të ceket se ne asnjë stacion monitorues nuk është tejkaluar sasia minimale (nën 3 mg/l). Shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO₅) - ky parametër në grafikon është paraqitur vetëm në stacionet përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe rezulton me këtë pasqyrë: në vitin 2008 minimumi i VMV paraqitet në lumin Lepenc- Kaçanik me vlerë 2.68 mg/l O₂, derisa maksimumi i VMV është në lumin Nerodimja-Gërlicë 11.97 mg/l O₂. Viti 2009 ka këtë pasqyrë: lumi Lepenc- Kaçanik me minimum VMV 2.92 mg/l O₂ dhe maksimum të VMV lumi Morava e Binçës- Uglar 14.08 mg/l O₂.




Figura 51: Shpenzimi biokimik i oksigjenit (mg/l O₂) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Vitin 2010 lumi Kriva Reka- Domorovc ka minimumin e VMV 3.81 mg/l O₂, derisa maksimumi i VMV është në lumin Morava e Binçës- Domorovc me vlerë 14.12 mg/l O₂. Në vitin 2011 kemi një gjendje

me minimum vlere në lumin Morava e Binçës- Uglar 3.55 mg/l O₂, ndërsa maksimumi i VMV në lumin Nerodimj- Gërlisë me vlerë 5.21 mg/l O₂.

Poashtu edhe në vitin 2012 si minimum VMV është në lumin Morava e Binçës- Klokot 4.7 mg/l O₂ dhe maksimum të VMV në lumin Nerodimj- Gërlisë me vlerë 9.19 mg/l O₂.

Përçueshmëria elektrike- në 2008 vlerat e këtij parametri sillen nga më e ulëta në lumin Nerodimja- Jezerc 138 µS/cm deri tek ajo më e larta në lumin Morava e Binçës- Morava e Binçës me vlerë 684 µS/cm. Në vitin 2009 vlera më e ulët figuron në lumin Lepenc- Prevallë Subain derisa vlera maksimale mesatare vjetore është matur në lumin Kriva Reka- Kriva Reka Domorovc 628 µS/cm. Viti 2010 ka minimum të VMV në lumin Lepenc- Prevallë Subain 86 µS/cm, derisa maksimumi i VMV është në lumin Morava e Binçës- Uglar me vlerë 503 µS/cm.




Figura 52: Përçueshmëria elektrike (µS/cm) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Në vitin 2011 po ashtu minimumi i VMV është në lumin Lepenc- Prevallë Subain 62 µS/cm, derisa maksimumi i VMV është në lumin Kriva Reka- Kriva Reka Domorovc 765 µS/cm.

Viti 2012 minimumi i VMV paraqitet në lumin Nerodimja- Jezerc me vlerë 116 µS/cm, ndërsa maksimumi i VMV në lumin Kriva Reka- Kriva Reka Domorovc 632 µS/cm.

Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH)- vlerat e pH sillen zakonisht ndërmjet vlerave 7.61 deri në 8.14 për vitin 2008, në vitin 2009 vlerat e pH sillen nga 7.64-8.27. Viti 2010 ka vlera të pH 7.63 – 8.24. Në vitin 2011 vlerat e pH sillen nga 7.62 – 8.26. Vlerat e pH në vitin 2012 sillen nga 7.73 - 8.32.

Përgjithësisht ujërat në këto pellgje i takojnë një mesë të dobët bazik.




Figura 53: Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Azoti i nitrateve (N-NO₃⁻)- në vitin 2008 minimumi i VMV është në lumin Lepenc- Prevallë Subain 0.154 mg/l N-NO₃⁻, derisa maksimumi i VMV është në lumin Lepenc- Kaçanik 2.851 mg/l N-NO₃⁻. Vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 minimumi paraqiten me limite detektimi (0.1 mg/l N-NO₃⁻) në këto

vendmostrime: 2009, 2010 dhe 2011 lumenjtë Kriva Reka- Zebincë, Lepenci- Prevallë Subain dhe lumi Nerodimja- Jezerc.

Derisa maksimumi i VMV është: viti 2009 në lumin Morava e Binçës- Morava e Binçës Domorovc (1.923 mg/l N-NO₃⁻), viti 2010 në lumin Kriva Reka Kriva Reka Domorovc (1.595 mg/l N-NO₃⁻) si dhe viti 2011 në lumin Morava e Binçës- Uglar me vlerë 1.384 mg/l N-NO₃⁻.




Figura 54: Azoti i nitrave (mg/l N-NO₃⁻) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Ndërsa viti 2012 si minimum paraqitet me limit detektimi (0.1 mg/l N-NO₃⁻) në vendmostrimin referent të lumit Nerodimja- Jezerc, ndërsa si vlerë maksimale e VMV paraqitet në lumin Morava e Binçës- Morava Domorovc 1.370 mg/l N-NO₃⁻.

Azoti i nitriteve (N-NO₂⁻) - në vitin 2008 minimumi i VMV është në lumin Lepenci- Prevallë Subain me vlerë 0.0046 mg/l N-NO₂⁻, derisa maksimum i VMV paraqitet në lumin Nerodimja- Kaçanik me vlerë 0.3297 mg/l N-NO₂⁻. Viti 2009 maksimumin e VMV e tregon në lumin Kriva Reka- Zebincë me vlerë 0.0149 mg/l N-NO₂⁻, derisa maksimumi i VMV paraqitet në lumin Morava e Binçës- Morava e Binçës Domorovc 0.1471 mg/l N-NO₂⁻. Viti 2010 ka këtë pasqyrë: minimumi i VMV në lumin Lepenci- Prevallë Subain 0.0201 mg/l N-NO₂⁻ dhe maksimumin e VMV në lumin Nerodimja- Kaçanik me vlerë 0.2592 mg/l N-NO₂⁻.




Figura 55: Azoti i nitriteve (mg/l N-NO₂⁻) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Edhe në vitin 2011 nuk ka ndonjë ndryshim të madh, minimumi i VMV është në lumin Lepenci- Prevallë Subain 0.0182 mg/l N-NO₂⁻, ndërsa maksimumi i VMV në lumin Nerodimja- Kaçanik me vlerë 0.2302 mg/l N-NO₂⁻. Viti 2012 azoti i nitriteve në këtë pell paraqitet me minimum të VMV 0.0017 mg/l N-NO₂⁻, ndërsa maksimumi i VMV paraqitet në lumin Nerodimja- Kaçanik 0.2226 mg/l N-NO₂⁻. Azoti i amoniumit (N-NH₄⁺) - si element i ndotjes së freskët rezultojnë në sasi të mëdha sidomos pas

kolektorëve shkarkues urbane e rurale. Amoniaku në kushte alkaline $\text{pH} > 10$ në mjedisin pritës sipërfaqësor ka efekte dëmtuese në faunën ujore. Prania e tij në ujëra ka efekte olfaktike me shfaqjen e erërave te pakëndshme.




Figura 56: Azoti i amoniumit (mg/L N-NH_4^+) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Viti 2008 në lumin Nerodime- Jezerc kemi limit të detektimit ($0.001 \text{ mg/L N-NH}_4^+$) gjersa maksimumin e arrin në lumin Nerodime- Gërlicë $18.921 \text{ mg/L N-NH}_4^+$. Viti 2009 dhe 2010 vlera minimale vjetore ka lumi Lepenc- Prevallë Subain $0.1906 \text{ mg/L N-NH}_4^+$ dhe $0.1089 \text{ mg/L N-NH}_4^+$, derisa lumi Nerodimja- Gërlicë kap vlerën maksimale $2.7230 \text{ mg/L N-NH}_4^+$ dhe $9.0467 \text{ mg/L N-NH}_4^+$. Në vitin 2011 minimumi i VMV është paraqitur në lumin Morava e Binçës- Kurbuliq $0.1089 \text{ mg/L N-NH}_4^+$, derisa maksimumi i VMV është në lumin Morava e Binçës- Uglar $4.2234 \text{ mg/L N-NH}_4^+$.

Ndërsa në vitin 2012 azoti i amoniumit si vlerë minimale e mesatares vjetore paraqitet në lumin Morava e Binçës- Kurbuliq $0.0233 \text{ mg/L N-NO}_2^-$ dhe si vlerë maksimale vjetore azoti i amoniumit paraqitet në lumin Nerodimja- Gërlicë $7.6902 \text{ mg/L N-NO}_2^-$.

Fosfori i ortofosfateve (P-PO_4^{3-})- minimumi i VMV për 2008 dhe 2011 është në lumin Nerodimja- Jezerc $0.003 \text{ mg/L P-PO}_4^{3-}$, për 2009 dhe 2012 lumi Kriva Reka- Zebincë $0.004 \text{ mg/L P-PO}_4^{3-}$ dhe për 2010 lumi Lepenc- Prevallë Subain $0.006 \text{ mg/L P-PO}_4^{3-}$. Derisa maksimumi i VMV për të katër vitet është në lumin Nerodimja-Gërlicë me interval vlerë nga $0.330 \text{ mg/L P-PO}_4^{3-}$ deri $0.865 \text{ mg/L P-PO}_4^{3-}$.

Nga rezultatet konkludojm se parametri fosfat gjatë këtyre katër viteve të monitorimit vlerë maksimale ka në stacionin e monitorimit Nerodimja-Gërlicë.




Figura 57: Fosfori i ortofosfateve (mg/L P-PO_4^{3-}) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Jonet fosfate në vlera më të ngritura paraqiten kryesisht në ato stacione monitorimi pas shkarkimeve urbane dhe industriale.

Fosfori total (poli dhe orto)- edhe ky parametër në vendburime ka vlera të ulëta dhe në grafikone janë të paraqitura vlerat e fosforit total përgjat rrjedhjes së lumenjëve. Në lumin Lepenc- Kaçanik për vitet 2008-2011 është matur minimumi i VMV me interval vlerash 0.064 mg/l P – 0.168 mg/l P. Derisa maksimumi i VMV është matur për të katër vitet në lumin Nerodimja- Gërlicë me vlera nga 0.420 mg/l P- 1.247 mg/l P.




Figura 58: Fosfori total (poli dhe orto)(mg/l P) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Ndërsa për vitin 2012 kemi këtë pasqyrë: si vlerë minimale e mesatares vjetore kemi në lumin Kriva Reka- Kriva Reka Domorovc 0.254 mg/l P, dhe si vlerë maksimale e mesatares vjetore në lumin Nerodimja- Gërlicë 0.736 mg/l P.

Ndotja nga metalet e rënda

Metalet e rënda në ujërat sipërfaqësore nga IHMK-ja kanë filluar të monitorohen nga vitit 2008, me një shkëputje prej dy viteve, por që nga viti 2011 përsëri kemi matje të metaleve të rënda. Disa nga këta elementë janë toksike p.sh. Pb, Cd, Cu, Cr, Ni etj. Por në mesin e tyre përfshihen edhe elementet esenciale si: Fe, Zn, Mn, Cr.

Tabela 24: Vlerat maksimale të lejuara për disa metale të rënda në ujërat sipërfaqësor sipas Dekretit Legjislativ 11 Maj 1999 nr.152 ¹⁹

Nr.	Metali	Simboli	Njësia matëse	VML
1	Kadmiumi	Cd	µg/l	5
2	Kromi	Cr	µg/l	50
3	Mangani	Mn	µg/l	50
4	Hekuri	Fe	µg/l	200
5	Nikeli	Ni	µg/l	20
6	Plumbi	Pb	µg/l	10
7	Bakri	Cu	µg/l	1000
8	Zinku	Zn	µg/l	3000

Në vijim do ti paraqesim grafikonet e metaleve vetem për ata parametra që kanë shënuar tejkalime në Vlerat Maksimale të Lejuara (VML).

Pellgu i Drinit të Bardhë- Në bazë të Dekretit Legjislativ 11 Maj 1999 metali mangan dhe hekur paraqiten me kalueshmëri të VML (në vijim grafiket e këtyre metale).

¹⁹ "DEKRETI LEGJISLATIV 11 MAJ 1999,NR. 152", Dispozita për mbrojtjeje ujërave nga ndotja, Direktiva 91/271/EEC për trajtimin e ujërave të shkarkuara urbane.

Metali mangan- për vitin 2008 tejkalime me metalin mangan kemi në këto stacione: lumi Erenik- Ura e Terzive, lumi Rimnik- Xërxë, Toplluha në dy stacionet monitoruese dhe në lumin Lumëbardhi i Prizrenit- Vllashnje. Viti 2011 kryesisht në stacionet referente kemi limitet e detektimit 1.5 µg/l. Ndërsa tejkalime në VML kemi në kryesisht përgjat rrjedhjes së lumenjëve: Istog- Zllakuqan, Klina- Klinë, Ereniku- Ura e Terzive, lumin Rimnik- Xërxë dhe në lumin Toplluha- Piranë.

Poashtu edhe në vitin 2012 limite të detektimit paraqiten në stacionet referente, derisa tejkalime të metalit mangan kemi në këto vendmostrime: lumi Drini i Bardhë- Gjonaj, Lumbardhi i Pejës- Pejë dhe Grabanicë, Lumbardhi i Deçanit- Deçan, Erenik- Ura e Terzive, Rimnik- Xërxë, lumi Toplluha- Piranë dhe në lumin Lumbardhi i Prizrenit – Vllashnje.




Figura 59: Metali mangan në pellgun e Drinit të Bardhë

Për të tri këto vite në Pellgun Drini i Bardhë lumi Rimnik- Xërxë shënon ndotjen më të madhe me metalin mangan.

Metali hekur- për vitin 2008 nuk kemi tejkalim të VML të metalit hekur. Viti 2011 si limit detektimi (1.5 µg/l) paraqitet në lumin Istog- Istog. Ndërsa tejkalimet paraqiten në këto stacione matëse: lumi Istog- Zllakuqan, Lumbardhi i Pejës- Grabanicë, Erenik- Ura e Terzive dhe në lumin Lumbardhi i Prizrenit- Vllashnje.




Figura 60: Metali hekur në pellgun e Drinit të Bardhë

Viti 2012 tejkalime nga VML me metalin hekuri kemi në këto stacione monitoruese: lumi Drini i Bardhë- Gjonaj, Lumbardhi i Pejës- Grabanicë, Lumbardhi i Deçanit- Krelan, Erenik- Ura e Terzive, lumi Toplluha- Piranë dhe në lumin Lumbardhi i Prizrenit- Vllashnje.

Pellgu i Ibrit– Në këtë pellg janë evidente prezenca e metaleve të rënda si: metali krom, zink, mangan dhe hekur. Edhe për këtë pellg do ti paraqesim në grafikone vetëm metalet që kanë shënuar tejkalime nga vlera maksimale e lejuar (VML).

Metali krom- për vitin 2008 me limit detektimi(1.5 µg/l) paraqiten këtë stacione monitoruese: lumi Ibër- Kushtovë dhe Mitrovicë, Sitnica- Mitrovicë, lumi Llap- Murgullë dhe lumi Drenica- Krojmir. Ndërsa tejkalime nga VML paraqitet në këto stacione monitoruese: lumi Sitnica- Vragoli dhe Plemetin, Llapi- Podujevë, Prishtevka- Bresje, lumi Graçanka- Vragoli dhe lumin Drenica- Vragoli. Viti 2011 limiti i detektimit paraqitet në lumin Topilla- Petrovë. Ndërsa tejkalime në VML shënohen në: lumi Ibër- Kelmend, Sitnica- Vragoli dhe Plemetin, Llapi- Podujevë dhe lumi Drenica- Vragoli.




Figura 61: Metali krom në pellgun e Ibrit

Edhe për vitin 2012 me limit detektimi paraqiten pothuajse të gjitha stacionet monitoruese referente. Ndërsa tejkalime nga VML paraqiten në lumin Sitnica – Vragoli dhe Plemetin në lumin Drenica – Vragoli, që njëherit janë stacionet më të ndotura me metalin krom në këtë pellg.

Metali zink- për këto tri vite sa janë monitoruar metalet e rënda, metali zink nuk shënon tejkalime nga VML por paraqitet me përqendrim të lartë, kjo rrjedh nga ujërat e flotacionit të xehes nga miniera e Stan Tërgut. Për vitin 2008 përqëndrimi i vlerës mesatare vjetore të metalit zink është 290 µg/l, për vitin 2011 vlera mesatare vjetore e metalit zink 1280 µg/l dhe për vitin 2012 kemi një vlerë mesatare vjetore më të ulët të metalit zink 694 µg/l.




Figura 62: Metali zink në pellgun e Ibrit

Metali mangan- në pellgun e Ibrit metali mangan për këto tri vite është prezent në të gjitha stacionet monitoruese. Për të pasur pasqyr më të qartë po i përmendim vetëm stacionet matëse ku nuk kemi tejkalim të VML. Në vitin 2008 vlera më të ulëta nga VMV kemi në këto stacione: lumi Ibër- Kush-

tovë dhe Mitrovicë, Llap- Murgullë dhe Drenica- Krojmir. Për vitin 2011 vlera nën maksimumin e lejuar paraqiten në këto stacione matëse: lumi Sitnica- Plemetin, lumi Llap- Murgullë dhe Milloshevë, Drenica- Krojmir dhe lumi Topillës- Petrovë. Edhe në vitin 2012 stacionet ku nuk kemi tejkalime nga VML pothuajse janë të njëjtat si në tri vitet e paraqitura më lartë: lumi Ibër- Mitrovicë, Drenica- Krojmir dhe lumi i Topillës- Petrovë.




Figura 63: Metali mangan në pellgun e Ibrit

Vlen të ceket se për tri vitet lumi Graçanka është lumi që ka përqendrimin më të lartë të metalit mangan.

Metali hekur- metali hekur për vitin 2008 nuk ka tejkalime nga VML. Për vitin 2011 tejkalime paraqiten vetëm në lumin Shtime- Muzeqinë. Viti 2012, tejkalime nga VML paraqitet në këto stacione: lumi Prishtevka- Bresje, lumi Graçanka- Vragoli dhe lumi Shtime- Muzeqinë.




Figura 64: Metali hekur në pellgun e Ibrit

Pra, lumi Shtime- Muzeqinë tregon ndotjen më të lartë me metalin hekur në këtë pellg. Për dy vitin 2011 si vlerë mesatare vjetore 550 µg/l dhe 2012 me një përqendrim pak më të ulët 528 µg/l.

Pellgu i Morava e Binçës dhe Lepencit- Në këto dy pellgje metali mangan dhe metali hekur ka një tejkalim nga vlerat e lejuara në bazë të direktivës EU 152/1999, përderisa sasia e metaleve të tjera të përcaktuar ndodhen në sasira më të vogla se sa VML.

Metali mangan- për vitin 2008 në të gjitha stacionet monitoruese kemi tejkalime nga VML, përveç në lumin Lepenc në të tri stacionet monitoruese që nuk kemi tejkalime. Derisa maksimumi i vlerës mesa-

tare vjetore paraqitet në lumin Morava e Binçës- Uglar (189 µg/l). Metali mangan për viti 2011 përveç në stacionet referente që nuk paraqitet, në stacionet tjera është me tejkalim të VML.




Figura 65: Metali mangan në pellgun Morava e Binçës dhe pellgun e Lepencit

Në viti 2012 metali mangan nuk tejkalon VML vetëm në dy stacionet referente të pellgut të Lepencit, ndërsa në stacionet e tjera metali mangan tregon tejkalim nga VML.

Për vitin 2011 dhe 2012 maksimumi i vlerës mesatare vjetore paraqitet në lumin Kriva Reka- Kriva Reka Domorovc .

Metali hekur- për vitin 2008 paraqitet me tejkalim nga VML vetëm në lumin Morava e Binçës – Uglar. Për vitin 2011 dhe vitin 2012 tejkalime nga VML me metalin hekur kemi në lumin Morava e Binçës në të gjitha stacionet monitoruese (me përjashtim të stacionit referent), lumin Kriva Reka- Kriva Reka Domorovc dhe në lumin Lepenc- Lepenci Kaçanik dhe Han i Elezit.




Figura 66: Metali hekur në pellgun Morava e Binçës dhe pellgun e Lepencit

3.3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Konkluzionet

- Kosova ende nuk ka Stretëgjia Nacionale për Ujërat,
- Baza aktuale ligjore ka nevojë për plotësime dhe harmonizim me direktivat e Bashkimit Evropian.
- Menaxhimi i ujërave në Kosovë është ende në fazën e ndërtimit të infrastrukturës për furnizim me ujë të pijshëm, sistemin ujitës, kontrollimin e hedhjes së ujërave të ndotura, zhvillimin e potencialeve hidro-energjetike, kontrollimin e vërshimeve, erozionin etj
- Njëra ndër problemet më të mëdha në sektorin e ujërave është mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Perkunder perparimeve të theksuara ende ka problem në bashkëpunimin nderinstitucional në zgjidhjen e problemeve në sektorin e ujërave e sidomos në nivelin lokal.
- Verehet mungesa e hulumtimeve shkencore në fushën e ujërave e sidomos në hulumtimin e resurseve ujore nëntokësore.
- Sistemi i monitorimit të ujërave sipërfaqësore ka nevojë për modernizim ndërkohë që mungon sistemi i monitorimit të ujërave nëntokësore,
- Për shkak të rritjes së popullsisë në Kosovë, si dhe numrit në rritje të amvisërive të kyçura në sistemet ujore, kërkesa për ujë vazhdon të rritet

Rekomandimet

- Hartimi i strategjisë afatgjate për menaxhimin e ujërave
- Plotesimi i baze ligjore për ujëra dhe harmonizimi i saj me direktivat e Bashkimit Evropian.
- Të modernizohet sistemi i monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe të ngritet sistemi i monitorimit të ujërave nëntokësore,
- Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore;
- Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Përfshirja e popullatës në sisteme të organizuara të ujësjellësve dhe të kanalizimeve;
- Vendosja e masave për kursimin e ujit në të gjithë sektorët,
- Mirëmbajtja e dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellësve dhe kanalizimeve.
- Rritja e bashkëpunimit dhe informimit në mes institucioneve qendrore dhe lokale.
- Realizimi i hulumtimeve shkencore në fushën e ujërave e sidomos në hulumtimin e resurseve ujore nëntokësore.
- Vetëdijesimit dhe edukimit për të qenë më të përgjegjshëm me resurset ujore.
- Vlerësimi i nevojave për investime në infrastrukturën e ujërave.

4. Toka /dheu

4.1. Shfrytëzimi i tokave

Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjell deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Sfidë është që të parandalohet degradimi i tokave përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave. Në tabelën 25 janë prezantuar të dhëna për klasat e përdorimit të tokave në hektarë (ha), ndërsa në tabelën 26 janë prezantuar kategoritë e tokave sipas komunave.

Tabela 25. Sipërfaqja totale e tokave sipas klasave të përdorimit²⁰

Përdorimi i sipërfaqes	Sipërfaqja (ha)
Pyje	464800
Tokë pyjore	28200
Tokë bujqësore	342400
Kullosa dhe livadhe	153200
Tokë e djerrë	23400
Zona urbane, ndërtesa	40000
Sipërfaqe ujore	4600
E pa klasifikuar	41600
Gjithsej	1098200

Sipas tabelës nga sipërfaqja totale prej 464 800 ha, 278 880 ha ose rreth 60% është klasifikuar si tokë pyjore publike. Pjesa e mbetur 40% (185 920 ha) është pronë private. Këto shifra ndryshojnë si nga shënimet statistikore të vjetra, po ashtu edhe nga shënimet kadastrale.

Tabela 26: Kategoritë e tokave sipas komunave²¹

Emri i Komunës	Kategoritë e tokave/ ha			
	Toka djerrina që shfrytëzohen si kullosa	Toka djerrina që nuk shfrytëzohen	Toka të ndotura	Gjithsej
Deçan	960			960
Gjakovë	800	420		1220
Glllogoc	1600			1600
Gjilan		2332.4		2332.4
Dragash		60		60
Istog	4000	410	48	4458
Kaçanik	300	116		416
Klinë	800			800
Fushë Kosovë	360	228	157	745
Kamenicë	3583			3583
Mitrovicë	2532.9			2532.9
Leposaviq				
Lipjan	350			350

20 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2009

21 Anketa Administrative Gjysmë Vjetore/ Zyra e Statistikave Bujqësore-MBPZHR

Novo Bërdë				
Obiliq	1400	1350	147	2897
Rahovec	3513	1520		5033
Pejë	1020	4493		5513
Podujevë	1805	1478		3283
Prishtinë				
Prizren	200	150	5	355
Skenderaj	1600			1600
Shtime	149		1	150
Shtërpçë		215		215
Suharekë	3550	900	17	4467
Ferizaj				
Viti	500	12		512
Vushtrri	450	271.7		721.7
Zubim Potok				
Zveçan			20	20
Malishevë	2217.05			2217.05
Gjithsej	31689.95	13956.1	375	46021.05

Faktorët kryesorë që ndikojnë në humbjen e tokave në Kosovë janë: vendbanimet (ndërtime të paplanifikuara), industria (mbeturinat e ngurta, mihjet sipërfaqësore), ndërtimi i rrugëve dhe autostradave, mbeturinat e shtëpiake dhe deponitë, erozioni dhe eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit.

Njëra prej formave më të shpeshta të humbjes së tokave bujqësore është ndërtimi i destinimit të shfrytëzimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Sipas të dhënave të MBPZHR, që janë siguruar nga Drejtoritë Komunale për Bujqësi, gjatë periudhës 1999-2008, rreth 2,580.50 ha tokë bujqësore i është ndërruar destinimi pa lejen e Kuvendeve Komunale. Ndërsa rreth 1.690.00 ha të sipërfaqes së tokës bujqësore i është ndërruar destinimi me leje nga Kuvendet Komunale.




Figura 67: Sipërfaqja e tokës bujqësore të cilës i është ndërruar destinimi në tokë jo bujqësore pa leje të Kuvendeve Komunale 1999-2008²²

22 Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2009




Figura 68: Sipërfaqja e tokës bujqësore të cilës i është ndërruar destinimi në tokë jo bujqësore me leje të Kuvendeve Komunale 1999-2008

Sipas vlerësimeve të MBPZHR, llogaritet se rreth 400 ha tokë bujqësore brenda vitit i ndërrohet destinimi i shfrytëzimit në tokë ndërtimore.

4.2. Ndotja e tokave

Ndotja e tokave me metale të rënda - Kjo kategori e ndotjes është rezultuar nga proceset industriale. Metale të rënda dhe shumë toksike të cilat kontribuojnë në ndotje janë: mercuri metalik dhe komponimet organomerkurike si dimetilmercuri i $Hg(CH_3)_2$, arseni, plumbi, kadmiumi, beriliumi etj. Efektet e tyre në organizëm janë tejet negative duke shkaktuar dëmtime të sistemit nervor, sistemit kardiovaskular, sistemit urinar, po ashtu shkaktojnë pneumoni dhe plagë të rënda në lëkurë.

Në Kosovë ende nuk ka sistem të monitorimit të tokës (dheut). Aktualisht as operatorët ekonomik me potencial ndotës të mjedisit nuk e bëjnë monitorimin e rregullt të cilësisë së tokës (dheut), prandaj edhe AMMK ka mungesë të dhënave për kualitetin e dheut në këto zona.

Në vitin 2008 NeëCo "Ferronikeli Complex" ka bërë disa analiza (matje) të dheut në brendi të rrethojës së fabrikës dhe në disa lokacione tjera përreth, për të verifikuar përqendrimin e disa metaleve të rënda. Të dhënat nga këto matje janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 27: Lokacionet dhe rezultatet për ndotjen e dheut me metale të rënda në zonën e NeëCo "Ferronikeli Complex"²³


Lokacionet e vendmarjes se mostrave	Metalet e rënda/njësia			
	Hekuri-Fe %	Nikeli-Ni mg/kg	Kobalti-Co mg/kg	Kromi-Cr mg/kg
Në perëndim të shkrites	4.05	628.0	20.0	204
Në jug-perëndim të shkrites	3.50	557.0	3.0	102
Në afërsi të stacionit të zjarfikësve të Drenasit	2.96	136.5	gjurmë	40
Tërstenik afër mullirit	2.96	72.5	gjurmë	13
Çikatovë	2.88	308.5	gjurmë	54
Nën deponi të skories	2.50	334.0	gjurmë	66
Suka	3.81	648.0	gjurmë	158
Rezervuarët e ujit të fabrikës	2.59	140.0	gjurmë	n.d.

²³ NewComplex Feronikeli, 2009

Në bazë të udhëzimit administrativ për nivelet maksimale të lejuara të shkarkimit dhe shpërndarjes së ndotësve në tokë, VML nga analizat e prezantuara në tabelë për metalet e rënda si Nikeli (Ni) dhe Kromi (Cr), janë tejkaluar pasi që VML në tokë për këto metale është 50 mg/kg.

4.3. Gjendja e mjedisve të rrezikuara

Agjencioni Për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës pas realizimit të projektit për identifikimin e mjedisve të rrezikuara në Kosovë, 2008-2009, ka identifikuar 110 vende të ndotura dhe të kontaminuara. Prej tyre 28 mjedise janë me potencial të lartë të ndotjes²⁴. Mjediset e tilla të rrezikuara janë të propozuara si Hotspote. Hot-spotet mjedisore janë krijuar dhe të trashëguara si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave, nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide të skaduara e kështu më radhë.



Harta 4. Lokacionet e hotspoteve në Kosovë

Për Mjediset e rrezikuara-hotspoteve, ekzistojnë definicione të ndryshme në terminologjinë e mjedisit varësisht se në çfarë fushe mjedisore perceptohet hot-spoti. Definicioni më i pranueshëm është ai që hotspotet paraqesin lokacione me koncentrim të lartë të ndotësve. Hotspotet mund të jenë edhe toka të kontaminuara kimikisht nga industritë e minierave, aktivitetet me mbeturina dhe ndotës tjerë që kanë ndikim në ujërat nëntokësore, tokë dhe ajër. Si hotspote mjedisore janë evidentuar deponitë e minierave me koncentrim të lartë të metaleve të rënda, deponi të mbetjeve bujqësore, deponi sanitare të mbeturinave, deponitë e rehabilitura komunale dhe deponitë e egra, mbetjet nga kimikatet e rrezikshme industriale dhe radioaktivitetit.

Të dhënat me të detajuara për lokacionet e këtyre hotspoteve, sipërfaqet e tyre dhe burimet potenciale të ndotjes janë prezantuar në tabelën 28.

²⁴ Raporti, Hotspotet Mjedisore në Kosovë, AMMK 2011

Tabela 28: Hot-spotet mjedisore sipas lokacioneve, aktivitetit, sipërfaqes dhe burimeve potenciale të ndotjes²⁵

Nr.	Lokacioni	Aktiviteti në të kaluarën	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Kemikate	Vajra	Materie organike	Tjetër
1.	Objekti i ish Ndërmarrjes së Agro-Kulturave në Shirokë-Komuna e Therandës	Depo për mbeturina të pesticidëve dhe fertilizues	0.04 ha	-	+	-	-	-
2.	Objekti i ish Fabrikës së automjeteve në Pejë	Depo për kemikale të rrezikshme industriale	0.12 ha	-	+	+	-	-
3.	Objekti në Mazgit	Depo për barnat me afat të skaduar	0.19 ha	-	+	-	-	-
4.	Deponia Sanitare komunale në Podujevë	Deponi e mbeturinave	5 ha	-	+	+	+	+
5.	Deponia Sanitare Komunale në Pejë	Deponia e mbeturinave	2 ha	-	+	+	+	+
6.	Deponia Sanitare Regjionale në Gjiilan	Deponi e mbeturinave	20.5 ha	-	+	+	+	+
7.	Deponia Sanitare Regjionale në Prizren	Deponi e mbeturinave	14 ha	-	+	+	+	+
8.	Deponia Sanitare Regjionale në Mirash-Obiliq	Deponi e mbeturinave	40 ha	-	+	+	+	+
9.	Deponia Sanitare Komunale në Mitrovicë	Deponi e mbeturinave	7 ha	-	+	+	+	+
10.	Fabrika për prodhim të gomave dhe trakëve-Suharek	Mbetje të vajrave dhe kontaminim i tokës	14 ha	-	+	+	-	-
11.	Parku Industrial Trepça	Deponit industriale	44.50 ha	+	+	-	-	-
12.	Pjesa jug-lindore-pjesa e Fshatit Çikatovë-Komuna e Drenasit	Mbeturinat e skories së Feronikelit	4 ha	+	-	-	-	-
13.	Deponia Industriale e Feronikelit-Çikatovë-Drenas	Deponia e Skories industriale të Feronikelit	24 ha me ndikim prej 71.37 ha	+	-	-	-	-
14.	Deponia e Minierës afër pendës, Badovcë	Deponia me metale të rënda	2.85 ha	+	-	-	-	-
15.	Deponia e materialit steril në Kishnicë	Deponia me metale të Rënda	10.23 ha	+	-	-	-	-
16.	Deponia e Marecit 1, prroi i djaloshit, Miniera Artane	Deponia me metale të rënda	2.38 ha	+	-	-	-	-
17.	Deponia e Marecit 2, prroi i djaloshit, Miniera Artane	Deponia me metale të Rënda		+	-	-	-	-
18.	Deponia në Kelmend-Mitrovicë	Deponia me metale të rënda	23.78 ha	+	-	-	-	-
19.	Materiet radioaktive në kombinatin industriale në Trepçe -Mitrovicë	Objekti-Deponim i materieve radioaktive të Nitrat toriumit	0.04 ha	-	-	-	-	+
20.	Materiet radioaktive të Tuneli i Pare, Mitrovicë	Objekti-Deponim me metere radioaktive, Stroncium, Torium dhe Americium	0.03 ha	-	-	-	-	+

²⁵ Raporti Hot-spotet mjedisore në Kosovë, AMMK 2011

21	Deponit industriale ne Zvecan	Deponi e metaleve të rënda	62.28 ha	+	-	-	-	-
22	Deponit industriale ne Leposaviq	Deponi e metaleve të rënda	20.31 ha	+	-	-	-	-
23	Deponit e Hirit i TEC A	Deponit industriale termoeenergjetike	181.97 ha	+	+	+	-	+
24	Deponia e Hirit i TEC B	Deponit industriale termoeenergjetike dhe areali i ndikimit	192.94 ha	+	+	+	-	+
25	Rezervuare me fenole	Rezervuar me fenole	177.64 ha	+	x	x	-	x
26	Deponia e Minerës ne Deve-Gjakove	Deponi me metale të renda	1 ha	+	-	-	-	-
27	Miniera në Golesh-Komuna e Lipjanit	Eksplotimi dhe përpunimi i metaleve të rënda	15.13 ha	+	-	+	-	-
28	Dy Deponi të Asbestit në Han të Elezit	Deponi me materie të asbestit	0.60 ha	+	+	-	-	+

4.5. Konkluzionet dhe Rekomandimet

Konkluzionet

- Mungesa e rrejtit nacional për monitorimin e cilësisë së dheut,
- Mungesa e programeve dhe planeve për rehabilitimin e tokave të ndotura,
- Mungesa e programeve për monitorimin e përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike,
- Mungesa e planeve dhe programeve për mbrojtjen e tokave nga erozioni dhe përmbytjet,
- Mungesa e strategjisë për mbrojtjen e tokës nga ndotja,
- Ndryshimi pa kriter i destinimit të shfrytëzimit të tokës;
- Zgjerimi i vendbanimeve në toka bujqësore
- Zgjerimi i komunikacionit rrugor dhe krijimit të zonave të reja industrial në toka bujqësore,
- Fragmentimi i parcelave

Rekomandimet

- Ngritja e rrjetit të integruar të monitorimit të dheut dhe monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së tij.
- Kompletimi i e bazës ligjore dhe strategjike për mbrojtjen e tokës nga ndotja,
- Hartimi i programeve, planeve dhe masave për mbrojtjen e tokave bujqësore;
- Hartimi i programeve, planeve dhe masave për rehabilitimin e tokave të ndotura;
- Hartimi i programeve dhe planeve për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe monitorimi i erozionit.
- Promovimi i bujqësisë organike dhe prodhimeve ekologjike;
- Kontrolli sistematik i cilësisë së produkteve ushqimore,
- Ngritja e sistemeve të kontrollit dhe monitorimit të përdorimit të pesticideve;
- Ngritja e sistemeve të kontrollit dhe monitorimit të përdorimit të plehrave.
- Ndërtimi i politikave mbi shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokave,
- Zbatimi i planeve rregullative dhe planeve urbanistike;
- Identifikimi i zonave të ndotura dhe hartimi i programeve për rehabilitim e tyre.

5. Mbrojtja e Natyrës dhe Biodiversitetit

5.1. Zonat e mbrojtura dhe gjendja e tyre

Numri i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë është 99 dhe përfshinë sipërfaqen prej 118505.5 ha, ose (11.4 % e territorit të Kosovës). Në kuadër të zonave të mbrojtura hyjnë: 11 Rezervate të Natyrës, 2 Parqe Kombëtar, 84 Monumente të Natyrës, 1 Park Regjional i Natyrës dhe 1 Peizazh i mbrojtur i natyrës. Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura përfshijnë Parqet Kombëtare “Bjeshkët e Nemuna” me (62.488 ha) dhe “Sharri” me (53.469 ha) ose me 93.5 % të sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura.

Tabela 29: Zonat e Mbrojtura të Natyrës²⁶

Kategoria IUCN	Emërtimi	Nr:	Sipërfaqja /ha
I	Rezervate të natyrës	11	846.92
	R.N. Bimore	7	
	R.N. Shtazore	2	
	R.N. Hidrologjik	1	
	R.N. gjeologjikë	1	
II	Parqe Kombëtar	2	115957
III	Monument Natyre	84	5691.48
	M.N. Spelologjike	5	
	M.N. Hidrologjike	16	
	M.N. Gjeomorfologjike	7	
	M.N. Botanike	56	
V	Park regional i natyrës	1	1126
	Pejsazh i mbrojtur	1	69
	Totali	99	118505.5 ha*

Sa i përket menaxhimit, vetëm 3 zona të mbrojtura kanë organe menaxhuese.

Menaxhimin i Parkut Kombëtar “Sharri” bëhet nga Drejtoria e Parkut me seli në Prizren që vepron në kuadër të MMPH/AMMK. Drejtoria menaxhon me territorin e Parkut Kombëtar me sipërfaqe prej (53.469 ha) që gjendet në territorin e komunave Prizren, Suharekë, Dragash, Shtërpce dhe Kaçanik. Gjithashtu edhe rezervatet që gjenden brenda territorit të Parkut Kombëtar: “Maja e Arnenit”, “Pisha e Madhe”, “Oshlaku” dhe “Rusenica” menaxhohen nga Drejtoria e PK “Mali Sharr”.

Parku regjional “Gërmia” menaxhohet nga ndërmarrja publike “Hortikultura”, ndërsa monumenti i Natyrës me rendësi të veçantë “Shpella e Gadimës” menaxhohet nga një organ që nuk është në mbikëqyrje nga institucionet lokale dhe qendrore, kurse monumenti tjetër me rendësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës” ende nuk ka organ menaxhues. Edhe monumentet tjera të natyrës që janë të shpallur nga Kuvendet Komunale menaxhohen pjesërisht nga autoritetet komunale përkatëse.

Gjatë vitit 2011-2012, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) me qëllim të monitorimit të biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura ka realizuar vizita të rregullta terreni në zonat e mbrojtura dhe ka përgatitur raporte për gjendjen e këtyre zonave, në veçanti janë dhënë mendime profesionale për biodiversitetin në përgjithësi dhe ndërhyrjet e bëra në këto zona ku janë evidentuar problemet aktuale si dhe janë rekomanduar masat për tejkalimin e tyre.

²⁶ Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës - *Sqarim: Sipërfaqja e zonave të mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare Sharri dhe Bjeshkët e Nemuna.

Janë vizituar kryesisht zonat mbrojtura me vlera te veçanta natyrore si: Shpella e Gadimes, Parku Kombëtar “Mali Sharr”, Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Parku Regjional “Gërmia”, Parku Regjional “Mirusha”, Rezervati “Bifurkacioni në lumin e Nerodimes”, Monumenti “Gryka e Rugovës”, Burimi i Drinit te Bardhë dhe zonat tjera të mbrojtura.

Janë monitoruar edhe zonat tjera të mbrojtura nëpër territoret e komunave Drenas, Skenderaj, Istog, Klinë, Therandë, etj, si dhe zonat e propozuara për mbrojtje ligjore në komunat: Mitrovicë, Malishevë, Gjakovë, Viti etj.

Është punuar edhe në hartimin e arsyeshmërisë profesionale për marrjen në mbrojtje ligjore të zonave të reja të natyrës dhe llojeve të zbutura vendore.

Projekt me rendesi është fillimi i ndërtimit të strehimores për arinjtë e murrme në Kosovë, i financuar nga Organizata Ndërkombëtare Gjermane Vier Pfoten i cili parasheh konfiskimin e të gjithë arinjve të murrme që mbahen ilegalisht neper minikopshte zoologjike, neper restorante dhe vendosja e tyre në strehimore e ngritur nga kjo organizate në afërsi të Liqenit të badovcit në Prishtinë.


Në bazë të planit të punës dhe aktiviteteve është filluar hartimi i arsyeshmërisë profesionale për vënien në mbrojtje të zonës së propozuar për mbrojtje “Ligatina e Hencit” si zonë potenciale për tu shpallur Zonë e Rëndësishme e Zogjve (Important Bird Area – IBA).

Gjithashtu është punuar edhe në hartimin e arsyeshmërisë profesionale për vënien në mbrojtje të llojeve të zbutura vendore Gjellit Kosovar Këndimgjatë dhe Deltarit Ilir.

IKMN-ja gjatë vitit 2012, në bashkëpunim me Shoqatën për Mbrojtjen e Zogjve “FINCH”, ka përgatitë për botim librin “Në kërkim të zogjve”. Ky është njëherit edhe publikimi i parë i këtij lloji për zogj në Kosovë. Zogjtë janë tregues të rëndësishëm të cilësisë së mjedisit të një vendi prandaj informacionet dhe njohuritë për përhapjen e tyre që gjenden në këtë liber janë të nevojshme për të gjithë.

Disa nga aktivitetet tjera të rendesishme të zhvilluara gjatë viteve 2011-2012 në sektorin e e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit janë: Miratimi i dy ligjeve shumë të rëndësishme për PK “Sharri dhe për PK “Bjeshkët e Nemuna”, hartimi i Planit Hapësinor për “Ujëvarat e Mirushës”, hulumtimet në shpellën “Gryka e Madhe” në Grykë të Rugovës dhe në shpellën e Radavcit nga speleologët, Çekë, Sllovenë, në bashkëpunim me shoqatën e speleologeve “Aragoniti” nga Peja dhe ekspertët e AMMK/IKMN-së dhe punimi i hartave digjitale për këto dy shpella dhe pjesëmarrja në kuadër të aktiviteteve të projektit “Parqet e Harkut Dinarik” .

Zonat e Mbrojtura



Harta 5:
Zonat e Mbrojtura

5.2. Parku Kombëtar “Sharr”

Vlerësimi i gjendjes së resurseve natyrore të Parkut Kombëtar për vitin 2011-2012 është bërë në bazë të aktiviteteve (hulumtimeve, monitorimit dhe kontrollave) të vazhdueshme në terren që janë aplikuar në të gjitha rajonet menaxhuese të Parkut Kombëtar, në veçanti në territorët që gjenden e komunat e Prizrenit dhe Suharekës. Gjatë vlerësimit të gjendjes janë analizuar ndikimet dhe pasojat negative të faktorëve biotik (njeriu, insektet dhe sëmundjet bimore) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora etj.) në florën, faunën dhe ekosistemet e Parkut Kombëtar .

Gjendja e ekosistemeve pyjore

Gjendja e pyjeve të Parkut Kombëtar është e vështirësuar si pasojë e ndikimeve negative të faktorëve biotik dhe abiotik. Këta faktorë kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve duke shkaktuar dëme të konsiderueshme pyjore dhe rrezikuar qëndrueshmërinë biologjike, në veçanti të pyjeve të rrobullit.

Pyjet e ahut (*Fagetum montanum*, *F. subalpinum*)

Pyjet e ahut kanë përhapje me të gjerë (afro 65 %) në Parkun Kombëtar. Gjendja e këtyre pyjeve është relativisht e mirë. Dëmet pyjore shkaktohen kryesisht nga fatkeqësitë natyrore (era dhe bora) dhe prerjet ilegale të cilët në këtë vit në krahasim me vitet e kaluara kanë qenë dukshëm më të vogla.

Prerjet ilegale të pyjeve në veçanti janë paraqitur në rajonin Dellocit (zonat: Tëbanët e Bukoshit, Kroni i Mbretit, Qadriqe) ku veprojnë grupet kriminale të vjedhësve të pyjeve nga fshatrat përreth (Maçitevë, Delloc etj). Vëllimi i dëmit pyjor në këtë rajon ka qenë 65 m³. Prerjet ilegale të pyjeve, dukshëm më të vogla, janë paraqitur edhe në disa zona të tjera të Parkut Kombëtar, siç janë: Gradanci (30 m³), Prevalla (25 m³) dhe Manastreci (12 m³). Në parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve kanë ndikuar angazhimet e vazhdueshme të ekipeve të Drejtorisë së PK në terrenet e rrezikuara dhe bashkëpunimi i mirë me KK të Suharekës, policinë dhe banorët lokal. Shumica e kryeseve të prerjeve ilegale të pyjeve janë zënë dhe janë proceduar në gjykatat përkatëse, por problemin e paraqet vonimi i shqyrtimit të fletpadive dhe mosrealizimi i tyre. Dëme të konsiderueshme të pyjeve të ahut ka pasur në territorin e Parkut Kombëtar që gjendet në komunat e Shtërpçës dhe Kaçanikut. Kjo është pasojë e mungesës së kompetencave menaxhuese të Drejtorisë së PK (MMPH-së) në këto dy komuna që menaxhohen nga institucionet paralele serbe në Shtërpçe dhe Agjencia pyjore e Kosovës në Kaçanik, të cilët kanë bërë prerje të mëdha të pyjeve që vlerësohen me qindra apo mija kubik. Për këto shkatërrime të pyjeve janë informuar instancat më të larta të MMPH-së.

Në rajonet e ndryshme të pyjeve të ahut vërehet prania sporadike e faktorëve fitopatologjik (sëmundjet bimore), në kuadër të cilëve veçohen tumori i lëvores (*Nectria ditissima*) dhe kërpudha e kalbjes (*Fomes fomentarius*). Këta faktorë biotik paraqiten kryesisht në drutë e ahut me imunitet të dobësuar si pasojë e vjetërsisë dhe dëmtimeve të ndryshme të shkaktuara nga faktorët e tjerë biotik dhe abiotik.



Kërpudha e kalbjes në trungun e ahut (*Fomes fomentarius*)



Tumori i lëvores (*Nectria ditissima*)

Pyjet e rrobullit (Pinetum heldreichii)

Gjendja shëndetësore e pyjeve të rrobullit (Pinetum heldreichii) është e vështirë si pasojë e zjarreve pyjore që kanë ndodhur në vitet 2000 dhe 2007 si dhe zhvillimit të madh të insekteve dëmtues (nënlivorësve të pishës Blastophagus sp.) që janë shfaqur në mënyrë masive pas zjarreve si rezultat i dobësimit të imunitetit të drunjëve të dëmtuara. Pyjet e rrobullit, për shkak të karakterit endemo-relikt, paraqesin pyjet më të rëndësishme të Parkut Kombëtar, mirëpo, pikërisht këto pyje janë edhe më të dëmtuara. Pasi që shumica e drunjëve të rrobullit janë të prekur nga zjarri pyjor dhe nënlivorsit e pishës, ekziston mundësia e zgjerimit të tharjes së pyjeve të rrobullit duke rrezikuar ekzistencën biologjike të këtyre pyjeve.

Përmirësimi i gjendjes së pyjeve të rrobullit në aspektin shëndetësor dhe të ripërtëritjes natyrore, në dy vitet e fundit, vërehet në Oshlak (rajoni i Prevallës) si pasojë e ndërmarrjes së pastrimeve sanitare të druve të thara, të kalbura dhe të infektuara nga nënlivorësit (Blastophagus sp.) dhe fitopatogjenet e kalbjes (kërpudhat). Ndërhyrjet sanitare janë ndërmarrë në pyjet e rrobullit që gjenden në zonën e dytë të mbrojtjes, jashtë zonës strikte natyrore Maja e Arnenit.

Gjatë vitit 2011 dëmet nga zjarri janë shfaqur në pyjet e rrobullit në zonën e Pashallarës ku janë djegur afro 4 ha të këtyre pyjeve, ndërsa me intervenimin e punëtorëve të Drejtorisë së PK, komunës së Suharekës, zjarrfikësve dhe qytetarëve zjarri është lokalizuar dhe janë parandaluar dëmet më të mëdha pyjore.

Ripërtëritja natyrore e pyjeve të rrobullit është e pamjaftueshme, si pasojë e dëmtimeve të konsiderueshme të pyjeve, dobësimit të vitalitetit të drunjëve si dhe pranisë së dendur të llojeve barishtore.



Foto- Drutë e infektuar nga nënlivorsit



Foto:Pyjet e djegura të rrobullit në zonën e Pishës së Madhe

Pyjet e arnenit (Pinetum peucis)

Gjendja e pyjeve të arnenit (Pinetum peucis) është e mirë. Këto pyje kanë ripërtëritje të mirë në habitatet e tyre në Ujërat e Humbur dhe Pashallare ku janë duke e zgjeruar sipërfaqen dhe krijuar përbërje të reja pyjore. Dëmet e konsiderueshme në pyjet e arnenit janë shfaqur në zonën turistike të Brezovicës (mbi motelin Molika) si pasojë e prerjeve rrah (të pastër) të pyjeve në sipërfaqe prej afro 1 ha nga OJQ për skijim „Scardus” nga Prishtina në bashkëpunim me organizatën ilegale serbe të parkut nacional nga Shtërpca.

Gjithsej janë prerë rreth 5000 dru me diametër prej 3 cm deri 40 cm dhe vjetërsi prej 5 deri 42 vjeçare. Sasia e përgjithshme e masës së prerë drunore ka qenë mbi 50 m³. Drutë e prera janë grumbulluar në zonën turistike (nën hotelin Molika). Ky rast është proceduar në gjykatën përkatëse nga inspektorati i MMPH.



Foto: Pyjet e arnenit në zonën e Ujërave të Humbur në gjendje të mirë

Pyjet e tjera të halorëve dhe gjethorëve

Dëme të konsiderueshme nga zjarri kanë pësuar pyjet e hormoqit në zonën e Pashallarës që shtrihen në komunën e Shtërpcës (janë djegur mbi 5 ha të këtyre pyjeve) dhe pyjet e ulëta dhe shkurret e shkozës dhe frashrit të zi si dhe kulturat e pishës në Oshlak ku janë djegur afro 50 ha. Këto zjarre kanë ndodhur në fund të muajit gusht dhe në fillim të shtatorit. Me angazhimin e punëtorëve të Drejtorisë së Parkut Kombëtar, zjarrfikësve dhe institucioneve të tjera zjarret janë lokalizuar duke shmangur dëmet më të mëdha më pasojë katastrofike. Shkaktarët e zjarreve në të gjitha rastet janë njerëzit të pandërgjegjshëm dhe pakujdesshëm, të cilit në asnjë rast nuk janë identifikuar.



Foto: Lokalizimi i zjarrit në Pashallarë



Foto: Zjarri në Oshlak (gusht 2011)

Gjendja e ekosistemeve shkurre, barishtore dhe bimëve endemike

Ekosistemet më të rëndësishme shkurre në Parkun Kombëtar janë të: dredhakut (*Pinus mugo*), dëllinjës së siberisë (*Juniperus nana*) dhe boronicës (*Vaccinium myrtillus* dhe *V. uliginosum*). Gjendja e këtyre vegjetacioneve është e mirë, ndërsa dëme në këtë vit (në fillim të shtatorit) kanë pësuar nga zjarri në sipërfaqe prej afro 10 ha në zonën e Pashallarës.

Vegetacionet shkurre të dëllinjës dhe boronicës kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme nga zjarret që kanë ndodhur në muajin nëntor me ç`rast janë djegur afro 200 ha të këtyre ekosistemeve. Këto zjarre janë shkaktuar nga njerëzit e pandërgjegjshëm, ndërsa në përmasat e mëdha të dëmeve (djegieve) kanë ndikuar thatësira gjatë vjeshtës dhe terrenet e papërshtatshme malore për intervenime në lokalizimin e zjarreve.

Gjendja e bimëve të rralla barishtore, të cilët i japin vlerë të veçantë florës së Parkut Kombëtar, është e mirë dhe e qëndrueshme. Këto bimë gjenden kryesisht në zonat më të larta (mbi 1800 m) të Parkut Kombëtar dhe janë pjesë përbërëse e kullosave të maleve të larta.

Disa lloje të rralla të bimëve mjekuese janë objekt i shfrytëzimit ilegal nga njerëzit të papërgjegjshëm. Bima më e rrezikuar është sanëza (*Gentiana lutea*) e cila mbledhet nga banorët lokal dhe personat e ndryshëm që e përdorin për tregti (përfitime personale) pasi që ajo ka vlera të veçanta mjekuese. Sanëza gjendet në pjesët më të larta (mbi 1800 m) të territorit të Parkut Kombëtar, ndërkaq si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar në të kaluarën mbijetesa e saj është mjaft e rrezikuar. Në këtë vit tentime për mbledhje ilegale të kësaj bime kanë qenë të kufizuara për shkak të angazhimeve të vazhdueshme të Drejtorisë së PK në lokacionet ku ajo është e pranishme.



Sanëza (*Gentiana lutea*) bimë mjekuese e rrezikuar



Burnmullera dieckii - bimë stenoendemike

Gjendja e Faunës

Gjendja e përgjithshme e faunës në Parkun Kombëtar mund të vlerësohet si relativisht e mirë. Nga gjurmimet e bëra në terren janë verifikuar shumica e kafshëve të egra që kanë qenë të regjistruara nga hulumtimet e mëhershme, ndërsa shënimet për disa lloje më të rëndësishme të Parkut Kombëtar janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 30: Gjendja e kafshëve të egra në PK (komunat e Prizrenit dhe Suharekës) për vitin 2011-2012.

Lloji i kafshës së egër	Gjendja e fondit (numri) gjatë vitit 2011
Ariu i murrmë (<i>Ursus arctos</i>)	45-50
Kaprolli (<i>Capreolus capreolus</i>)	50-60
Rrëqebulli (<i>Lynx lynx</i>)	6-8
Dhia e egër (<i>Rupicapra rupicapra</i>)	250
Derri i egër (<i>Sus scrofa</i>)	200
Lepuri (<i>Lepus europeus</i>)	150-200
Ujku (<i>Canis lupus</i>)	10-15
Shqiponja e përhimët (<i>Aquila chrysaetos</i>)	6
Thëllëza gurore (<i>Alectoris greace</i>)	200
Pula e pyjeve (<i>Tetrastes bonasia</i>)	30-40

Numri i shumicës së kafshëve është në rritje në krahasim në vitet e kaluara, mirëpo numri i disa kafshëve të egra si rrëqebulli dhe shqiponja e përhimët është mjaftë i vogël. Shumica e llojeve të gjitarëve, të cilët kanë qenë të regjistruar gjatë hulumtimeve të mëparshme janë verifikuar në terren, mirëpo, për përcaktimin e numrit të tyre nevojiten gjurmimet më intensive në të gjitha rajonet e Parkut Kombëtar. Për të siguruar mbrojtjen e mirëfilltë institucionale dhe ligjore të llojeve të rralla shtazore, nevojitet që habitatet e tyre të shpallën si rezervate strikte të natyrës siç është propozuar në Draftin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Mali Sharr” (2009). Shumë prej kafshëve të egra, siç janë ariu i murrmë, ujku, rrëqebulli, dhelpira, lepurit, derri i egër, kaprolli etj. migrojnë në pjesët e ndryshme të Parkut Kombëtar dhe jashtë territorit në kërkim të ushqimit.

Gjendja shëndetësore të kafshëve të egra është e mirë (nuk janë vërejtur kafshë të sëmura apo të ngordhura), ndërkaq rrezikun e vazhdueshëm për kafshët e egra paraqet gjuetia ilegale nga njerëzit të pandërgjegjshëm.

Riprodhimi natyror i shumicës së kafshëve të egra është relativisht i kënaqshëm, në veçanti të ariut të murrmë dhe ujkut të cilit në Parkun Kombëtar kanë zhvillim mjaftë të mirë.



Lynx Lynx lloji i rrezikuar, Ursus arctos dhe Canis lupus-kafshët më zhvillim të mirë në PK

5.2. Konkluzionet dhe rekomandimet

Konkluzionet:

- Implementimi jo i kënaqshëm i ligjeve ekzistuese;
- Mungesa e institucioneve të mjaftueshme për mbrojtjen e natyrës;
- Mungesa e organeve menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Mungesa e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Shfrytëzim i pakontrolluar i resurseve natyrore;
- Mungesa e hulumtimeve shkencore për biodiversitetin;
- Mungesa e inventarit të plotë për florën, faunën dhe habitatet;
- Buxheti i pamjaftueshëm për natyrën;

Rekomandimet

- Hulumtimi, inventarizimi i llojeve dhe habitateve;
- Hartimi i Listës së Kuqe të florës dhe faunës për Kosovën;
- Përkrahja e projekteve ndërkufitare për mbrojtjen e natyrës;
- Përgatitja e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura të natyrës;
- Hartimi i programeve dhe projekteve për ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimit për mbrojtjen e natyrës;
- Themelimi i zyrës koordinuese për identifikimin, ratifikimin dhe implementimin e konventave dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës.

6. Mbeturinat

6.1. Mbeturinat Komunale

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është në gjendje të veshtirë gjë që paraqesin një problem mjaft të madh për vendin tonë. Mesatarisht në Kosovë me shërbimin për grumbullimin e mbeturinave komunale shërbehen 42% (viti 2007), 39% (viti 2008) përkatësisht 42% (viti 2009) e 49% (viti 2010) e popullatës. Regjioni i Prishtinës mbulon përqindjen më të lartë të popullatës me këtë shërbim me 64% (për vitin 2007), përkatësisht 52 % (për vitin 2008), 53% (për vitin 2009), dhe 55% (për vitin 2010), ndërsa regjioni i Mitrovicës më të ulët me vetëm 29% (2007-2008), përkatësisht 30% (për vitin 2009 e 2010). Rritjen më të madhe për vitin 2010 e ka pasur Regjioni i Ferizajit me 66%. Në zonat urbane (qytete), shërbimi i grumbullimit të mbeturinave u ofrohet përreth 90% të popullatës, ndërkaq zonat rurale mbulohen me këtë shërbim vetëm me rreth 10%. Te gjitha KRM kanë në dispozicion gjithsej 189 automjete, përfshirë traktorë dhe kamion të tipeve të ndryshme të cilat kryesisht janë në gjendje të vjetruar dhe ndikojnë dukshëm në produktivitetin e KRM.

Të dhënat e detajuara për shërbimet e ofruara për grumbullimin e mbeturinave sipas kompanive dhe regjioneve janë prezantuar në tabelën 31.

Tabela 31: Popullata që shërbehet me mbledhjen e mbeturinave sipas kompanive dhe regjioneve për periudhën 2007-2010 shprehur në %²⁷

Nr.	Kompania	Regjioni	Viti			
			2007	2008	2009	2010
1	Ambienti	Pejë	44%	29%	36%	54%
2	Çabrati	Gjakovë	51%	53%	52%	56%
3	Ekoregjioni	Prizren	32%	39%	38%	37%
4	Higjiena	Gjilan	44%	26%	33%	47%
5	Pastërtia	Ferizaj	33%	35%	44%	66%
6	Pastrimi	Prishtinë	64%	52%	53%	55%
7	Uniteti	Mitrovicë	29%	29%	30%	30%

Figura e më poshtme tregon strukturën sipas llojeve të mbeturinave në nivel të Kosovës. Sasia e tyre është kalkuluar duke u bazuar në hulumtimet që janë bërë në 4 qytete të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Viti dhe Hani i Elezit. Hulumtimet janë pjesë e planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave të përkrahura nga GIZ, JICA dhe LOGOS.

²⁷ Zyra Rregullatore për ujë dhe mbeturina, ZRRUK 2010.




Fig.6g. Sasia e mbeturinave sipas llojit (2012)

Në tabelën në vijim është paraqitur struktura sipas llojeve të mbeturinave në katër qytete ku janë zhvilluar planet komunale për menaxhimin e mbeturinave: Prishtinë, Prizren, Viti dhe Hani i Elezit. Nëse e krahasojmë strukturën sipas llojeve të mbeturinave në Prishtinë në vitin 2003 dhe në vitin 2012 atëherë shihet se struktura sipas llojeve të mbeturinave ka ndërruar ndjeshëm (figura 70).




Figura 70. Mbeturinat sipas llojeve në Kosovë 2008 (%)²⁸

Të dhënat e prezantuara në tabelat 32, 33, 34 dhe 35 tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave gjatë vitit 2009, është deponuar në deponinë e Prishtinës (84,660.59 ton), ndërsa sasia më e vogël është grumbulluar në deponinë e Sharrit (4807.00 ton). Kjo vlen edhe për vitin 2010 ku, sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara është në deponinë e Prishtinës (83,742.23 ton), ndërsa sasia më e vogël është deponuar në deponinë e Sharrit (5081.7 ton). Në vitin 2011 sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara përsëri është në deponinë e Prishtinës (81,816.63 ton) ndërsa sasia më e vogël është deponuar në deponinë sanitare të Sharrit (5248.00 ton). Situata është e ngjajshme edhe për vitin 2012 ku sasia më e madhe e mbeturinave është deponuar në deponinë sanitare të Prishtinës (78,393.54 ton) ndërsa më e vogla në Sharr (4,530.00 ton).

Nëse i krahasojmë të dhënat për mbeturinat e deponuara në deponitë sanitare për vitet 2009, deri në vitin 2012 vërehet se në të gjitha deponitë regjionale dhe komunale ka pasur sasi më të mëdha mbeturinave.

Sasia e gjenerimit të mbeturinave ka qenë më e madhe gjatë vitit 2011. Në vitin 2012 vërehet një rënie në grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave në deponi sanitare nga kompanitë për grumbullimin e mbeturinave.

²⁸ Raporti Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2008, AMMK

Tabela 32. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2009 të shprehura në ton²⁹

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	6,967.45	6,060.84	7,794.76	8,539.91	8,299.89	8,588.45	4,383.72	6,335.95	7,264.75	7,831.62	5,206.45	7,386.80	84,660.59
2	Gjilan*	3,642.26	3,236.29	3,604.45	4,537.04	4,582.66	4,336.01	2,392.61	4,488.12	2,552.47	2,513.01	4,129.69	2,551.62	42,566.23
3	Prizren*	2,705.50	2,543.73	3,088.40	3,836.50	3,520.25	3,377.93	1,968.20	4,267.22	4,553.70	1,691.30	3,672.67	3,402.00	38,627.40
4	Podujevë*	360.33	358.84	463.06	610.02	509.86	503.32	353.05	448.96	496.45	589.86	589.17	618.93	5,398.53
6	Pejë**	1677	1480	1820	1899	1823	1930	2250	2370	2160	2040	1855	1873	23177
7	Sharr	314	296	331	415	426	366	534	573	450	419	359	324	4807.00
8	Mitrovicë**	2,302.64	1,927.15	2,888.88	3,308.14	3,045.8	3,031.27	3,378.98	2,903.9	3,014.58	3,099.68	2741.01	2,553.79	34,195.82
9	Ferizaj*	1,069.39	1,250.90	1,002.60	1,732.20	1,411.50	609.30	710.30	285.29	1,845.17	1,895.93	991.75	969.75	13,774.08
	Totali	19,038.57	17,153.75	20,993.15	24,877.81	23,618.96	22,238.96	15,970.86	21,672.44	22,337.12	20,080.40	19,544.7	19,679.8	247,206.65

Tabela 33. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2010 të shprehura në ton³⁰

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	6,423.75	6,326.54	6,852.50	6,395.38	6,706.95	6,330.10	7,063.85	7,331.98	7,508.48	7,826.96	8,077.71	6,898.03	83,742.23
2	Gjilan*	2,093.95	2,231.51	3,070.35	3,695.06	3,176.08	2,577.95	3,658.85	3,088.35	2,716.37	2,573.78	2,260.79	1,951.08	33,094.12
3	Prizren*	2,855.10	2,772.46	3,507.78	3,912.80	3,966.40	4,067.30	4,645.91	5,380.65	5,098.00	5,538.78	5,958.34	4,685.90	52,389.42
4	Podujevë*	513.60	407.97	18.80	1,355.10	26.95	2,507.72	38.11	40.49	44.05	567.01	594.01	510.80	6,624.61
6	Pejë**	1,662	1,395	1,400	2,226	2,177	2,168	2,168	2,756	2,440	2,178	2,202	1,884	24,656
7	Sharr	282.5	292	301.2	415	408	409	457	628	628	420	421	420	5081.7
8	Mitrovicë**	2,275	2,307	2,992	2,707	2,708	2,763	3,502	3,555	3,950	3,569	3,231	2,909	36,469
9	Ferizaj*	988.75	357.90	643.10	667.40	569.10	1,294.59	1,061.55	1,672.30	1,608.00	1,608.60	1,496.50	1,521.40	13,489.19
	Totali	17,094.65	16,090.38	18,785.73	21,373.74	19,738.48	22,117.66	22,595.27	24,452.77	23,992.90	24,282.13	24,241.35	20,780.21	255,546.27

29 KDMK dhe ZRRUK, 2009

30 KDMK dhe ZRRUK, 2010

Tabela 34. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2011 të shprehura në ton ³¹

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	6,129.63	5,503.53	6,663.36	6,898.88	6,868.26	6,811.13	7,111.31	7,293.80	7,572.41	7,090.16	6,845.34	7,028.82	81,816.63
2	Gjilan*	1,690.72	1,651.22	2,811.63	2,531.37	2,687.38	2,857.74	3,196.94	3,646.87	3,440.74	3,100.12	2,658.29	2,663.49	32,936.51
3	Prizren*	4,517.30	4,015.60	4,994.20	5,086.26	5,812.93	5,544.70	6,135.50	7,035.70	6,290.30	5,946.53	5,112.50	4,571.40	65,062.92
4	Podujevë*	399.89	391.09	903.84	522.36	651.86	345.00	648.98	691.07	711.45	698.47	602.11	548.99	7,115.11
6	Pejë**	1427	1316	1763	2182	2128	2152	2117	2398	2075	2099	1853	1740	23,250.00
8	Mitrovicë**	2416.22	2213.39	3161.5	3122.78	3196.14	3724.74	3776.18	3756.65	3344.42	2903.31	2520.9	2425.74	36,561.97
9	Ferizaj*	1,348.40	1,185.60	981.85	1,257.79	1,497.20	1,651.74	1,886.45	1,966.70	1,954.50	1,831.80	1,701.00	1,533.90	18,796.93
	Totali	17,929.16	16,276.43	21,279.38	21,601.44	22,841.77	23,087.05	24,872.36	26,788.79	25,388.82	23,669.39	21,293.14	20,512.34	265,540.07

Tabela 35. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2012 të shprehura në ton ³²

2012	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	5287.08	5096.30	7592.91	6757.77	6371.67	6895.66	6996.11	7614.35	7097.02	6832.30	6092.71	5759.66	78,393.54
2	Gjilan*	1967.35	1933.20	2949.51	2455.28	2948.26	1968.33	1850.30	3324.31	2710.95	3517.97	3520.11	2608.01	31,753.58
3	Prizren*	4047.20	3246.60	6207.46	5378.50	6198.80	5070.90	5298.30	6950.20	5456.00	5245.90	5210.70	3438.60	61,749.16
4	Podujevë*	489.20	377.00	650.34	551.40	1166.70	652.55	581.75	644.70	674.00	701.30	540.70	498.45	7,528.09
6	Pejë**	2122.00	1189.00	2847.00	2472.00	3138.00	2754.00	2948.00	3855.00	2921.00	3121.00	2785.00	2471.00	32,623.00
7	Sharr	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	4,530.00
8	Mitrovicë**	2296.87	1847.29	3255.76	2839.98	3162.07	2562.78	3052.78	3278.53	2804.41	3133.40	2687.63	2536.51	33458.20
9	Ferizaj*	1326.60	947.48	2143.78	1759.03	1703.60	983.40	478.10	719.10	795.30	1459.09	1096.23	861.80	14,273.51
	Totali	17,913.8	15,014.37	26,024.26	22,591.46	25,066.6	21,265.12	21,582.84	26,763.69	22,836.18	24,388.46	22,310.58	18,551.53	264,309.08

* KDMK

**ZRRUK

31 KDMK dhe ZRRUK, 2011

32 KDMK dhe ZRRUK, 2012




Figura 71: Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare sipas viteve

Sasia e mbeturinave të gjeneruara për person në Kosovë për vitin 2008 është 167 kg, për vitin 2009 është 193 kg, për vitin 2010 është 297 kg, ndërsa për vitin 2011 është 335 kg, gjë që tregon një rritje të ndjeshme të sasisë së mbeturinave për kokë/banori. Krahasuar me regjionet tjera sasi më e madhe vjetore e mbeturinave për person gjenerohet në regjionin e Prishtinës, për vitin 2008 0.9kg, 2009 është 1.2 kg, në vitin 2010 është 1.4 kg dhe për vitin 2011 është 1.3 kg. Ndërsa në regjionet tjera 0.3 kg në vitin 2008 dhe 2009 0.6 kg në vitin 2010 dhe 0.8 kg në vitin 2011.

Tabela 36. Sasia mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë për banoërë (kg/vit dhe kg/ditë) për 2008- 2011³³

Vendi i grumbullimit	2008			2009			2010			2011		
	Sasia e Grumbulluar	Mbeturinat	Mbeturiatn/banore/Dite	Sasia e Grumbulluar	Mbeturinat	Mbeturiatn/banore/Dite	Sasia e Grumbulluar	Mbeturinat	Mbeturiatn/banore/Dite	Sasia e Grumbulluar	Mbeturinat	Mbeturiatn/banore/Dite
Njesia	1000/Ton	Kg/Banore		1000/Ton	Kg/Banore		1000/Ton	Kg/Banore		1000/Ton	Kg/Banore	
Prishtina dhe regjioni	198	396	0.9	218	436	1.2	222	511	1.4	230	488	1.3
Regjionet tjera ne Kosove	153	95	0.3	187	117	0.3	293	223	0.6	352	278	0.8
Kosova gjithesej	351	167	0.5	405	193	0.5	515	297	0.8	582	335	0.9

Të dhënat e prezantuara në figurat 72, 73 dhe 74, tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave grumbullohet sipas shërbimit “derë me derë”, ndërkohë që sipas shërbimit për banesa kolektive ky grumbullim është më i vogël. Ky dallim në mes të sasisë së mbeturinave të grumbulluara sipas shërbimit “derë me derë” dhe atij për banesa kolektive është me pak i shprehur në regjionet tjera të Kosovës, krahasuar me regjionin e Prishtinës.

³³ Anketa e mbeturinave komunale 2011, ASK



Figura 72: % e mbeturinave sipas mënyres së grumbullimit në nivel të Kosovës

Në Kosovë grumbullimi i mbeturinave derë më derë ishte 57 %, ndërsa në banimin kolektiv ka qenë 43 %.




Figura 73 dhe 74: % e mbeturinave sipas mënyres së grumbullimit sipas regjioneve

Në regjionet tjera në Kosovë grumbullimi i mbeturinave komunale ishte në raport 45% në banim kolektiv dhe 55% në banim derë më derë. Ndërsa në regjionin e Prishtinës 41% në banim kolektiv dhe 59% derë me derë.

6.2. Mbeturinat industriale

Sipas një anketimi të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2010 sasia e mbeturinave industrilae është 580,154 ton, ku 36,241 nga to janë mbeturina të rrezikshme ndërsa pjesa tjetër mbeturina jo të rrezikshme (Fig.76). Me poshtë janë të paraqitura tabelat me sasinë e mbeturinave industriale nga bizneset me shtatë ose më shumë punëtorë dhe ato me më pak se shtatë punëtorë.




Figura 75: Sasinë e mbeturinave industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme³⁴.

³⁴ Anketa e mbeturinave industriale 2010, ASK

Sasia më e madhe e mbeturinave të gjeneruara është në sektorin e prodhimeve të ushqimit dhe pijeve, 49% të industrisë me më shumë se shtatë punëtorë respektivisht 69% të industrisë me më pak se shtatë punëtorë (Tabelat 37 dhe 38). Në bazë të këtyre tabelave shihet se sasi e madhe e mbeturinave vjen edhe nga minierat. Minierat poashtu gjenerojnë sasi të madhe të mbeturinave të rrezikshme.

Tabela 37: Sasitë e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me shtatë ose më shumë punëtorë³⁵.

Grupi	Lloji i industrisë	Mbeturinat jo të rrezikshme në ton	Mbeturinat të rrezikshme në ton
14	Miniera dhe gurore tjera	172.686	35.500
15-16	Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve / Prodhimi i produkteve të duhanit	297.173	550
17-19	Tanimi ose mbulesat nga lëkura; prodhimi valixhes, çanta dore, takëme, parzmore dhe këpucë	297	-
20-22	Botimi, shtypja dhe riprodhimi i mediave të regjistruara	445	85
23-25	Prodhimi i gomës dhe prodhimeve plastike	3451	-
26	Prodhimi i produkteve të tjera jometalike minerale	94.490	34
27-29	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve n.e.c	415	-
30-35	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit	-	-
36	Prodhimi i mobiljeve, prodhimi n.e.c	47	30
37	Reciklimi	15.326	-
40	Furnizimin me energji elektrike, gaz, avull dhe ujë të nxehtë	11	-
41	Mbledhja, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	244	-
Total		566.666	36.199

Tabela 38: Sasitë e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me më pak se shtatë punëtorë³⁶.

Grupi	Lloji i industrisë	Mbeturinat jo të rrezikshme në ton	Mbeturinat të rrezikshme në ton
14	Miniera dhe gurore tjera	2.654	1.0
15-16	Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve/ Prodhimi i produkteve të duhanit	9.403	-
17-19	Tanimi ose mbulesat nga lëkura; prodhimi valixhes, çanta dore, takëme, parzmore dhe këpucë	211	-
20-22	Botimi, shtypja dhe riprodhimi i mediave të regjistruara	37	-
23-25	Prodhimi i gomës dhe prodhimeve plastike	45	0.3
26	Prodhimi i produkteve të tjera jometalike minerale	344	-
27-29	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve n.e.c	16	0.2
30-35	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit	352	-
36	Prodhimi i mobiljeve, prodhimi n.e.c	265	-
37	Reciklimi	226	40.0
40	Furnizimin me energji elektrike, gaz, avull dhe ujë të nxehtë	-	-
41	Mbledhja, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	-	-
Total		13.588	41.5

Sasia totale e mbeturinave industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të gjeneruara në ton është 580,154 ton, ku rreth 66% prej tyre trajtohen.

35 Anketa e mbeturinave industriale 2010, ASK

36 Anketa e mbeturinave industriale 2010, ASK

Tabela 39: Sasitë e mbeturinave të gjeneruarr, të mbeturinave të rrezikshme dhe të trajtuara³⁷

Lloji i industrisë	Mbeturinat e gjeneruara në ton	Mbeturinat e gjeneruara në ton	Mbeturinat të trajtuara në ton
C, D dhe E	580,154	36,241	383,323

6.3. Deponitë sanitare

Deponia sanitare në Pejë- Kjo deponi ka sipërfaqe prej 4.85 ha. Edhe pse e ndërtuar sipas standardeve, gjendja aktuale dhe menaxhimi i kësaj deponie është e keqe. Kjo deponi pothuajse është jo funksionale pasi nuk ka hapësirë për deponimin e mbeturinave. Mos funksionimi i pompave të lagunës dhe mos mbulimi i mbeturinave bëjnë që gjendja në këtë deponi të shkojë drejt përkeqësimit edhe më të madh dhe mbylljes përfundimtare.

Deponia sanitare në Gjilan - Në këtë deponi grumbullohen mbeturinat nga Komuna e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Kaçanikut, Shtimjes dhe Ferizajt. Madhësia e deponisë është 20.50 ha dhe kohëzgjatja e përdorimit të saj vlerësohet deri në 15 vite. Kapaciteti total është 1.222 222 m³, ndërsa kapaciteti mujor 4000 t.³⁸ Deponia Regjionale e mbeturinave në këtë komunë edhe pse është ndërtuar me standarde, nga keq menaxhimi ajo tani është shndërruar në një ndotës të madh për mjedisin në këtë lokalitet. Në këtë deponi ka djegie të vazhdueshme të mbeturinave gjë që paraqet rrezik permanent për punëtorët e deponisë dhe ndotjen e ajrit. Momentalisht pompat janë duke funksionuar në këtë deponi dhe nuk ka perzierje të ujërave të deponisë me ujërat sipërfaqësore.

Deponia në Prizren- Deponia ka 14 ha dhe gjendet në fshatin Landovicë të Prizrenit. Është e ndërtuar në vitin 2004 me ndihmën e fondeve nga Bashkimi Evropian. Si pasojë e keq menaxhimit në këtë deponi nuk funksionon sistemi i pompimit. Ujërat e zeza që vijnë nga deponia dalin jashtë lagunës dhe perzihen me ujërat sipërfaqësore. Keto ujëra janë të ndotura me kemikate të ndryshme që vijnë nga substancat e ndryshme që deponohen në këtë deponi. Një problem tjetër është edhe mos mbulimi i mbeturinave të cilat kanë arritur deri te vega.

Deponia sanitare në Mirash- Në kuadër të kësaj deponie bëhet grumbullimi i mbeturinave për komunat: Prishtinë, Obiliq, Lipjan. Fushë Kosovë dhe Drenas (Glllogoc). Madhësia e përgjithshme e kësaj deponie është rreth 40 ha. Kohëzgjatja e deponisë është 15 vjet. Kapaciteti total është 3.500 000 m³, ndërsa kapaciteti mujor 6000 T. Gjatë vizitave monitoruese në këtë deponi është konstatuar se gjendja është shumë e rëndë si pasojë e keq menaxhimit të deponisë. Si pasojë e keq menaxhimit dhe mosfunksionimit të pompave ka ardhë deri te krijimi i një bazeni të madh me ujërat të zeza të cilat perzihen me ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Gjithashtu në këtë deponi nuk bëhet shtypja dhe mbulimi i mbeturinave andaj hapësira në këtë deponi është duke u zvogëluar.

Deponia sanitare në Podujevë - Kjo deponi përfshinë lokalitetet e komunës së Podujevës. Madhësia e deponisë është 5 ha. Kohëzgjatja e kësaj deponie është 15 vjet. Kapaciteti total është 925 000 m³, ndërsa kapaciteti mujor 2000 T. Edhe në këtë deponi gjendja nuk është e mirë, pasi që mjetet për shtypjen e mbeturinave janë në defect. Në këtë deponi funksionon sistemi i pompimit dhe nuk ka rrjedhje të ujërave nga kjo deponi.

Deponia sanitare në Mitrovicë- Në Deponinë sanitare të Mitrovicës frekuentojnë mbeturinat urbane të qytetit të Mitrovicës, Vushtrrisë, Skenderajt dhe Zubin Potokut. Deponia gjendet afër Fshatit Gërmovë. Deponia ka një hapësirë të shtrirjes prej 7 ha, me një kohëzgjatje prej 15 vite, dhe me një kapacitet të deponimit deri në 2.000000 t. Që nga viti i ndërtimit e deri me sot nuk janë evidentuar informata se në këtë deponi janë të hedhura mbi 36 mijë tonelata mbeturina urbane në vit. Nëse bëhet një analizë për periudhën e jetëgjatësisë dhe kapacitetit të mbeturinave që mund të deponohen atëherë del se kjo deponi do të duhej të kishte një jetëgjatësi mbi 50 vite. Deponia që nga ndërtimi

³⁷ Anketa e mbeturinave industrial 2010, ASK

³⁸ Raport-Gjendja e Mbeturinave në Kosovë, 2008

qe llogaritet me standarde e deri në ditët e sotme është percjellur me probleme të ndryshme prej asaj teknike e deri te ato profesionale.

Këto kanë ndikuar që gjendja e deponisë të jetë jo e mirë, duke shkaktuar ndikime serioze në mjedis dhe shëndet të popullatës. Ka kohë që në këtë deponi bëhet përzierja e ujërave sipërfaqësore dhe ato te deponisë, dhe si rezultat ujërat dalin të patrajuara. Kjo është si rezultat i mos funksionimit të pompave për trajtim të ujërave që rrjedhin nga deponia. Kjo situatë është aktuale deri në ditët e sotme.

6.4. Konkluzionet dhe Rekomandimet

Konkluzionet

- Sistemi për administrimin e mbeturinave nuk është efikas dhe ka ngecje në shumë çështje;
- Mbeturinat komunale mblidhen dhe grumbullohen në shkallë vendi nga vendbanimet e Kosovës në masën deri në 50 %;
- Gjendja në deponitë e Kosovës është shumë e keqe dhe ka numër të madh të deponive të egra;
- Ka mungesë të sistemit të monitorimit të gjendjes së mbeturinave dhe mungesë të mekanizmave efikas për ndarjen dhe seleksionimin e mbeturinave;
- Mungesë e projekteve për riciklimin e mbeturinave dhe nevojë për investime në sektorin e mbeturinave;
- Inkasim i ulët për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave;
- Bashkëpunim jo i mjaftueshëm në mes të institucioneve;

Rekomandimet

- Fuqizimi i institucioneve menaxhuese të mbeturinave dhe forcimi i institucioneve lokale lidhur me menaxhimin e mbeturinave;
- Implementimi dhe kompletimi i bazës ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Promovimi i riciklimit të mbeturinave;
- Vetëdijesimi i popullatës lidhur me hedhjen e mbeturinave në vende adekuate dhe për kryerjen e obligimeve ndaj kompanive shërbyese;
- Ndalimi i hedhjes së mbeturinave në deponi ilegale dhe në fushë hedhurina;
- Hartimi i programeve për zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Hartografimi i të dhënave për administrimin e mbeturinave.

7. Mjedisi dhe shëndeti publik

7.1. Ndikimi i mjedisit në shëndetin publik

Te gjitha studimet e gjertanishme kanë treguar se mjedisi i ndotur ka ndikim negativ në shëndetin publik. Në cilësinë e jetës së popullatës dhe në jetëgjatësinë ndikojnë një seri faktorësh mjedisorë; cilësia e ajrit, ujit, standardi i jetës, kushtet e ambientit të punës dhe shumë faktorë tjerë të involvuar në mënyrë direkte apo indirekte.

Gjendja jo e favorshme e mjedisit, mos qasja e plotë e popullatës në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizim, ekspozimi ndaj ajrit të ndotur, mbeturinave dhe kemikateve janë disa nga treguesit kryesor të kualitetit të jetës, në raport me mjedisin.

Është çështje evidente se ndotja e mjedisit (komponentëve të saj), shkakton probleme serioze në shëndet publik si; sëmundjet respiratore, sëmundje të zemrës, të lëkurës dhe vdekje të parakohshme si dhe sëmundje të tjera të përcjellura me çrregullime hormonale, çrregullime në rritje dhe zhvillim, kancer, alergji etj.

Vendi ynë edhe pse ka një trend të rritjes së standardit të jetesës dhe përmirësimit gradual të mjedisit, ende ka shumë për të bërë për të krijuar kushte për një mjedis cilësor. Në rritjen e problemeve shëndetësore ka ndikim edhe mungesa e kushteve socio-ekonomike. Nga kjo gjendje e përgjithshme mund të vlerësohet se shëndeti i popullatës është jo i mirë. Edhe pse rastet e sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare kanë shënuar rënie, duke ju falënderuar ndërgjegjësimit, edukimit, tretmanit, kujdesit, që nga viti 1999 akoma sëmundjet e Hepatiti A, meningjiti, diabeti dhe sëmundjet ngjitëse të zorrëve janë ende të larta krahasuar me vendet e rajonit dhe BE.

Nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve të regjistruar në kujdesin parësorë shëndetësorë për vitin 2010, në kuadër të grupit të sëmundjeve që ndërlidhen me mjedisin dhe faktorët mjedisor, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar me sëmundje infektive me 53762 raste ose 28 %, si dhe me sëmundje të sistemit të frymëmarrjes me 6962 raste në vit, ose 3.6 % e numrit të përgjithshëm të të sëmurëve. Ndërsa është regjistruar numër relativisht i vogël i rasteve të morbiditetit dhe mortalitetit nga faktorët e jashtëm. Për më shumë tabelat vijuese.

Tabela 40: Rastet e sëmundjeve që ndërlidhen me gjendjen e mjedisit dhe faktorëve të tij në kuadër të numrit të përgjithshëm të rasteve të sëmundjeve të regjistruara³⁹

Nr.	Lloji i sëmundjes	Nr. i rasteve 2011	%
	Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	6962	3.6
	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	5139	2.7
	Sëmundjet e lëkurës dhe sistemit nën lëkuror	1453	0.8
	Tumoret	2943	1.5
	Sëmundjet e sistemit urogjenital	2189	1.1
	Sëmundjet infektive dhe parazitare	53762	28.0
	Sëmundjet e sistemit të tretjes	3192	1.7
	Lëndimet, helmimet dhe pasojat tjera të shkaktuara nga faktorët e jashtëm	2871	1.5
	Shkaktarët e jashtëm të morbiditetit dhe mortalitetit	579	0.1

Në tabelën vijuese janë prezantuar edhe llojet e sëmundjeve ngjitëse dhe incidenca e tyre në Kosovë për vitet 2008 dhe 2009.

39 Statistikat e Shëndetësisë 2011, ESK 2012, fq 13

Tabela 41: Ecuria e sëmundjeve ngjitëse dhe incidenca e tyre në Kosovë 2008 dhe 2009⁴⁰

Sëmundjet	2008		2009	
ITPR - Pneumonia	13136	624	14537	690.6
Diarea acute	52515	2494.7	47111	2238.05
Variçela	5140	244.2	5354	254.3
Sindromi i diarese me gjak	64	3.04	130	6.2
Sindromi meningjeal	397	18.8	378	17.9
Paraliza acute flakcide	1	0.05		
Sindromi i etheve hemoragjike	7	0.33	14	0.7
*Sindrome me ethe ekzantematike	5	0.24	27	1.3
Parotiti epidemik	797	37.8	909	43.2
Verdhëza acute A	1271	60.3	1193	56.7
Verdhëza B, HBs	95	4.5	159	7.6
Pertussis	37	1.7	20	0.9
Tularemia	46	2.2	88	4.2
Bruceloza	73	3.5	64	3.04
TBC	948	45.04	901	42.8
*Intoxicatio alimentaris	460	21.8	466	22.1
*Typhus abdominalis	29	1.4	6	0.3
Dyshimi në Influençë	26684	1267.6	41959	1993.3
Influenca A (H1N1)			308	14.6
Sëmundjet tjera ngjitëse	1817	86.3	2375	112.8
Total	103522	4917.9	115999	5510.64

Ndërsa nëse analizohen rastet e vdekjes në Kosovë, sipas klasifikimit të sëmundjeve për peridhën 2006-2011, mund të konkludohet se numri më i madh i të vdekrave kanë qenë me sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut, nga tumoret dhe nga sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes (Tabela 42).

Tabela 42: Shkaqet e vdekjes në Kosovë 2006-2011⁴¹

Nr.	Lloji i sëmundjes	2006	2007	2008	2009	2010	2011
	Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	203	145	152	236	243	264
	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	2766	2561	2794	2796	3465	3260
	Tumoret	546	573	597	575	754	827
	Sëmundjet e sistemit urogjenital	114	133	100	102	76	72
	Sëmundjet infektive dhe parazitare	28	34	29	25	30	30
	Sëmundjet e sistemit të tretjes	50	66	89	76	55	52
	Lëndimet, helmimet dhe pasojat tjera të shkaktuara nga faktorët e jashtëm	11	13	2	1	5	0
	Shkaktarët e jashtëm të morbiditetit dhe mortalitetit	74	129	82	85	170	274

40 Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, 2010

41 Shkaqet e vdekjeve në Kosovë 2006-2007 dhe 2010-2011, ASK. Prishtinë, fq 59 dhe 35.




Fig 76: Shkaqet e vdekjes në Kosovë

7.2. Kualiteti i ujit të pijes dhe shëndeti publik

Një ndër problemet evidente në Kosovë është mos qasja e plotë e popullatës në ujë cilësor të pijes. Po ashtu, ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nuk janë të mbrojtur nga ndotja dhe nuk respektohen zonat e përcaktuara sanitare.

Sa i perket furnizimit me ujë të pijshëm të populates ne Kosovë është pak a shumë i ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet ujit sipërfaqësor, me rreth 55% të ujit të furnizuar, dhe ujërave nëntokësore, të cilët e furnizojnë 45% të pjesës së mbetur. Gjysma e ujit që e furnizon Kosovën vije nga 5 rezervarët e mëdhenj të ujit, një pjesë tjetër domethënëse prej 31% vije nga burimet natyrale, këto burime natyrale përbëjnë një resurs të madh të ujit nëntokësor të kualitetit të lartë.

Në Kosovë janë shtatë KUR të licencuara, zonat e shërbimeve të cilave mbulojnë rreth 96% të popullsisë dhe të cilat furnizojnë me ujë rreth 60% të popullsisë që jeton në ato zona. Prej 40% të popullsisë të cilat nuk e marrin ujin nga KUR-të, vlerësohet se rreth 7% jetojnë në komunitet që furnizohet me ujë nga sistemet rrjedhëse të pompuar prej të cilave (3%) nuk menaxhohen nga askush. Pjesa e mbetur prej 33% nuk kanë sistem të furnizimit me ujë të pompuar, dhe e marrin ujin nga pusët apo burimet shtëpiake.

Do të ishte e arsyeshme që të vlerësohet që shumica e 40% të popullsisë që nuk furnizohet nga KUR-të nuk furnizohen me ujë të dezinfektuar. Për këtë arsye, ekziston arsyeja për brengosje në lidhje me kualitetin e ujit dhe rrezikun që pason prej saj për shëndetin publik.⁴²

Me këtë mund të themi se kualiteti i ujit të pa trajtuar për furnizim të popullatës dallon prej rajoni në rajon. Përmbajtja e ujërave sipërfaqësore varet edhe nga përbërja minerale e tokës nëpër të cilën rrjedh si dhe nga struktura e akuiferëve. Ky është një problem serioz duke pasur parasysh se nuk respektohen standardet për zona sanitare. Është prioritet absolut të themelohen mekanizmat për monitorim me qëllim të sigurimit të të dhënave të sakta mbi kualitetin dhe kuantitetin e ujërave në Kosovë.

Përgjegjës për monitorimin e cilësinë e ujit të pijshëm të ujësjellësve publik në Kosovë është Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, i cili përcjell, kryen analizat dhe bënë raportet për përshtatshmërinë e cilësisë së ujit në bazë të rregullave.

Shumica e mbetjeve bakteriologjike ndodhin në ujësjellësit e qyteteve të vogla/rurale (zakonisht në puse të shpuara apo burime), edhe pse ka të raportuar edhe mos-përshtatshmëri të kualitetit të ujit

42 Studimi i Fizibilitetit për Kualitetin e Ujit të Pijshëm në Kosovë, Raporti i Përfundimtar i Fizibilitetit, 1 Tetor, 2009.

të pijshëm (kryesisht mbetje bakteriologjike) edhe në sistemet e ujësjellësve publik. Shqetësuese mund të jetë fakti se akoma nuk është duke u bere analizat e ujit te pijes për të përcaktuar nivelin e pesticideve e cila sipas Direktivës se Ujit te Pijes kërkon trajtim shtesë terciar (me karbon aktiv granular me kosto kapitale, por limitet parametrike maksimale për pesticidet individuale dhe totale janë respektivisht 0.1 dhe 0.50 mikro gram/l), por edhe analiza për te përcaktuar nivelin e radioaktivitetit në lokacione që mund të mendohet qe është rreziku i paraqitjes.

Rreth 50 % e popullatës ka qasje në rrjetin e kanalizimit. Rastet e sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare kanë shënuar rënie të ndjeshme që nga periudha e pasluftës e deri me sot. Një ndër faktorët që ka ndikuar në reduktimin e sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare mund të llogaritet edhe ngritja e shkallës së qasjes së popullatës ne kanalizim për ujerat e zeza, duke pasur parasysh se asnjëherë nuk është respektuar standardi i mbrojtjes së resurseve ujore të pijes.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP), rregullisht ndërmerr aktivitete me qëllim të vendosjes së një kontrolli të shtuar mbi cilësinë e ujërave të pijshëm. Në bazë të dhënave nga monitorimi i burimeve të ujit të pijshëm nga ky institucion, konstatohet se ndotja e ujërave të pijshëm është më e madhe nga kontaminimi bakteriologjik se sa nga kontaminimin kimik. 74%-90% e ujërave të bunarëve sipas IKSHP-së janë me kontaminim fekale.

Tabela 43 : Raporti i sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave për vitin 2009⁴³

KOMUNA	ITPR-Pneumonia	Diarreja akute	Varicela	Dyshimi në Influcencë	Gjithsej
DEÇAN	31	2	1021	673	16
SHARR	130	1	163	472	92
FERIZAJI	1730	18	3926	2671	521
FUSHË KOSOVË	281	14	772	1242	128
GJAKOVË	37	8	260	1165	142
GJILANI	791	6	2188	2535	330
DRENAS	175	23	1304	1339	250
BURIM	75	1	452	766	13
KAÇANIK	123	4	596	656	64
HANI I ELEZIT	5		913	35	57
DARDANË	359	1	1988	742	101
KLINË	390	3	2263	1627	166
LIPJAN	371	15	1195	1287	150
MALISHEVË	290	10	1999	1097	167
MITROVICË	1544	10	1824	6091	284
ARTANË	11		3	64	5
KASTRIOT	272	8	514	738	134
PEJË	752	6	1217	2498	202
JUNIK	9		383	265	33
PODUJEVË	881	9	1661	1891	146
PRISHTINË	2149	116	4557	8742	867
PRIZREN	1704	17	5009	3903	790
RAHOVEC	1656	6	1390	1405	152
SHTIME	161	4	479	170	28
SKENDERAJ	38	10	860	1269	118
THERANDË	303	2	3221	553	55
VITI	57	4	1211	1226	140
VUSHTRRI	212	10	590	1989	203
TOTALI	14537	308	41959	47111	5354

43 Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik, 2010




Figura 77: Përqindja e rasteve të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, A) viti 2007 dhe B) janar-qershor 2009

Tabela 44: Përqindja e mostrave të kontaminuara dhe sasia e klorit rezidual⁴⁴

Kontrolli bakteriologjik			Kontrolli kimik			Gjithsej mostra te analizuar	Klori rezidual mg/l
Mostra të analizuar	Mostra të kontaminuara	%	Mostra të analizuar	Mostra të kontaminuara	%	13.049	0-1-0.2
9.577	522	5.50	3.454	165	4.7		

Të dhënat në tabelën 44, flasin se prej 9.577 mostrave të analizuar nga IKSHP, 522 prej tyre ose (5.50 %) janë me kontaminim bakteriologjik, ndërsa prej 3.454 mostrave të analizuar 165 prej tyre ose (4.7 %) janë me kontaminim kimik.




Figura 78 : Papërshtatshmëria bakterore dhe vlerat e Clorit rezidual i ujit për pije nga sistemet qendrore të furnizimit në Kosovë: A) 2007 dhe B) janar-qershor 2009

44 Disa fakte për mjedisin, ESK 2009

Ndërkohë që vlerat e klorit rezidual sillen prej 0.1-0.2 mg/l, që është brenda vlerave të lejuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (VML 0.2 mg/l).

7.3. Kualiteti i ajrit dhe shëndeti publik

Hulumtimet shkencore kanë vërtetuar ndikimet në shëndetin publik nga ndotja e ajrit dhe në veçanti nga grimcat (PM). Efektet kryesore të PM në shëndetin publik janë sëmundjet respiratore dhe efektet kardiovaskulare. Efektet që i atribuohen ekspozimit afatgjatë përfshijnë mortalitetin për shkak të sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore, sëmundjeve kronike respiratore (astma, sëmundjet kronike obstruktive të mushkërive, dhe ndryshimet kronike patologjike), kanceri i mushkërive, sëmundjet kronike kardiovaskulare, dhe pengesat në rritjen intrauterine sikur është përsëmbull pesha e ulët në lindjen normale.

Në një analizë të bërë nga Banka Botërore, thuhet se në bazë të koeficienteve ekspozim/reagim, koncentrimet vjetore të PM në ajrin e ambientit, dhe të dhënat për popullsinë e ekspozuar, ndotjen e ajrit urban në Kosovë llogaritet se shkaktojnë 835 vdekje të parakohshme, 310 raste të reja të bronkitit kronik, 600 shtrirje në spital dhe 11,600 vizita në emergjencë. Efektet shëndetësore paraqesin humbjen prej më shumë se 8,700 DALY në vit.

Tabela 45: Ndikimi i llogaritur në shëndet nga ndotja e ajrit në Kosovë⁴⁵

Ndikimi në shëndet	Rastet në vit	DALY/10,000 raste	Gjithsej DALY* në vit
Mortaliteti kardiopulmonar (PM _{2.5})	748–800	80,000	5,987–6,399
Mortaliteti ALRI ⁴ (PM ₁₀)**	57–61	80,000	458–488
Mortaliteti ALRI (PM ₁₀)	2	340,000	59–63
Bronkiti kronik (PM ₁₀)	299–320	22,000	658–705
Shtrirjet në spital (PM ₁₀)	580–620	160	9–10
Vizitat në emergjencë (PM ₁₀)	11,200–12,000	45	50–54
Ditët me aktivitete të kufizuara (PM ₁₀) (mijëra)	1,976–2,117	3	593–635
Sëmundja e traktit të ulët respirator te fëmijët (PM ₁₀)	22,900–24,500	65	149–159
Simptomat respiratore (PM ₁₀) (mijëra)	6,291–6,741	0.75	472–506
Gjithsej			8,435–9,019

Këto raste të përlllogaritura zakonisht janë më të larta sesa numri i pacientëve të regjistruar me sëmundje respiratore pasi që nuk shkojnë të gjithë personat me simptoma respiratore te mjeku apo në spital.

Brenda grupit të sëmundjeve që lidhet me mjedisin dhe faktorët mjedisor, grupi i vetëm më i madhi i pacientëve ka sëmundje respiratore - 663,353 raste në vit apo 31,5% e pacientëve total

45 Burimi: Analize mjedisore, Vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin, Banka Botërore 2011 - *DALY, Efektet shëndetësore të ndotjes së ajrit të konvertuara në vite të jetës të humbura si pasojë e sëmundjes, kurse **ALRI - Infeksioni akut i traktit të poshtëm respirator

7.4. Konkluzione dhe Rekomadimet

Konkluzionet

- Edhe me tej në Kosovë, ka numër të madh të rasteve të sëmundjeve ngjitëse;
- Edhe me tej në Kosovë, ka numër të madhe të rasteve të sëmundjeve që ndëlidhen me gjendjen e mjedisit e sidomos të sëmundjeve që vijnë nga ndotja e ujit dhe ajrit,
- Numri i madh i rasteve me diarre ujore mund të lidhet me kushtet e dobëta ekonomike dhe higjienike, cilësinë e ujit të pijshëm, mungesën e kanalizimit, menaxhimin e dobët të mbeturinave etj;
- Numri ende i madh i rasteve të Hepatitit A është indikator i cili flet për nivelin e ulët të higjienës si dhe shfrytëzimin e ujit të pijes nga pusët e kontaminuara;
- Numri i madh i të semuarve të sistemit respirator është indikator i ndotjes së ajrit,
- Cilësia e ujit të pijshëm në nivelin nacional ende nuk është e kënaqshme;
- Dezinfectimi i ujit të pijshëm nuk është i qëndrueshëm;
- Zonat mbrojtëse të resurseve ujore mungojnë në shumë raste.

Rekomandimet

- Të mbahen statistika të detajuara për numrin e sëmundjeve ngjitëse dhe sëmundjeve ambientale,
- Të hartohen raporte të rregullta për kualitetin e ujit të pijes dhe të jenë në dispozicion të publikut,
- Të stabilizohet cilësia e ujit të pijes në nivel nacional
- Dezinfectimi i ujit të pijshëm duhet të jetë i qëndrueshëm në tërë territorin e Kosovës
- Të shpallen zonat mbrojtëse të resurseve ujore që përdoren për pije,
- Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i kualitetit të ujërave të akumulacioneve ujore.
- Të investohet në përmirësimin e kualitetit të ujit dhe kualitetit të ajrit.

8. Masat për mbrojtjen e mjedisit

8.1. Zbatimi i Strategjisë së Kosovës për Mjedis dhe Planit të Veprimit

Gjatë vitit 2011-2012, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka rishikuar Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2005-2015 dhe Planin e Veprimit për Mjedis. Si rezultatet i këtij procesi është hartuar draft Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2022. Ky dokument ka identifikuar problemet kyçe mjedisore dhe ka përcaktuar orientimet strategjike. Me qëllim të zbatimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2022 dhe detyrimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, është hartuar edhe Plani i Kosovës për Veprimi në Mjedis për periudhën 2013-2017. Hartimi i këtyre dokumenteve është mbështetur edhe nga Qeveria Suedeze përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA). Aktualisht, Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2022 është në procedurë të shqyrtimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës dhe në Kuvendin e Kosovës.

8.2. Strategjitë dhe Planet Sektoriale të Veprimit

Në legjislacionin mjedisorë të Kosovës përveç hartimit të Strategjisë së Kosovës për Mjedisin dhe Planit të Kosovës për Veprim në mjedis është paraparë edhe hartimi i strategjive sektoriale dhe planeve aksionare për sektorët kryesorë të mjedisit si: ujin, ajrin, biodiversitetin, mbeturinat dhe për çështje tjera mjedisore si: ndryshimet klimatike, mbrojtjen e tokës, mbrojtjen e pyjeve, administrimin me kemikate, mbrojtjen nga zhurma, mbrojtjen nga rrezatimi jonizues dhe jo jonizues etj. Gjatë vitit 2011 është miratuar në Kuvendin e Kosovës, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020, ndërsa janë në procedure për miratim edhe Strategjia dhe Plani Aksional për Mbeturina si dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit.

Gjatë vitit 2012, ka filluar puna në përgatitjen e Planit Strategjik të Kosovës për Ujëra, Strategjisë për Ndryshime Klimatike dhe disa strategjive tjera që parashihen sipas legjislacionit mjedisor dhe që janë të nevojshme për administrimin më efikas të mjedisit.

8.3. Hartimi i Planeve Mjedisore në nivelin lokal

Në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, komunat janë të obliguara që të hartojnë plane lokale të veprimit në mjedis. Deri më tani janë hartuar Plane Lokale të Veprimit në Mjedis në 27 Komuna. Në disa prej komunave këto plane janë miratuar, ndërsa në disa të tjera ato janë në proces të miratimit. Disa nga PLVM-të janë hartuar me përkrahjen financiare nga SIDA me implementimin e zyrës regjionale të mjedisit REC, ndërsa disa të tjera janë hartuar në kuadër të një projekti të Komisionit Evropian, implemetnuar nga EPTISA.

Gjatë vitit 2011, me përkrahje të Agjencionit Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar, Qendra Rajonale për Mjedis (REC) Zyra në Prishtinë ka filluar se implementuari projektin për hartimin e Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis - PVLM në 10 komuna të Kosovës, përkatësisht në komunat: Obiliq, Fushë Kosovë, Graçanicë, Partesh, Podujevë, Hani i Elezit, Istog, Deçan dhe Junik.

Po ashtu janë hartuar edhe 14 Plane lokale për menaxhimin e mbeturinave, konform kërkesave të Ligjit për mbeturina. Komunat që kanë hartuar Plane Lokale për menaxhimin e mbeturinave janë: Prishtina, Prizreni, Hani i Elezit, Vitia, Deçani, Juniku, Peja, Malisheva, Graçanica, Klllokoti, Ranillugu, Parteshi, Novobrdë dhe Kamenica. Ndërsa në komunat Mitrovicë, Rahovec, Fushë Kosovë dhe Istog, hartimi Planeve Lokale për menaxhimin e mbeturinave është në proces.

8.4. Hartimi i legjislacionit dhe përafrimi me Direktivat e BE-së

Gjatë 2012, në kuadër të plotësimit të legjislacionit për mjedisin dhe çështjeve tjera që nderlidhen me mbrojtjen e mjedisit janë miratuar disa ligje me rëndësi sikur janë:

- Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” 04/L-086 i miratuar me datën 13.12.2012 Dekreti nr. DL- 60 -2012, Datë 26.12.2012
- Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri” 04/L-087 i miratuar me datën 13.12.2012 Dekreti nr. DL- 059 -2012, Datë 26.12.2012
- Ligji për mbeturina 04/L-060 i miratuar me datën 24.05.2012 Dekreti nr. DL- 027 -2012, Datë 08.06.2012
- Ligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore 04/L-067 i miratuar me datën 24.05.2012 Dekreti nr. DL- 028 -2012, Datë 08.06.2012

Po ashtu janë miratuar edhe disa Udhëzime Administrative dhe Rregullore për fusha specifike mjedisore.

Krahas hartimit të legjislacionit mjedisor i është kushtuar kujdes i veçantë edhe përafrimit të legjislaturës kombëtare mjedisore me atë evropiane. Komisioni Evropian ka monitoruar progresin e harmonizimit të legjislaturës mjedisore të Kosovës me atë të BE-së dhe zbatimin e saj.

Tabela 46: Rezultatet e monitorimit të progresit të harmonizimit të legjislaturës mjedisore me atë të BE-së⁴⁶

Fusha	Direktiva e BE	Niveli i harmonizimit (%)
Legjislatura horizontale	Direktiva për VNM (85/337/EEC)	62
	Direktiva për VSM (2001/42/EC)	100
	Direktiva për informimin mjedisor (2003/4/EC)	26
	Direktiva për pjesëmarrjen e publikut (2003/35/EC)	60
Kualiteti i Ajrit	Direktiva kornizë për kualitetin e ajrit (96/62/EC)	75
	Direktiva për vlerat kufitare të SO ₂ , NO ₂ , NO _x , grimcave pezull (particulate matter) dhe plumbit në ajër (99/30/EC)	47
	Direktiva për Benzenin dhe Monoksidin e Karbonit (2000/69/EC)	50
	Direktiva për Ozonin (2002/3/EC)	57
	Direktiva për Arsenin, Kadmiumin, Merkurin, Nikelin, dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër (2004/107/EC)	20
Menaxhimi i mbeturinave	Direktiva për mbeturinat (2006/12/EC)	95
	Direktiva për mbeturinat e rrezikshme (91/689/EC)	100
	Direktiva për ambalazhet mbeturinë (94/62/EC)	88
	Direktiva për deponitë (99/31/EC)	90
	Direktiva për incinerimin e mbeturinave (2000/76/EC)	69
Kualiteti i ujit	Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC)	16
	Direktiva për ujërat e ndotura urbane (91/271/EEC)	25
	Direktiva për ujin e pijes (98/83/EC)	68
	Direktiva për nitratet (91/676/EEC)	7
Mbrojtja e Natyrës	Direktiva për zogjtë e egër (79/409/EEC)	83
	Direktiva për habitatet (92/43/EC)	73
Kontrolli i ndotjes industriale	Direktiva për kontrollin e integruar të ndotjes (96/61/EC)	97
	Direktiva për impiantet me djegie të mëdha (2001/80/EC)	64
Kimikatet	Direktiva për substancat e rrezikshme (67/548/EEC)	xx
	Direktiva për kontrollin e OMGJ-ve (2001/18/EC)	79

46 European Commission, DG ENV, Progress Monitoring Report, Year 3 -2009. August 2009

8.5. Investimet në Mbrojtjen e Mjedisit

Gjatë viteve 2010-2012 një pjesë e investimeve mjedisore janë orientuar në rehabilitimin e disa deponive dhe mbylljen e deponive të vjetra të mbeturinave komunale dhe industriale.

Investime tjera nga MMPH-ja janë realizuar edhe në implementimin e projekteve për ndërtimin e shtatë qendrave për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore, si dhe në implementimin e projektit për mbeturina të rrezikshme, në ndërtimin e magazinave për ruajtje të përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.

Në sektorin e ujërave është investuar në rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe në hartimin e studimeve të fisibilitetit për trajtimin e ujërave të ndotura.

Tabela 47: Projektet në sektorin e ujërave 2010-2012⁴⁷

Emri i projektit	Shuma e projektit €	Viti i realizimit
Rehabilitimi dhe ndërtimi i argjinaturave përgjatë lumit Sitnica	9,400,000.00	2010 – 2012
Rregullimi i shtratit të Lumëbardhit të Prizrenit	1,000,000.00	2010 – 2012
Realizimi i fazës së parë të projektit socio-ekonomik për trajtimin e ujërave të ndotura për Prizren	3,000,000.00	2010 – 2012
Studimi i fizibilitetit dhe projekti për trajtimin e ujërave të ndotura për Pejë	70,000.00	2010 – 2012
Studimi i fizibilitetit dhe projekti për trajtimin e ujërave të ndotura për Prishtinë	150,000.00	2010 – 2012
Studimi i segmenteve ku mund të shfrytëzohet rëra dhe zhavorri në lumin Drini i Bardhë	1,700,000.00	2010 – 2012
Ndërtimi i argjinaturave përgjatë lumit Drini i Bardhë	1,105,000.00	2010 – 2012
Vlerësimi i gjendjes së sigurisë së digave dhe pajisja me instrumente monitoruese	505,000.00	2010 – 2012
Ndërtimi i kanalizimit të qytetit dhe disa fshatrave në Komunën e Deçanit.	1,800,074.00	2010 – 2012
Rregullimi i shtratit të lumit Drenica	1,200,000.00	2010 – 2012
Rregullimi i shtratit të lumi Toplluha në Suharekë	1,500,000.00	2010 – 2012
Rregullimi i shtratit të lumit në Mamushë	1,000,000.00	2010 – 2012
Rregullimi i kanalizimit për fshatrat Runik dhe Banjë të Skenderajt	550,000.00	2010 – 2012

Investimet e donatoreve kanë qenë të orientuara në ngritjen e kapaciteteve dhe në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në përgjithësi, por edhe në ngritjen e rrjetit të monitorimit të gjendjes së mjedisit (Tabela 48).

⁴⁷ Departamenti i ujërave MMPH

Tabela 48: Investimet nga donatorët për periudhën 2009-2012⁴⁸

Nr	Donatori	Titulli i projektit	Shuma e financuar
1.	KE (IPA-2010)	Mbështetje për përmirësimin e kushteve Mjedisore në Kosovë-Projek Binjakezimi	1,800,000.00 €
2.	KE (IPA 2009)	Mbështetje për sektorin e Mjedisit në Kosovë- Projekt Binjakezimi	1,100,000.00 €
3.	KE (IPA-2009)	Krijimi i rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit	2,035,000.00 €
4.	KFW	Sistemi Ujërave të zeza dhe projekti i përmirësimit të infrastruktures së lumit Bistrica Prizren	5,000,000.00 €
5.	JICA Japoneze	Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshem të materialeve të reciklueshme	5,171,000.00 €
6.	Czech Trust Fund + UNDP	Zhvillimi i Sistemit për Inventarin e Gazrave të Seres në Kosove	70. 000 US Dollar
7.	SËECO/SIDA	Mbështetje për hartimin e Strategjisë së Mjedisit dhe Planit të Veprimit	375,000.00 €
8.	UNDP	Studim fisibiliteti për trajtimin e lokacioneve të minierave në, Artanë	12. 500 €
9.	UNDP- FIN-LANDA	Konservimi i biodiversitetit dhe zhvillimi i qëndrueshëm hapësinor për komunën e Dragashit	3,000,000.00 €
10.	Qeveria Gjermane (GIZ)	Menaxhimi i Tokës/ Kadastrit i Tokave të Kosovës	2.5 milion €
11.	Ambasada Çeke	Ndërtimi i Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Halilaq	300,000.00 €
12.	Banka Botërore	Sigurimi i Ujit për Kosovën Qendrore (pellgu i Ibrit dhe HS. Ibër - Lepenc	200.000.00 €
13.	KFW (WBIF)	Studimi i Fizibilitetit për 4 impiante për trajtimin e Ujërave të Zeza në 4 qendra rajonale të Kosovës	1.8,000,000.00 €

8.6. Zhvillimet dhe ngecjet në forcimin e institucioneve mjedisore

Ndër zhvillimet kryesore në forcimin, afirmimin dhe ngritjen e kapaciteteve teknike të institucioneve mjedisore gjatë periudhës 2010-2012 duhet veçuar:

- AMMK-ja ka vazhduar bashkëpunimin me EEA – EIONET dhe është involvuar në të gjitha aktivitetet e Agjencionit Evropian të Mjedisit,
- AMMK-ja është bërë anëtare e rrjetit të kryeshafave dhe drejtorëve të Agjencive Evropiane të Mjedisit- Epa Network.
- Është themeluar Agjencioni për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Nukleare-AMRK.
- Është themeluar Drejtoria e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
- Është themeluar njësi për krimet mjedisore në kuadër të Policisë së Kosovës.
- Ngritja e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe pajisja me aparatura dhe mjete të nevojshme e IHMK-së.
- Funksionalizimi i Bordit Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Themelimi i Drejtorive për mjedis në disa komuna (psh. Mitrovica dhe Obiliqi).
- Është themeluar Agjencioni për Eficiência të Energjisë në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Ndërsa, në kuadër të ngecjeve dhe pengesave në forcimin e institucioneve mjedisore gjatë kësaj periudhe veçohen:

- Mungesën e organit menaxhues për Parkun Regjional Mirusha;
- Mos funksionalizimi i Këshillit Kombëtarë të Ujërave.
- Mungesa e rrjetit të monitorimit për cilësinë e tokës/dheut.
- Kapacitetet e kufizuara të institucioneve mjedisore për disa çështje mjedisore, për shembull Ndryshimet Klimatike.
- Mungesa e kapaciteteve për mbrojtjen e mjedisit në nivelin lokal.

⁴⁸ MMPH, 2012

9. Referencat

9.1 Literatura, Raportet dhe Publikimet

- Analizë mjedisore, Vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin, Banka Botërore 2011
- Anketa Administrative Gjysmë Vjetore/ Zyra e Statistikave Bujqësore-MBPZHR
- Anketa e mbeturinave industrial 2010, ASK
- Anketa e mbeturinave komunalet 2011, ASK
- Bruto prodhimi vendorë në Kosovë për vitet 2004-2008, ESK, Prishtinë, 2009
- Buletini 17,ESK, 1991-2001, Ecuria dhe shtrirja e pop. Shqiptare në Ish Jugosllavi, Instituti Ekonomik 1997, 2006.
- Disa fakte për mjedisin, ESK 2009
- Disa fakte për mjedisin, ESK, 2007
- European Commission, DG ENV, Progress Monitoring Report, Year 3 -2009. August 2009
- Gjeografia e Kosovës, ETMM,Pr,1994
- Identifikimi Hapësinor i Ndotësve Potencial në Komunat Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Obiliq, AMMK 2009
- Kadastr i ndotësve të ujërave, REC&AMMK, 2010
- Kosova në shifra 2006 dhe 2011, ESK, Prishtinë 2007 dhe 2012.
- Raportet mujore nga NeëCoFerronikeli,(2011- 2012)
- Raportet mujore, SHARRCEM, 2012
- Raporti Gjendja e Natyrës në Kosovë 2009, AMMK 2010
- Raporti për gjendjen e mjedisit në KEK (2011- 2012)
- Raporti vjetor i monitorimit të cilësisë së ajrit-2012, IHMK
- Raporti, Gjendja e Ajrit në Kosovë, AMMK 2011
- Raporti, Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2008, AMMK
- Raporti, Gjendja e Mjedisit të Kosovës 2008-2010, AMMK
- Raporti, Gjendja e Ujërave në Kosovë, AMMK 2010
- Raporti, Hotspotet Mjedisore në Kosovë, AMMK 2011
- Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, ESK 2011
- Shkaqet e vdekjeve në Kosovë 2006-2007 dhe 2010-2011, ASK
- Statistikat e lindjeve në Kosovë 2008, ESK 2009
- Statistikat e Shëndetësisë 2011, ASK 2012
- Statistikat e vdekjeve në Kosovë 2011, ESK, Prishtinë 2012
- Statistikat vitale të Kosovës 2002,
- Studimi i Fizibilitetit për Kualitetin e Ujit të Pijshëm në Kosovë, Raporti i Përfundimtar i Fizibilitetit , 1 Tetor, 2009.
- Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011, ASK 2012,
- Zyra Rregullatore për ujësjellës dhe kanalizim, ZRRUK 2010.

9.2. Institucionet qeveritare, joqeveritare dhe ndërmarrjet publike

- Agjencioni Kadastral i Kosovës
- Drejtoria e Parkut Kombëtar “Mali Sharr”
- Agjencioni i Statistikave të Kosovës
- Fabrika e Çimentos-Sharrcem
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës-IKSHP
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës-KDMK
- Kompania Regjionale e Ujësjetësimit- Prishtina
- Korporata Energjetike e Kosovës-KEK
- Ministria e Integrimeve Evropiane
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Infrastruktura
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Ministria e Shëndetësisë
- Ndërmarrja Trepça (nën administrim të AKP-së)
- NeëComplex Feronikeli
- Ngrohtorja e Qytetit-Termokos sh.a
- Qendra Regjionale për Mjedis zyra në Kosovë, REC
- Shoqata e Ujësjetësimit dhe Kanalizimeve të Kosovës-SHUKOS
- Zyra Rregullatore për Ujësjetësimit dhe Kanalizim-ZRRUK

10. Shtojcat

10.1. SHKURTESAT

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës	MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
AMRK	Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Nukleare	MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës	NP	Ndërmarrje Publike
BE	Bashkimi Evropian	OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
DL	Dekreti Ligjor	OE	Operatorë Ekonomik
DU	Departamenti i Ujërave	OJQ	Organizatë Joqeveritare
EEA	Agjencioni Evropian i Mjedisit	OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
EIONET	Rrjeti Evropian Mjedisor për Informim dhe Vëzhgim	PCB	Poli Klorur Bifenil
EPA Net.	Rrjeti Evropian i Kryeshefave të Agjencive të Mjedisit	PE	Përçueshmëria Elektrike
ETMM	Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore	PH	Përqendrimi i Jonit Hidrogjen
FP	Fortësia e Përgjithshme	PIM	Parku Industrial i Mitrovicës
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman	PK	Parku Kombëtar
GTS	Grimca të Suspenduara	PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
HEC	Hidrocentral	PLVM	Planet Lokale të Veprimit në Mjedis
IBA	Zonë me Rëndësi e Zogjëve	PMB	Produkte Kimike për Mbrojtjen e Bimëve
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës	PTD	Pluhuri Total i Depozituar
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës	REC	Qendra Rregjionale për Mjedis
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës	RM	Rezervat Natyrore
IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së	SIDA	Agjencioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtarë
IUCN	Unioni Ndërkombëtar i Konservimit të Natyrës	SHBO	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit
JICA	Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtarë	SHKO	Shpenzimi Kimik i Oksigjenit
KE	Komisioni Evropian	SHUKOS	Shoqata e Ujësjetllësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
KEK	Korporata Energetike e Kosovës	TC	Termocentral
KFW	Banka Gjermane për Zhvillim	TCA	Termocentrali A
KFOR	Forcat Paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë	TCB	Termocentrali B
KK	Kuvendi Komunal	TSP	Grimcat e Suspenduara Totale
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës	UA	Udhëzim Administrativ
KRM	Kompani Regjionale e Mbeturinave	UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
KUR	Kompania e Ujësjetllësve Rajonal	UNESCO	Programi i Kombeve të Bashkuara për Trashëgimi Kulturor dhe Natyrore
MAB	Rezervat i Biosferës	VML	Vlerat Maksimale të Lejuara
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	VMM	Vlerat Mesatare Mujore
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	VMV	Vlerat Mesatare Vjetore
MIE	Ministria e Integriteteve Evropiane	VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
MN	Monument i Natyrës	ZRRUK	Zyra Rregullator për Ujësjetllës dhe Kanalizim

10.2. Indeksi i tabelave

Tabela 1:	Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2011	Tabela 22:	Akumulacionet kryesore në Kosovë, sipërfaqja, rrjedhja ujore dhe vëllimi
Tabela 2:	Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 1948-2011	Tabela 23:	Tabela 23: Kodet e stacioneve monitoruese
Tabela 3:	Dendësia e popullsisë në Kosovë 1948-2011	Tabela 24:	Vlerat maksimale të lejuara për disa metale të rënda sipas direktivës EU 152/1999
Tabela 4:	Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2011	Tabela 25:	Sipërfaqja totale e tokave sipas klasave të përdorimit
Tabela 5:	Të ardhurat kombëtare për kokë banori në Kosovë 1985-2009	Tabela 26:	Kategoritë e tokave sipas komunavekave
Tabela 6:	Varfëria dhe varfëria e skajshme sipas vendbanimeve (%) 2009-2011	Tabela 27:	Lokacionet dhe rezultatet për ndotjen e dheut me metale të rënda në zonën e NeëCo "Ferronikeli Complex"
Tabela 7:	CO ₂ në t/vit për TC A dhe TC B gjatë viteve 2007- 2012	Tabela 28:	Hot-spotet mjedisore sipas lokacioneve, aktivitetit, sipërfaqes dhe burimeve potenciale të ndotjes
Tabela 8:	Emisionet e matura të Pluhurit ne furrat rrotulluese të Ferronikelit gjatë vitit 2012	Tabela 29:	Zonat e Mbrojtura të Natyrës
Tabela 9:	Emisionet e matura të SO ₂ në furrat rrotulluese të Ferronikelit gjatë vitit 2012	Tabela 30:	Gjendja e kafshëve të egra në PK (komunat e Prizrenit dhe Suharekës) për vitin 2011.
Tabela 10:	Emisionet e matura të NO _x në furrat rrotulluese të Ferronikelit gjatë vitit 2012	Tabela 31:	Popullata që shërbehet me mbledhjen e mbeturinave sipas kompanive dhe regjioneve për periudhën 2007-2010 shprehur ne %
Tabela 11:	Stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë	Tabela 32:	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2009 të shprehura në ton
Tabela 12:	Stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit në zonën e KEK-ut	Tabela 33:	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2010 të shprehura në ton
Tabela 12:	Numri i ditëve që tejkalon vlerën kufitare ditore për PM ₁₀	Tabela 34:	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2011 të shprehura në ton
Tabela 13:	Vlersimi i koncentrimin të SO ₂ në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011	Tabela 35:	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2012 të shprehura në ton
Tabela 14:	Vlersimi i koncentrimin të NO ₂ në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011	Tabela 36:	Sasia mbeturinave për person (kg/vit dhe kg/ditë) për 2008 dhe 2011
Tabela 15:	Vlersimi i koncentrimin të CO në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011	Tabela 37:	Sasitë e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me shtatë ose më shumë punëtorë
Tabela 16:	Vlersimi i përqendrimit të O ₃ në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011	Tabela 38:	Sasitë e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me më pak se shtatë punëtorë
Tabela 17:	Vlersimi i koncentrimin të PM ₁₀ në ajrin ambiental, sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011	Tabela 39:	Sasitë e mbeturinave të gjeneruara, të mbeturinave të rrezikshme dhe te trajtuara
Tabela 18:	Vlersimi i koncentrimin të PM _{2.5} në ajrin ambiental (mjedisor), sipas kërkesave të Direktives 2008/50 dhe UA Nr.02/2011	Tabela 40:	Rastet e sëmundjeve që ndërlidhen me gjendjen e mjedisit dhe faktorëve të tij në kuadër të numrit të përgjithshëm të rasteve të sëmundjeve të regjistruara
Tabela 19:	Gjatësia në kilometra e lumenjve kryesorë të Kosovës		
Tabela 20:	Pellgjet ujëmbledhës, sipërfaqja, sasia rrjedhëse e ujit dhe vend derdhja		
Tabela 21:	Vlerat maksimale, minimale dhe mesatare vjetore të prurjeve (Q=m ³ /s) të stacioneve hidrometrike sipas pellgjeve lumore		

- Tabela 41:** Ecuria e sëmundjeve ngjitëse dhe incidenca e tyre në Kosovë 2008 dhe 2009
- Tabela 42:** Shkaqet e vdekjes në Kosovë 2006-2011
- Tabela 43:** Raporti i sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave për vitin 2009
- Tabela 44:** Përqindja e mostrave të kontaminuara dhe sasia e klorit rezidual
- Tabela 45:** Ndikimi i llogaritur në shëndet nga ndotja e ajrit në Kosovë

- Tabela 46:** Rezultatet e monitorimit të progresit të harmonizimit të legjislaturës mjedisore me atë të BE-së
- Tabela 47:** Projektet në sektorin e ujërave 2010-2012
- Tabela 48:** Investimet nga donatorët për periudhën 2009-2012

10.3. Indeksi i figurave

- Figura 1:** Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2011
- Figura 2:** Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 2002-2011
- Figura 3:** Dendësia e popullsisë në Kosovë 1948-2011
- Figura 4:** Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2006
- Figura 5:** Të ardhurat kombëtare për kokë banori në Kosovë 1985-2009
- Figura 6:** Emisionet e matura të pluhurit për TC B1 në vitin 2007 dhe 2008 të paraqitura në mg/Nm³
- Figura 7:** Emisionet e kalkuluara të pluhurit në mg/Nm³ për TC A dhe TC B gjatë vitit 2012
- Figura 8:** Emisionet e kalkuluara të pluhurit në mg/Nm³ për TC A gjatë viteve 2007-2012
- Figura 9:** Emisionet e kalkuluara të pluhurit në mg/Nm³ për TC B gjatë viteve 2007 deri 2012
- Figura 10:** Emisionet e kalkuluara të SO₂ në mg/Nm³ për TC A dhe TC B gjatë vitit 2012
- Figura 10:** Emisionet e kalkuluara të SO₂ në mg/Nm³ për TC A gjatë viteve 2007 deri 2012
- Figura 12:** Emisionet e kalkuluara të SO₂ në mg/Nm³ për TC B gjatë viteve 2007 deri 2012
- Figura 13:** Emisionet e kalkuluara të NO_x në mg/Nm³ për TC A dhe TC B gjatë vitit 2012
- Figura 14:** Emisionet e kalkuluara të NO_x në mg/Nm³ për TC A gjatë viteve 2007 deri 2012
- Figura 15:** Emisionet e kalkuluara të NO_x në mg/Nm³ për TC B gjatë viteve 2007 deri 2012
- Figura 16:** Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm³ gjatë muajve Qershor, Korrik, Gusht të vitit 2012 në Sharrcem.
- Figura 17:** Vlera mesatare e SO₂ në mg/Nm³ gjatë muajve Qershor, Korrik, Gusht të vitit 2012 në Sharrcem.
- Figura 18:** Vlerat mesatare e NO_x në mg/Nm³ gjatë muajve Qershor, Korrik, Gusht të vitit 2012 në Sharrcem. Vlera mesatare e pluhurit gjatë viteve 2003-2011 nga Sharrcemi
- Figura 16:** Vlera mesatare e SO₂ gjatë viteve 2003 deri 2011 në Sharrcem
- Figura 17:** Vlerat mesatare e NO_x gjatë viteve 2003-2011 në Sharrcem
- Figura 18:** Emisionet absolute të CO₂ (tCO₂/vit)
- Figura 19:** Vlerat mesatare mujore të SO₂(ug/m³) gjatë vitit 2012
- Figura 20:** Vlerat mesatare mujore të NO₂(ug/m³) gjatë vitit 2012
- Figura 21:** Vlerat mesatare mujore të CO(mg/m³) gjatë vitit 2012
- Figura 22:** Vlerat mesatare mujore të O₃(ug/m³) gjatë vitit 2012
- Figura 23:** Vlerat mesatare mujore të PM₁₀(ug/m³) gjatë vitit 2012
- Figura 24:** Vlerat mesatare mujore të PM_{2.5}(ug/m³) nga monitorimi i ajrit gjatë vitit 2012
- Figura 25:** Numri i ditëve me tejkalim të vlerës kufitare ditore të PM₁₀(50ug/m³)
- Figura 26:** Vlera mesatare mujore e PM₁₀ në pikat matëse: Airpointer 1 dhe Airpointer 2
- Figura 27:** Vlera mesatare mujore e SO₂ në pikat matëse: Airpointer1 dhe Airpointer2
- Figura 28:** Vlera mesatare mujore e SO₂ në INKOS-TCA dhe në Kastriot-TCB për vitin 2012
- Figura 29:** Trëndafili i erës për stacionin e Gjilanit
- Figura 30:** Trëndafili i erës për stacionin e Hanit të Elezit
- Figura 31:** Trëndafili i erës për stacionin e Prizrenit
- Figura 32:** Oksigjeni i tretur në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 33:** Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 34:** Përçueshmëria elektrike në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 35:** Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Drinit të Bardhë

- Figura 36:** Azoti i nitrave në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 37:** Azoti i nitriteve në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 38:** Azoti i amoniumit në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 39:** Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 40:** Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 41:** Oksigjenit të tretur në pellgun e Ibrit
- Figura 42:** Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Ibrit
- Figura 43:** Përçueshmëria elektrike në pellgun e Ibrit
- Figura 44:** Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Ibrit
- Figura 45:** Azoti i nitrave në pellgun e Ibrit
- Figura 46:** Azoti i nitriteve në pellgun e Ibrit
- Figura 47:** Azoti i amoniakut në pellgun e Ibrit
- Figura 48:** Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Ibrit
- Figura 49:** Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Ibrit
- Figura 50:** Oksigjeni i tretur në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 51:** Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 52:** Përçueshmëria elektrike në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 53:** Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 54:** Azoti i nitrave në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 55:** Azoti i nitriteve në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 56:** Azoti i amoniumit në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 57:** Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 58:** Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës
- Figura 59:** Metali mangan në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 60:** Metali hekur në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 61:** Metali krom në pellgun e Ibrit
- Figura 62:** Metali zink në pellgun e Ibrit
- Figura 63:** Metali mangan në pellgun e Ibrit
- Figura 64:** Metali hekur në pellgun e Ibrit
- Figura 65:** Metali mangan në pellgun Morava e Binçës dhe pellgun e Lepencit
- Figura 66:** Metali hekur në pellgun Morava e Binçës dhe pellgun e Lepencit
- Figura 67:** Sipërfaqja e tokës bujqësore të cilës i është ndërruar destinimi në tokë jo bujqësore pa leje të Kuvendeve Komunale 1999-2008
- Figura 68:** Sipërfaqja e tokës bujqësore të cilës i është ndërruar destinimi në tokë jo bujqësore me leje të Kuvendeve Komunale 1999-2008
- Figura 69:** Sasia e mbeturinave sipas llojit (2012)
- Figura 70:** Mbeturinat sipas llojeve në Kosovë (2008)
- Figura 71:** Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare sipas viteve
- Figura 72:** % e mbeturinave sipas mënyrës se grumbullimit ne nivel te Kosovës
- Figura 73,74:** % e mbeturinave sipas mënyrës se grumbullimit sipas regjioneve
- Figura 75:** Sasitë e mbeturinave industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme
- Figura 76:** Shkaqet e vdekjes në Kosovë
- Figura 77:** Përqindja e rasteve të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, A) viti 2007 dhe B) janar-qershor 2009
- Figura 78 :** Papërshtatshmëria bakterore dhe vlerat e Clorit rezidual i ujit për pije nga sistemet qendrore të furnizimit në Kosovë: A) 2007 dhe B)janar-qershor 2009

10.4. Indeksi i hartave

- Harta 1.** Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë
- Harta 2.** Lokacionet e stacioneve monitoruese të cilësisës së ajrit zonën e KEK-ut
- Harta 3.** Stacionet e monitorimit te kualitetit fiziko-kimik të ujërave sipërfaqësore
- Harta 4.** Lokacionet e hotspotëve në Kosovë
- Harta 7:** Zonat e Mbrojtura

Raporti për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2011-2012”
është përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë,
përkatësisht nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Përgaditja e Raportit është realizuar nga ekspertët
e Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në
bashkëpunim me departamentet e tjera të Ministrisë
së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe me institucionet tjera relevante.

Raporti shpërndahet falas, kurse versioni elektronik
i Raportit mundë të shkarkohet edhe në www.ammk-rks.net dhe në www.mmph-rks.org

Adresa e AMMK-së:
Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04
Tel. +381 38 200 33 228 , email: kepa@rks-gov.net

Prishtinë, 2013

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

502.8(496.51)“2011/2012”

Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2011-2012 /
[Përgatitur nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të
Kosovës]. – Prishtinë : Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit
Hapësinor : Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës,
2013. - 110 f. : ilustr. me ngjyra; 29 cm.

Referencat : f. 102-103. – Shtojcat : f. 104-109

ISBN 978-9951-638-01-2

ISBN 978-9951-638-01-2



9 789951 638012



ISBN 978-9951-638-01-2



9 789951 638012